REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr.Prot 1924/2 Tiranë më 10.04.2019.

Kontratë partneriteti publik-privat për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore

Datë

10.04.19.

PËRMBAJTJA

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME 5
2. KONCESIONARI 16
3. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME 18
4. KOHËZGJATJA DHE KUSHTET PARAPRAKE 22
5. PËRFAQËSUESIT DHE NDËRLIDHJA 25
6. NDËRLIDHJA 26
7. DORËZIMI DHE DEKLARIMET DHE GARANCITË E AUTORITETIT 28
8. TË DREJTAT E KONCESIONARIT MBI LOKALET 30
9. LEJET DHE MIRATIMET 30
10. PROJEKTIMI 31
11. PUNIMET DHE PAJISJA 32
12. DETYRIMI I PËRGJITHSHËM I KONCESIONARIT 36
13. OBJEKTI I SHËRBIMEVE 37
14. NIVELI I SHËRBIMIT 42
15. STAFI DHE PUNËSIMI 42
16. NDËRVEPRIMI 44
17. ASETET E PROJEKTIT – SIGURIA 45
18. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE 45
19. DETYRIMET E KONCESIONARIT PËR TË RAPORTUAR 46
20. TË DREJTAT E AUTORITETIT PËR AUDITIM 46
21. AUDITIMI I FSDKSH-SË 47
22. TARIFAT DHE TAVANET E BUXHETIT 47
23. KUSHTET E PAGESËS 51
24. DËMET E LIKUIDUESHME DHE PENALITETET E PERFORMANCËS 53
25. DËMET E TËRTHORTA 54
26. GARANCIA E PERFORMANCËS 54
27. SIGURIMET 55
28. TARIFA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT 56
29. [NUK PËRDORET] 56
30. NDRYSHIMI 56
31. FORCA MADHORE 58
32. FORCË MADHORE POLITIKE 59
33. NDRYSHIMI NË LIGJ 60
34. RASTET E MOSPËRMBUSHJES 60
35. PERIUDHA E KORRIGJIMIT DHE PËRFUNDIMI NË LIDHJE ME NJË RAST MOSPËRMBUSHJE 61

36. NDËRHYRJA E AUTORITETIT....62
37. PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM....64
38. PAGESAT E PËRFUNDIMIT TË PARAKOHESHËM....64
39. DORËZIMI....66
40. DËMSHPËRBLIMET....68
41. NËËNKONTRAKTORËËT....69
42. LIGJI I ZBATUESHËM....70
43. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE....70
44. KALIMI....71
45. KONFIDENCIALITETI....71
46. GJUHA....71
47. POZITA E AUTORITETIT SI AUTORITET SHETËROR....72
48. TATIMET DHE TAKSAT....72
49. NJOFTIMET....72
50. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME....73
51. GARANCI E MËTEJSHME....73
52. MARRËVESHJA E PLOTË....73
53. MOSHEQJA DORË....73

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1. ANËTARËT E KONSORCIUMIT
SHTOJCA 2. MEKANIZMI I RAPORTIMIT
SHTOJCA 3. ANALIZAT DHE TARIFAT E SHËRBIMIT
SHTOJCA 4. KËRKESAT TË KNIKE MINIMALE
SHTOJCA 5. PLANI I REKRUTIMIT
SHTOJCA 6. LEJET
SHTOJCA 7. KALENDARI I PROJEKTIT
SHTOJCA 8. PROCESI I REFERIMIT
SHTOJCA 9. LISTA E SPITALEVE REFERUESE
SHTOJCA 10. STRUKTURA E PRONËSISË SË KONCESIONARIT
SHTOJCA 11. LOKALET
SHTOJCA 12. FORMA E MARRJES PËRSIPËR TË DETYRIMEVE
SHTOJCA 13. KOMISIONIMI
SHTOJCA 14. TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE PENALITETET
SHTOJCA 15. FORMA E GARANCISË SË PERFORMANCËS
SHTOJCA 16. SIGURIMET E KËRKUARA
SHTOJCA 17. DORËZIMI ME FAZA I LOKALEVE
SHTOJCA 18. PROCEDURAT E SISTEMIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (ESMS)
SHTOJCA 19. OFERTA E KONCESIONARIT
SHTOJCA 20. STANDARDET E SHËRBIMITT

"KJO KONTRATË E PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT-PPP ("Kontrata") e lidhur sot më datë [●_____] 2019 ,

MIDIS

1. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e përfaqësuar nga [●], me adresë në [●], dhe

(më poshtë referuar si **"Autoriteti")"**

DHE

2. Konsorciumit të operatorëve ekonomikë të listuar në Shtojcën 1, i krijuar në përputhje me marrëveshjen Nr. Kol. 603 Nr. Rep. 189/3, përfaqësuar ligjerisht nga _____, (më poshtë referuar si **"Koncesionari"**, ku përfshihen pasardhësit dhe përfituesit e të drejtave përmes cedimit).

Autoriteti dhe Koncesionari përbëjnë bashkërisht **"Palët"** dhe individualisht një **"Palë".**

NDONËSE:

(A) Në përputhje me Ligjin nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat"(**"Ligji për PPP-të"**), Autoriteti ka fituar ofertuesit të dorëzojnë ofertat e tyre për financimin, projektimin, ndërtimin, administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Objekteve Laboratorike në Spitalet Referuese;

(B) Konsorciumi i përbërë nga anëtarët e listuar në Shtojcën 1 (*Anëtarët e Konsorciumit*) dorëzoi një ofertë detyruese për Projektin tek Autoriteti më [_____] të përbërë nga oferta teknike dhe oferta financiare, bashkëngjitur në Shtojcën 19 (**"Oferta e Koncesionarit"**);

(C) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i krijuar për këtë Projekt vendosi se konsorciumi i sipërpërmendur është ofertuesi fitues për këtë Projekt;

(D) Konsorciumi do të krijojë një subjekt për qëllim të veçantë (**"SPV"**) për të vepruar si Koncesionar, në përputhje me kërkesat e kësaj Kontrate;

(E) Autoriteti dhe Koncesionari kanë dakorduar me sukses këtë Kontratë pa ndonjë ndryshim thelbësor nga projekt-marrëveshja e përfshirë në dokumentet e tenderit për Projektin.

SI RRJEDHOJË U RA DAKORD PËR SA VIJON:

I. TË PËRGJITHSHME

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Fjalët që fillojnë me gërma të mëdha këtu kanë kuptimin që u jepet atyre në këtë Nen si vijon:

"Data Reale e Komisionimit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 11.5.3.

"Palë e Prekur" ka kuptimin e dhënë në Nenin 31.1.

"Filiali" nënkupton në lidhje me çdo shoqëri, një shoqëri kontrolluese e cila ka Kontrollin në atë shoqëri, çdo shoqëri nën Kontrollin e kësaj shoqërie apo çdo shoqëri bijë të një shoqërie kontrolluese e cila ka Kontroll mbi atë shoqëri.

"Kontratë" është kjo marrëveshje dhe të gjitha Shtojcat e saj (të cilat konsiderohen se janë pjesë përbërëse të saj).

"Plani Alternativ i Punësimit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 15.3.

"Tavani i Buxhetit Vjetor" është shuma maksimale e përgjithshme e tarifave të shërbimit që i paguhen Koncesionarit në një vit të caktuar financiar nga Spitalet Referuese duke filluar nga Data Reale e Komisionimit, sipas buxhetit të miratuar nga Këshilli i Ministrave (apo çdo Entitet tjetër Shtetëror, sipas rastit në cdo kohë) për çdo Spital Referues në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe Nenin 23.1.2 (a) të kësaj Kontrate.

"Ligji i Zbatueshëm" në Republikën e Shqipërisë, është çdo akt, statut, apo ligj; çdo urdhër ekzekutiv apo dekret; çdo legjislacion i nxjerrë nga një organ i deleguar apo i varur, instrument ligjor, rregulla apo rregullore; çdo vendim i Këshillit të Ministrave; çdo akt normativ nënligjor; çdo aktgjykim apo urdhër gjykate i formës së prerë nxjerrë nën juridiksion kompetent; çdo akt administrativ apo vendim i një Entiteti Shtetëror, që ka efekt ligjor detyrues; kodet, standardet apo udhëzuesit që kanë efekt ligjor detyrues; në rastin e secilit prej sa më lart, pavarësisht nëse të njëjtët zbatohen për një person apo persona të caktuar, apo përgjithësisht në nivel lokal, rajonal, federal, kombëtar, apo ndërkombëtar; sikundër mund të ndryshohet herë pas here.

"Autoriteti" është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
"Rast Mospërmbushje i Autoritetit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 34.2.

"Garancia e Ofertës" është garancia e ofertës që i dorëzohet Autoritetit nga ofertuesi fitues, në përputhje me kërkesën për ofertë për Projektin.

"Tavani Buxhetor" nënkupton shumën maksimale totale të Tarifës së Shërbimit të pagueshme nga një Spital Referues për Koncesionarin në një Periudhë Buxhetore gjatë Afatit, e cila përfaqëson Tavanin Buxhetor Vjetor për atë Spital Referues në 12 Periudha Buxhetore.

"Periudha Buxhetore" është një muaj kalendarik.

"Data e Fillimit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 4.2.4.

"Njoftimi i Përfundimit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 11.5.2.

"Koncesionari" ka kuptimin e dhënë në përshkrimin e Palëve në faqen e parë të Kontratës.

"Oferta e Koncesionarit" ka kuptimin e dhënë në Recitalin B.

"Rast Mospërmbushje i Koncesionarit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 34.1.

"Person i Lidhur" është, në lidhje me çdo Person: (i) një Palë e lidhur ; (ii) çdo anëtar i Këshillit të Administrimit, drejtues i lartë ose administrator, ose i një Personi të tillë, ose i çdo Personi të përmendur në një pikë (i); (iii) çdo konsulent, agjent, apo përfaqësues që mbështet një Person të tillë në lidhje me Projektin, dhe; (iv) çdo Person me interes fundon të përgjithshëm në të paktën pesë përqind të kapitalit të regjistruar ose interesave pronësore tek një Person i tillë (pavarësisht nga forma e pronësisë).

esa:

"Periudha e Ndërtimit" është periudha gjatë së cilës merren përsipër Punimet nga Koncesionari, periudhë që nis në Datën e Fillimit dhe që përfundon në Datën Reale të Komisionimit të Objektit të fundit Laboratorik, të përfunduar dhe komisionuar sipas Shtojcës 7 (*Kalendari i Projektit*).

"Kontrolli" është aftësia për të drejtuar apo për të përcaktuar politikat menaxhuese të një Personi përmes:

(a) zotërimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të të paktën pesëdhjetë përqind (50%) plus një të pjesëve/aksioneve me të drejtë vote; ose

(b) zotërimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të të paktën 20% (njezetë përqind) të pjesëve/aksioneve me të drejtë vote dhe:

(i) zotërimi i të drejtës së votës për një numër të caktuar pjesësh/aksionesh, përmes marrëveshjeve mbi të drejtën e votës, në mënyrë të tillë që numri total i pjesëve/aksioneve që zotërohen nga subjekti së bashku me numrin e pjesëve/aksioneve për të cilat subjekti ushtron të drejtën e votës, të jetë i barazvlefshëm me pesëdhjetë përqind (50%) plus një të pjesëve/aksioneve me të drejtë vote; ose

(ii) aftësinë për të zgjedhur shumicën e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të atij Personi,

(dhe **"i Kontrolluar"** do të interpretohet në përputhje me këtë më lart).

"Entitet i Kontrolluar" në lidhje me Koncesionarin nënkupton një Filial, një nënkontraktor, konsulent dhe çdo Person tjetër, agjent dhe përfaqësues që vepron në emër të tij/tyre.

"Këshilli i Ministrave" është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

"Periudha e Korrigjimit" ka kuptimin e dhënë në Nenin 35.2.

"Dokumentet e Projektimit" janë të gjitha vizatimet, raportet, dokumentet, llogaritjet e programeve dhe dokumentet e tjera të projektit, duke përfshirë projektet konceptuale, projektet e hollësishme dhe vizatimet përfundimtare të punës që prodhohen nga Koncesionari në përputhje me këtë Kontratë, me qëllim për të siguruar lejet dhe kryer Punimet.

"E&S" ka kuptimin e dhënë në Nenin 20.4.

"Data efektive" e kësaj kontrate (kur edhe hyn në fuqi) do të jetë data e nënshkrimit të kësaj kontrate në mënyrë të rregullt nga të dy palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe publikimit ne Fletoren Zyrtare."

"Pacient Urgjence" është një pacient (i siguruar apo i pasiguruar) i paraqitur dhe i pranuar në shërbimin e urgjencës të Spitaleve Referuese i cili trajtohet jo më shumë se 24 orë nga shtrimi, në këtë shërbim.

"Analiza Urgjente" janë të gjitha Analizat e cilësuara si të tilla në Shtojcën 3 *(Analizat dhe Tarifat e Shërbimit).*

"Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social" ose **"ESMS"** është një sistem menaxhimi mjedisor, social, shëndetësor dhe i sigurisë, i cili bën të mundur identifikimin, vlerësimin

dhe menaxhimin e risqeve të Projektit në bazë të vazhdueshme, i ngritur në përputhje me kërkesat e Ligjit të Zbatueshëm dhe Standardet e Performancës së IFC-së.

"Pajisje" janë të gjitha pajisjet diagnostikuese, harduerët e teknologjisë së informacionit dhe pajisjet e laboratorëve mjekësore të prokuruara nga Koncesionari dhe të përdorura për Projektin, sipas Kërkesave Teknike Minimale, sikurse parashikohet në pjesën përkatëse të ofertës teknike të Koncesionarit, bashkëngjitur në Shtojcën 19 (*Oferta e Koncesionarit*).

"Investitor Kapitali" është çdo person që siguron kapital, hua të nënrenditur dhe mbështetje kapitali, nëse ka të tilla, për Konçesionarin për qëllimet e Projektit.

"Pajisje Ekzistuese" janë në çdo Spital Referues, pajisjet e barazvlershme në natyrë me Pajisjet e siguruara nga Koncesionari.

"EURO" është monedha e ligjshme e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar Europian.

"Stafi Ekzistues" është personeli i punësuar në Datën Efektive nga Spitalet Referuese ose Autoriteti, i angazhuar me punë apo shërbime në laboratorët e Spitaleve Referues.

"FF&E" janë të gjitha instalimet, orenditë dhe pajisjet (duke përfshirë pajisjet alternative të furnizimit me energji elektrike, pajisjet e ventilimit dhe të ajrit të kondicionuar dhe pajisjet kompjuterike), që vendosen në Ambiente, me qëllim kryerjen e Shërbimeve në përputhje me Kërkesat Teknike Minimale, me përjashtim të Pajisjeve.

"Paketa e Financimit" nënkupton kostot e përgjithshme kapitale të Objekteve Laboratorike dhe kostot e lidhura me to si dhe mjetet e financimit të tyre, që përfshijnë kapitalin, borxhin e nënrenditur, huatë, dhe mbështetje për kapitalin, kur ka të tilla.

"Ngjarje e Forcës Madhore" ka kuptimin e dhënë në Nenin 31.

"Akreditimi i DPA-së" është akreditimi i laboratorëve mjekësore nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me standardet e laboratorëve mjekësore që janë në fuqi në periudha të ndryshme.

"Praktika e Mirë e Industrisë" është ushtrimi i zotësisë, korrektesës, maturisë dhe praktikave, metodave, standardeve, procedurave dhe rekomandimeve në një masë të tillë që është në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, të ndjekura përgjithësisht në sektorin e laboratorëve mjekësorë në pronësi dhe administrim privat, në lidhje me projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin (duke përfshirë ofrimin e shërbimeve diagnostikuese mjekësore) dhe mirëmbajtjen e objekteve laboratorike mjekësore, sipas pritshmërive të arsyeshme nga një kontraktor, inxhinier apo Koncesionar i aftë dhe me përvojë, sipas rastit, në rrethana të njëjta apo të ngjashme. Për të shmangur çdo dyshim, Praktikat e Mira të Industrisë përfshijnë, po pa u kufizuar në:

(a) të gjitha udhëzimet dhe rekomandimet e urdhrit të mjekëve të Shqipërisë, nëse ka të tilla, duke përfshirë ato që nuk kanë efekt detyrues ligjor; dhe

(b) Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore mbi Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë e Objekteve Shëndetësore dhe Udhëzimet e Përgjithshme të Grupit të Bankës Botërore mbi Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë.

"Entitet Shtetëror" është (i) Republika e Shqipërisë; (ii) çdo ministri, departament apo; (ii) çdo korporatë, organizatë publike apo subjekt tjetër në pronësi, apo që vepron për llogari të Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, agjenci, departament apo nënndarje politike apo ushtarake e tyre; dhe (iii) çdo gjykatë apo tribunal, apo çdo subjekt tjetër shtetëror, agjenci

apo autoritet nën kontrollin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, departament apo nëndarje politike e tyre, dhe që ka juridiksion sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Koncesionarit, apo çdo Autoritet i pavarur rregullator, në çdo rast brenda Republikës së Shqipërisë. Për qëllimet e këtij përkufizimi, Autoriteti, në cilësinë e tij si Palë në këtë Kontratë, nuk do të konsiderohet si Entitet Shtetëror.

"FSDKSH" është Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

"Përfaqësuesi i FSDKSH-së " është zyrtari i FSDKSH sikurse do t'i bëhet i ditur Koncesionarit me shkrim nga Autoriteti, kohë pas kohe.

"Standardet e Performancës të IFC" janë Standardet e Performancës të IFC mbi Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale, 1 – 4 (përfshirëse), datë 1 Janar 2012 të cilat i janë bërë me dije Koncesionarit dhe ai ka pranuar marrjen dijeni mbi to.

"Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale" janë çdo patentë, model zbatimi, projekt i regjistruar, markë tregtare, e drejtë autori, apo çdo e drejtë tjetër e pronësisë intelektuale (duke përfshirë secilën dhe të gjitha licencat), pavarësisht se ku dhe nëse janë regjistruar apo jo.

"Marrëveshje Ndërveprimi" është marrëveshja e lidhur midis Koncesionarit dhe secilit prej Spitaleve Referuese për çështjet e listuara në Nenin 16.1.

"Buxheti i Laboratorëve PPP" ka kuptimin e dhënë në Nenin 23.1.2 (a).

"Objektet Laboratorike" janë objektet laboratorike në të cilat Koncesionari ofron Shërbimet për Spitalet Referuese sipas specifikimeve të Projektit të përcaktuara në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*) duke përfshirë, sipas rastit, Ambientet, Pajisjet, rrjetin dhe logjistikën dhe të gjitha FF&E-të, dhe **"Objekt Laboratorik"** është çdonjëri prej këtyre mjeteve në një Spital Referues.

"Personel Kyç" është stafi kryesori i identifikuar si Personel Kyç në planin e stafit të përcaktuar në Shtojcën 5 (*Plani i Rekrutimit)* i cili përfshin por nuk kufizohet me: Drejtorin Ekzekutiv, Drejtorin Financiar dhe Drejtorin Teknik të Koncesionarit.

"Anëtar Drejtues" nënkupton **Labopharma SHPK**.

"LEK" është monedha e ligjshme e Republikës së Shqipërisë në datën e kësaj Kontrate.

"Huadhënës" janë të gjithë personat që i ofrojnë financim borxhi Koncesionarit sipas marrëveshjeve të financimit për qëllimet e Projektit.

"Dëmet e Likuidueshme" janë të gjitha shumat që Koncesionari duhet t'i paguajë Autoritetit si shpërblim dëmi në përputhje me Nenin 24.1.

"LIS" ka kuptimin e dhënë në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*).

"Afati i fundit" është data që përkon me plotësimin e afatit 90 (nëntëdhjetë) ditor nga Data Efektive ose çdo datë tjetër për të cilën Palët bien dakord në përputhje me Nenin 4.

"Shërbime Mjekësore" ka kuptimin e dhënë në Nenin 13.3.1.

"Shërbimet e Mjekësisë Ligjore" janë rastet ligjore që kërkojnë ndër të tjera një hetim mjekësor.

"Kërkesa Teknike Minimale" janë kërkesat teknike të listuara në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*), të cilat Koncesionari duhet t'i zbatojë për projektimin dhe shfrytëzimin e Objekteve Laboratorike.

"Ministria e Financave" është ministria përgjegjëse për financat në Republikën e Shqipërisë.

"Njoftim Mospërmbushje" ka kuptimin e dhënë në Nenin 35.1.

"Njoftim për Defekte" ka kuptimin e dhënë në Nenin 11.5.4.

"Penalitetet e Performancës" janë shuma e parave e përllogaritur në përputhje me Shtojcën 14 si një vlerësim real i humbjes që i është shkaktuar Autoritetit nga shkelja e Treguesve të Performancës nga ana e Koncesionarit.

"Treguesit e Performancës" janë treguesit e Performancës që duhen plotësuar ose tejkaluar nga Koncesionari dhe që listohen në Shtojcën 14.

~~**"Garancia e Performancës" ka kuptimin e dhënë në Nenin 26.1.**~~

"Leje" janë të gjitha lejet, autorizimet dhe pëlqimet, të cilat duhen marrë nga çdo Entitet Shtetëror me qëllim që Koncesionari të realizojë Punimet dhe kryejë Shërbimet, një listë indikative (por jo e plotë) e të cilave paraqitetnë Shtojcën 6 (*Lejet*) bashkëngjitur në këtë Kontratë.

"Person" ka kuptimin e një personi fizik ose shoqëri.

"Ligji për PPP-të" ka kuptimin e dhënë në Recitalin A.

"Ambientet" janë, në lidhje me çdo Spital Referues, Lokalet e identifikuara në Shtojcën 11 (*Lokalet*) që do të projektohen dhe/ose rindërtohen nga Koncesionari sipas Kërkesave Teknike Minimale, dhe të cilat do të akomodojnë Objektet Laboratorike.

"Projekti" ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1.

"Marrëveshje të Projektit", do të konsiderohen për Projektin dhe/ose për secilin Objekt Laboratorik, dokumentat e mëposhtme kontraktuale (sipas rastit):

(a) Urdhër Blerje për kontratat e mirëmbajtjes së Pajisjeve,

(b) kontratë (kontrata) projektimi dhe ndërtimi për Punimet,

(c) marrëveshja (marrëveshjet) ndërmjet Koncesionarit dhe Anëtarit Teknik për shërbimet teknike, trajnuese dhe mbështetëse që do të ofrohen nga Anëtari Teknik dhe Sealab SELARL në lidhje me Projektin.

(d) marrëveshja (marrëveshjet) për nënkontraktimin e Shërbimeve ose pjesë të tyre, duke përfshirë marrëveshje shërbimi, marrëveshje administrimi, marrëveshje mirëmbajtjeje dhe marrëveshje shfrytëzimi dhe mirëmbajtjeje, dhe

(e) marrëveshjet në lidhje me Pajisjet e marra me qera

dhe **"Marrëveshja e Projektit"** do të thotë secilën prej tyre më sipër.

"Kalendari i Projektit" është Shtojca që përcakton piketat dhe datat e synuara të Projektit, sikundër përcaktohen në Shtojcën 7 (*Kalendari i Projektit*).

"Ngjarje e Zgjatur e Forcës Madhore" ka kuptimin e dhënë në Nenin 31.3.

"Urdhra Blerjeje" janë gjithë dokumentat, duke përfshirë kontratën e shitjes me garancinë e lidhur, kushtet e përgjithshme të shitjes dhe specifikimet teknike të mallrave të blera në këtë mënyrë, duke evidentuar blerjen e pakthyeshme të secilit artikull të Pajisjeve dhe në përputhje me Kërkesat Teknike Minimale.

"Proçesi i Referimit" është proçesi për referimin e Pacientëve të Referuar (duke përfshirë pacientët e siguruar dhe të pasiguruar) sikurse përcaktohet në Shtojcën 8 (*Proçesi i Referimit*).

"Sistem Referimi" është sistemi i referimit të pacientëve të siguruar dhe të pasiguruar në shërbimet e kujdesit shëndetësor publik në Shqipëri, në bazë të të cilit pacientëve u ofrohen shërbime mjekësore (përfshirë edhe analiza laboratorike) pa pagesë ose me tarifa të zbritura, sipas miratimit me vendim të Ministrit të Shëndetësisë nr. 28 datë 26 Janar 2016.

"Pacient i Referuar" është një pacient (i siguruar apo i pasiguruar) i rekomanduar nga një Mjek Referues për kryerjen e Analizave sipas Shtojcës 8 (dhe që përfshin për të shmangur cdo dyshim si Pacientët e Shtruar të Referuar ashtu edhe Pacientët Ambulatorë të Referuar).

"Pacient i Shtruar i Referuar" është një pacient (i siguruar apo i pasiguruar) i shtruar në një Spital Referues dhe që qëndron në shtrat për më shumë se 24 orë.

"Pacient Ambulator i Referuar" është një pacient ambulator (i siguruar apo i pasiguruar) i rekomanduar nga një Mjek Referues sipas Shtojcës 8.

"Mjek Referues" është personeli i kualifikuar i Spitalit Referues dhe/ose qëndrave të kujdesit shëndetësor parësor që ka të drejtë të kërkojë kryerjen e Analizave për Pacientin e Referuar në përputhje me Shtojcës 8.

"Spitalet Referuese" janë kolektivisht, spitalet e rretheve, qarqeve dhe spitalet terciare të listuara në Shtojcën 9 (*Lista e Spitaleve Referuese*) (të cilët, për të shmangur cdo paqartësi, referime dhe nga qëndrat e kujdesit shëndetësor parësor sipas Shtojcës 8) dhe çdo subjekt i ri që zëvendëson apo plotëson subjektet ekzistuese që përbëjnë Spitalet Referuese në Datën e Nënshkrimit, pavarësisht nëse këto subjekte plotësuese apo zëvendësuese të Spitaleve Referuese janë krijuar dhe do të operojnë në kuadër të një partneriteti publik privat, administrimi publik apo çdo lloj tjetër administrimi; dhe **"Spital Referues"** është secili prej tyre.

"Drejtori i Spitalit Referues" është drejtori/administratori i një Spitali Referues sipas emërimit të tij/saj në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, i cili i bëhet i ditur Koncesionarit me shkrim nga Autoriteti; Drejtorët e Spitaleve Referuese në Datën Efektive për Spitalet Referuese janë paraqitur në Shtojcën 9 (*Lista e Spitaleve Referuese*).

"Propozim Korrigjues" ka kuptimin e dhënë në Nenin 33.2.

"Përfaqësues" është personi (personat) i caktuar prej secilës nga Palët për të kryer funksionet e përcaktuara në Nenin 5.

"Tarifë Shërbimi" është tarifa që i paguhet Koncesionarit nga Spitalet Referuese për Analizat që u bëhen Pacientëve të Referuar në përputhje me listën e çmimeve të përcaktuara në Shtojcën 3 (*Tarifat e Analizave dhe Shërbimeve*).

"**Shërbime**" ka kuptimin e dhënë në Nenin 13.

"**Periudhë Shërbimesh**" është periudha që fillon në Datën Reale të Komisionimit dhe që përfundon me Kohëzgjatjen ose datën e zgjidhjes së parakohshme të Kontratës, cilado qoftë e para.

"**Ortak**" është:

(a) çdo person që ka pjesëmarrje në kapitalin e SPV-së në përputhje me këtë Kontratë, duke përfshirë Anëtarin Drejtues dhe Anëtarin Teknik; ose

(b) secili nga pasardhësit apo përfituesit e të drejtave nëpërmjet cedimit.

"**Kuota**" janë të gjitha klasat e pjesëve të emetuara nga Koncesionari dhe çdo garanci tjetër, e drejtë e kalueshme, ekzistuese apo e ardhme, që i jep të drejtë mbajtësit të saj, menjëherë ose në të ardhmen, me kushte apo jo, me anë të këmbimit, ushtrimit të një opsioni, nënshkrimit, rimbursimit, apo me ndonjë mjet tjetër të besueshëm, për të përfituar interes financiar ose të drejtën e votës tek Koncesionari, si edhe çdo të drejtë tjetër pronësie apo uzufrukti; apo ndonjë të drejtë tjetër e lidhur me Kuotat.

"**Ortak i Rëndësishëm**" nënkupton, për çdo Person, atë që zotëron drejtpërdrejtë të paktën pesë përqind (5%) të Kuotave të Koncesionarit.

"**Lokalet**" janë sheshet, vendet dhe ambientet brenda të gjithë apo disa prej Spitaleve Referuese, siç përcaktohen në Shtojcën 11 (*Lokalet*) në të cilat Koncesionari rinovon dhe përdor Ambientet; "**Lokal**" është secili prej tyre.

"**Data e Dorëzimit të Lokalit**" ka kuptimin e dhënë në Nenin 7.1.2.

"**Softuerë**" janë të gjitha programet që mund të kërkohen, ose që është e përshtatshme të përdoren për realizimin e Shërbimeve në përputhje me këtë Kontratë, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me, programin e regjistrimit të pacientëve, administrimin e të dhënave dhe nxjerrjen e tyre në përputhje me Specifikimet e përcaktuara në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*).

"**SPV**"ka kuptimin që i jepet në Recitalin D.

"**Plani i Rekrutimit**" është plani i marrjes në punë të stafit të Koncesionarit për Projektin siç përcaktohet në Shtojcën 5 (*Plani i Rekrutimit*).

"**E drejta e Ndërhyrjes**" ka kuptimin e dhënë në Nenin 36.

"**Studentë**" ka kuptimin e dhënë në Nenin 13.7.1.

"**Nënkontratë**" është çdo kontratë e lidhur nga Koncesionari dhe një palë e tretë për kryerjen e çdo pjese të Punimeve apo Shërbimeve.

"**Nënkontraktor**" është çdo person që lidh një Nënkontratë me Koncesionarin.

"**Tarifa e Zhvillimit të Projektit**" ka kuptimin e dhënë në Nenin 28.1.

"**Dokumentet e Rilevimit**" janë të gjitha dokumentet e projektimit që fotografojnë situatën e Ambienteve në gjendjen aktuale, skica dhe vizatime skematike të siguruara nga rilevimit matës i Ambienteve (dhe nëse është e rastit, të ndërtesave ku ndodhen Ambientet), të cilat do të kryhen nga Koncesionari rreth Datës Efektive.

"Data e Synuar e Komisionimit" është, për sa u përket të gjithë Objekteve Laboratorike, data e caktuar në Kalendarin e Projektit, brenda të cilës datë, Koncesionari duhet të ketë kryer gjithçka të nevojshme, përfshirë Punimet dhe marrjen e Lejeve, në mënyrë që Objekti Laboratorik të jetë plotësisht i shfrytëzueshëm dhe i gatshëm për ofrimin e Shërbimeve.

"Tatim" është çdo tatim, pagesë, taksë, tarifë, vlerësim, pagim, taksë doganore apo tarifë e çdo lloji të ngarkuar, të vendosur apo vënë, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga një Enitet Shtetëror sipas Ligjit të Zbatueshëm, duke përfshirë çdo tatim për mallra dhe shërbime, tatimin e shitjeve, taksën e pullës, tatimi i importit, tatimin i mbajtur në burim (qoftë mbi të ardhurat, dividendët, pagesat e interesit, tarifa, marrja me qira të pajisjeve apo të tjera), tatimin mbi huatë në monedha të huaja ose transaksionet e këmbimit valutor, tatimin e akcizës, tatimin e pronës, tarifën e regjistrimit apo të licencës, duke përfshirë çdo interes, sanksion apo shtesa të tjera mbi to.

"Anëtar Teknik" nënkupton EXALAB SELARL

"Kohëzgjatje" ka kuptimin e dhënë në Nenin 4.1.

"Njoftim për Përfundim Kontrate" ka kuptimin e dhënë në Nenin 37.3.

"Analiza" janë të gjitha analizat e përcaktuara në Shtojcën 3 (*Analizat dhe Tarifat e Shërbimeve*) që do të realizohen nga Koncesionari në lidhje me Pacientët e Referuar, në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, Praktikën e Mirë të Industrisë dhe Shtojcës 8.

"Kryerje Analizash" do të thotë kryerja e procesit të përgjithshëm ku Koncesionari administron Analizat përkatëse për një Pacient të Referuar dhe paraqet një raport diagnostikues me rezultatet e këtyre Analizave.

"Datë Transferimi" ka kuptimin e dhënë në Nenin 3.1.4.

"Shërbime Komunale" janë të gjitha shërbimet komunale të ofruara nga ofrues palë e tretë (duke përfshirë Entitete Shtetërore të ndryshme nga Autoriteti), që mund të kërkohen për kryerjen si duhet të detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate, përfshirë (i) ujë të nxehtë dhe të flohtë, (ii) largimin e mbetjeve dhe ujërave të zeza, (iii) energjinë elektrike pavarësisht nga voltazhi apo amperazhi), dhe (iv) telekomunikacionin (me zë dhe me të dhëna).

"Ndryshim" ka kuptimin e dhënë në Nenin 30.1.

"Urdhër Ndryshimi" ka kuptimin e dhënë në Nenin 30.4.

"Vëllimi i Lejuar" ka kuptimin e dhënë në Nenin 22.4.3.

"Punime" janë të gjitha punimet e nevojshme të ndërtimit dhe rregullimet e brendshme, duke përfshirë prokurimin dhe instalimin e Pajisjeve dhe prokurimin, blerjen e të gjitha FF&E-ve të kërkuara, për të ndërtuar Ambientet dhe Objektet Laboratorike që të plotësojnë dhe tejkalojnë Kërkesat Teknike Minimale dhe që Koncesionari të kryejë Shërbimet në përputhje me Kontratën.

"Udhëzimet e Përgjithshme Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore" janë dokumentet e referimit teknik të Grupit të Bankës Botërore, datë 30 prill 2007, me shembuj të përgjithshëm dhe specifikë të Praktikave të Mira, sipas sektorëve të ekonomisë, të cilët përmbajnë nivelet e performancës dhe masat që janë zakonisht të

pranuara për IFC-në, një kopje e të cilave i është dërguar Koncesionarit, i cili ka njohur marrjen e tyre.

"Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë për Objektet e Kujdesit Shëndetësor të Bankës Botërore" janë dokumentet e referimit teknik të Grupit të Bankës Botërore, datë 30 prill 2007, me shembuj specifikë të praktikave të mira, sipas sektorëve të ekonomisë, të cilët përmbajnë nivelet e performancës që janë zakonisht të pranueshme për IFC-në, një kopje e të cilave i është dërguar Koncesionarit, i cili ka njohur marrjen e tyre.

1.2 **"Vëllimi total i investimit të ri kapital", përfshin shpenzimin kapital kryesor të mirëmbajtjes dhe të zëvendësimit, përllogaritur paraprakisht sipas pikës 2.4.2 të DST në vlerën 10.3 milion Euro pa TVSH. Rregullat e interpretimit**

Përveç se kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe:

(a) fjalët e përdorura për një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër;

(b) termat "të kësaj", "këtu", "kështu", "bashkëngjitur" dhe fjalë të ngjashme i referohen të gjithë kësaj Kontrate dhe jo ndonjë Neni, Aneksi, Shtojce, ose Shtojcave apo ndonjë ndarjeje tjetër të kësaj Kontrate;

(c) referencat ndaj Shtojcave dhe Lidhjeve u referohen Shtojcave dhe Lidhjeve të Shtojcave të kësaj Kontrate, përveç se kur është rënë dakord ndryshe nga Palët;

(d) referencat ndaj çdo miratimi përfshijnë çdo ndryshim apo ri-miratim të atij miratimi dhe ndaj çdo rregulli apo rregulloreje të bërë në përputhje me atë miratim; dhe referencë ndaj një lidhje do të thotë referencë ndaj këtij ligji ashtu si mund të jetë ndryshuar apo rimiratuar;

(e) fjalët "përfshijnë" ose "duke përfshirë" konsiderohen se pasohen nga fjalët "pa kufizim", ose "por jo të kufizuar/a", pavarësisht nëse ndiqen apo jo nga fraza apo fjalë të tilla me këtë kuptim;

(f) referencat ndaj "kësaj Kontrate", ose çdo Kontrate ose dokumenti tjetër interpretohen si referenca ndaj një marrëveshje apo dokumenti të tillë, të ndryshuar, të modifikuar apo plotësuar dhe në fuqi herë pas here dhe përfshijnë një referencë ndaj çdo dokumenti që ndryshon, modifikon, apo e plotëson atë, apo që nënshkruhet, bëhet apo jepet sipas, apo në përputhje me kushtet e saj;

(g) sa herë që kjo Kontratë i referohet një numri "ditësh", një numër i tillë u referohet ditëve kalendarike, përveç se kur kjo gjë u referohet "ditëve të punës", rast në të cilin një referencë e tillë bëhet për ditët në të cilat bankat dhe zyrat shtetërore janë të hapura për biznesot në Republikën e Shqipërisë;

(h) çdo referencë ndaj një "muaji" apo "një viti" interpretohet si referencë ndaj një periudhe që fillon në një ditë, përkatësisht, në muajin kalendarik apo vitin kalendarik sipas kalendarit Gregorian, dhe që përfundon përkatësisht në ditën korresponduese të muajit apo vitit tjetër kalendarik të kalendarit Gregorian, përveç kur nuk ka një ditë numerike korresponduese në muajin kur mbaron periudha, ajo periudhë mbaron në ditën e fundit të atij muaji kalendarik;

(i) çdo fjalë, term, frazë dhe shkurtim me germë të madhe, i përdorur posaçërisht në secilën prej Shtojcave, në një Shtojcë, apo në ndonjë Lidhje të ndonjë Shtojce, ose në një Shtojcë ka kuptimet e parashikuara në Shtojcat apo Lidhjet, sipas rastit;

(j) në rastin e ndonjë mospërputhje midis fjalës me germë të madhe, termit, frazës apo shkurtimit të përkufizuar, të parashikuar në Nenin 1.1 dhe të çdo dispozite, fjale me germë të madhe, fraze apo shkurtimi të përcaktuar në këtë Kontratë, në çdo Shtojcë tjetër, apo në një Lidhje të një Shtojcë, kuptimi i parashikuar në Nenin 1.1 ka përparësi ndaj kuptimit të përcaktuar në ndonjë Shtojcë tjetër, apo në një Lidhje të një Shtojce, përveçse kur konteksti i kësaj Kontrate e kërkon ndryshe;

(k) referencat ndaj një "pale" ose një "personi" përfshijnë referencat ndaj asaj pale apo pasardhësve dhe përfituesve të ligjshëm të të drejtave të atij personi nëpërmjet cedimit; dhe

(l) titujt e Neneve dhe Kapitujve në këtë Kontrate dhe Përmbajtja janë vetëm për lehtësi përdorimi dhe qëllime Referimi dhe në asnjë mënyrë nuk prekin interpretimin e kësaj Kontrate.

"1.3 **Dokumentacioni i Kontratës dhe rendi i përparësive**

1.3.1 **Kjo Kontratë përbëhet nga:**

(a) Teksti i kësaj Kontrate, duke përfshirë hyrjen e saj; dhe

(b) Shtojca dhe Lidhjet e Shtojcave, që janë pjesë përbërëse e saj, te renditura me poshte:

SHTOJCA 1. ANËTARËT E KONSORCIUMIT
SHTOJCA 2. MEKANIZMI I RAPORTIMIT
SHTOJCA 3. ANALIZAT DHE TARIFAT E SHËRBIMIT
SHTOJCA 4. KËRKESAT TEKNIKE MINIMALE
SHTOJCA 5. PLANI I REKRUTIMIT
SHTOJCA 6. LEJET
SHTOJCA 7. KALENDARI I PROJEKTIT
SHTOJCA 8. PROCESI I REFERIMIT
SHTOJCA 9. LISTA E SPITALEVE REFERUESE
SHTOJCA 10. STRUKTURA E PRONËSISË SË KONCESIONARIT
SHTOJCA 11. LOKALET
SHTOJCA 12. FORMA E MARRJES PËRSIPËR TË DETYRIMEVE
SHTOJCA 13. KOMISIONIMI
SHTOJCA 14. TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE PENALITETET
SHTOJCA 15. FORMA E GARANCISË SË PERFORMANCËS
SHTOJCA 16. SIGURIMET E KËRKUARA
SHTOJCA 17. DORËZIMI ME FAZA I LOKALEVE
SHTOJCA 18. PROCEDURAT E SISTEMIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (ESMS)
SHTOJCA 19. OFERTA E KONCESIONARIT
SHTOJCA 20. STANDARTET E SHËRBIMIT

1.3.2 Në rastin e një konflikti midis tekstit të kësaj Kontrate dhe Shtojcave, Palët përpiqen, në rastin e parë, ta zgjidhin konfliktin duke e lexuar këtë Kontratë si një të tërë dhe dispozita që është më specifike do të jetë dispozita rregulluese. Nëse konflikti vazhdon të ekzistojë pavarësisht nga përpjekjet me qëllim të mirë të Palëve për ta zgjidhur atë, sikurse parashikohet në fjalinë paraprake,

ntëherë, për qëllimet e zgjidhjes së një konflikti të tillë, dispozitat e tekstit të kësaj Kontratë kanë përparësi ndaj çdo gjëje tjetër dhe Shtojca 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*) ka përparësi ndaj të gjitha Shtojcave të tjera."

2. KONCESIONARI

2.1 Deklarimet dhe garancitë e Koncesionarit

Që nga Datën Efektive dhe gjatë gjithë Kohëzgjatjes, Koncesionari deklaron dhe garanton se:

(a) është i organizuar rregullisht, ekziston ligjërisht dhe është aktiv, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

(b) ka të drejta të plota dhe autoritet për të nënshkruar, përmbushur dhe kryer detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe Marrëveshjeve të tjera të Projektit;

(c) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, përmbushjen dhe realizimin e kësaj Kontrate dhe Marrëveshjeve të tjera të Projektit;

(d) nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate dhe/ose përmbushja e secilit prej detyrimeve të Koncesionarit, sikurse përcaktohen në këtë Kontratë nuk do të shkelë asnjë nga (i) Ligjet e Zbatueshme për Koncesionarin, (ii) statutin e tij, aktet nënligjore apo dokumente të tjera të shoqërisë tregtare që janë detyruese për të dhe/ose (iii) çdo kontratë të zbatueshme nënshkruar prej tij;

(e) kjo Kontratë përbën ndaj tij detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues, të zbatueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e saj; dhe detyrimet e tij në këtë Kontratë do të jenë ligjërisht të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj;

(f) ai dhe cdo Ortak i Rëndësishëm (dhe në dijeninë e tij cdonjëri prej Personave të Lidhur) ka zbatuar Ligjin e Zbatueshëm në të gjitha aspektet e rëndësishme dhe nuk ka qenë subjekt i ndonjë gjobe, ndëshkimi, urdhëri për sigurim padie, ose i çdo përgjegjësie tjetër civile apo penale që së bashku kanë apo mund të kenë një efekt të rëndësishëm negativ në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Kontrate;

(g) SPV do të jetë një subjekt tregtar me qëllim të vecantë dhe aktiviteti tregtar që lejohet të ushtrojë do të kufizohet në atë që është e nevojshme dhe e përshtatshme për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate;

(h) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm nuk është në proçes falimentimi apo likuidimi;

(i) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm (apo, në dijeninë e tij, asnjë nga Personat e lidhur të tij apo Personat e Lidhur të tyre) nuk është dënuar për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë apo pastrim parash, ose për një vepër penale të kryer gjatë përmbushjes së detyrave profesionale;

(j) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm (apo, në dijeninë e tij, asnjë nga Personat e lidhur të tij apo Personat e Lidhur të tyre) nuk është subjekt i ndonjë hetimi penal për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim të fshehtë, apo pastrim parash, dhe asnjë prej Personave të mësipërm nuk ka qenë objekt i akuzave të besueshme dhe/ose të vazhdueshme në lidhje me aktivitete të tilla kriminale, në asnjë rast, në datën e dorëzimit të ofertës së Koncesionarit për Projektin dhe për tre (3) vitet përpara dorëzimit të një oferte të tillë;

(k) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm (apo, në dijeninë e tij, asnjë nga Personat e lidhur të tij apo Personat e Lidhur të tyre) nuk është përjashtuar apo skualifikuar nga ndonjë tender apo proces prokurimi publik në Republikën e Shqipërisë në datën e dorëzimit te ofertës së Koncensionarit për Projektin dhe për tre vitet përpara dorëzimit të ofertës;

(l) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm (apo, në dijeninë e tij, asnjë nga Personat e lidhur të tij apo Personat e Lidhur të tyre) nuk është përjashtuar në bazë të listës të sanksioneve publike të ndonjë banke shumëpalëshe për zhvillim që është palë në Marrëveshjen për Zbatimin e Vendimit për Përjashtim të 9 prillit 2010 (www.crossdebarment.org), si edhe asnjë nga Personat e mësipërm nuk është përfshirë në ndonjë listë sanksionesh të shpalluar nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo Komitetet e tij, apo në ndonjë listë tjetër sanksionesh, e njohur në shkallë ndërkombëtare, ose në ndonjë farë mënyre tjetër, përfshirë në aktivitete (drejtpërdrejt apo përmes një filiali) që nuk janë në përputhje me sanksionet e shpallura nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, apo Komitetet e tij, apo sanksione kombëtare në Republikën e Shqipërisë;

(m) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm nuk ka patur detyrime të pashlyera tatimore, detyrime të sigurimeve shoqërore apo detyrime në lidhje me aktgjykime të dhëna në procese penale apo administrative (me përjashtim të rastit kur provigjionuar detyrime të tilla në përputhje me rregulloret e zbatueshme të kontabilitetit), në asnjë rast, në datën e paraqitjes së Ofertës së Koncesionarit për Projektin dhe për tre (3) vitet e fundit përpara dorëzimit të saj; dhe

(n) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm nuk ka ndonjë konflikt interesi apo ndonjë konflikt të mundshëm interesi që buron nga kontrata, marrëveshje apo marrëdhënie të mëparshme apo ekzistuese, që prekin apo mund të prekin përfshirjen e mundshme të tij në Projekt.

(o) as ai, as ndonjë prej Ortakëve të tij të Rëndësishëm, apo Personat e Lidhur nuk kanë kryer në lidhje me Projektin, ndonjë veprim korruptiv, mashtrues, marrëveshje të fshehtëapo shtrënguese, dhe as veprime të tjera që shkelin ndonjë Ligj të Zbatueshëm.

2.2 Pronësia e Koncesionarit – kufizime në kalimin e Kuotave

2.2.1 Koncesionari përfaqëson dhe garanton Autoritetin se, në datën e Fillimit të Kontratës, pronësia ligjore dhe interesat mbi Kuotat e SPV-së do të jenë sipas përcaktimit në Shtojcën 10 (*Struktura e Pronësisë së Koncesionarit*).

2.2.2 Koncesionari merr përsipër se deri në datën që bie jo më herët se 3 vjet nga Data Reale e Komisionimit të Objektit të fundit Laboratorik të përfunduar dhe komisionuar sipas Shtojcës 7 (*Kalendari i Projektit*), Anëtari Drejtues do të zotërojë në menyrë të drejtpërdrejtë të paktën gjashtëdhjetë përqind (60%) të Kuotave të Koncesionarit.

2.2.3 Koncesionari merr përsipër se deri në një datë që bie jo më herët sesa (i) 3 vjet nga Data Reale e Komisionimit të Objektit të fundit Laboratorik të përfunduar dhe komisionuar sipas Shtojcës 7 (*Kalendari i Projektit*) (ii) akreditimit të të gjithë Laboratorëve sipas ISO 15189 siç kërkohet në Shtojcën 20 (*Standardet e Shërbimit*), Neni 1.11, Anëtari Teknik do të zotërojë të paktën dyzet për qind (40%) të Kuotave të Koncesionarit në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

2.2.4 Përveç kufizimit në Nenet 2.2.2 dhe 2.2.3 më sipër, Ortakët mund të shesin, transferojnë, kalojnë, apo ndryshe disponojnë të gjitha apo një pjesë të Kuotave vetëm me miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit dhe Ministrisë së Financave, miratim i cili nuk mund të mbahet apo vonohet pa shkaqe të arsyeshme. Koncesionari paraqet të

gjitha veçoritë e transaksionit që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti dhe/ose Ministria e Financave.

2.2.5 Mosrespektimi nga Koncesionari i Nenit 2.2 përbën një Rast Mospërmbushjeje të detyrimeve nga ana e Koncesionarit.

3. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

3.1 Detyrimet e përgjithshme të Koncesionarit

3.1.1 **Koncesionari do të:**

(a) përgatisë të gjitha Dokumentet e Projektimit dhe do të kryejë Punimet;

(b) financojë, prokurojë, instalojë dhe mirëmbajë Pajisjet;

(c) ndërtojë rrjetin e shtresëzuar dhe logjistikën e lidhur me të për realizimin e Shërbimeve;

(d) do të punësojë personelin;

(e) do të administrojë dhe shfrytëzojë Objektet Laboratorike dhe realizojë Shërbimet; dhe

(f) dorëzojë Objektet Laboratorike tek Autoriteti ose një palë e tretë e caktuar nga Autoriteti, me mbarimin e Kohëzgjatjes apo zgjidhjen e parakohshme të saj, cilado qoftë më e para,

të gjitha në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe kushtet e Kontratës ("**Projektit**").

3.1.2 Koncesionari nuk do të reklamojë Objektet Laboratorike apo ndonjë pjesë të tyre në ndonjë mënyrë të tillë që reklamon, afishon apo pasqyron emrin e Autoritetit, përveçse sikundër Autoriteti do të pranojë me shkrim. Koncesionari nuk do të pretendojë në asnjë mënyrë që Analizat e ofruara nga Koncesionari në Objektet Laboratorike të jenë të miratuara nga Autoriteti përsa i takon cilësisë apo cdo qëllimi tjetër dhe Koncesionari është i vetmi përgjegjës për cilësinë e Analizave të kryera në Objektet Laboratorike.

3.1.3 **Koncesionari:**

(a) nuk mund të nënshkruajë kontrata me Filialet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit. Autoriteti mund të kundërshtojë kontratën e propozuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune në rast se ka pretendime të bazuara (përfshirë pretendime per dënime apo hetime penale) rreth integritetit të Filialit, përndryshe pëlqimi konsiderohet si i dhënë;

(b) nuk mund të ndryshojë kontratat që duhet të miratohen nga Autoriteti sipas Nenit 4.2.2 (d) të Kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit. Autoriteti mund të kundërshtojë me shkrim, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune, nëse ka pretendime të bazuara në lidhje me ndryshimet e propozuara dhe integritetin e palës tjetër (përfshirë shqetësime që vijnë nga dënime apo hetime penale), përndryshe pëlqimi do të konsiderohet si i dhënë;

(c) duhet të njoftojë Autoritetin për çdo kontratë të re që lidhet nga Koncesionari; Autoriteti mund të kundërshtojë palën tjetër të kontratave të njoftuara brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nëse ka pretendime të bazuara (përfshirë ato që vijnë nga dënime apo

hetime penale) lidhur me integritetin e saj, osc në të kundërt pala tjetër do të konsiderohet si e pranuar.

3.1.4 Ndërkohë që është Koncesionari ai që lidh këtë Kontratë me Autoritetin, Palët pranojnë se në bazë të Nenit 4.2.2 (a) Koncesionari duhet të krijojë SPV-në e cila do të zbatojë këtë Kontratë në vend të Koncesionarit. Për këtë qëllim, në datën e regjistrimit të SPV-se në regjistrin tregtar të Shqipërisë ("Data e Transferimit"), të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj Kontrate do t'i transferohen SPV-së, për pasojë, përvec rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, SPV-ja do të bëhet Palë e Kontratës dhe do të zëvendësojë Koncesionarin. Koncesionari garanton se kërkesat e kësaj Kontrate do të përfshihen në dokumentet themelore të SPV-së. Të gjithë anëtarët e konsorciumit mbajnë përgjegjësi të përbashkët dhe individuale për të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e Koncesionarit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Pavarësisht krijimit të SPV, SPV-ja dhe Koncesionari janë përgjegjës në mënyrë solidare për përgjegjësitë dhe detyrimet në përmbushjen e kontratës gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj për aq kohë sa do të jenë ortakë/aksionerë në SPV.

Pas Zëvendësimit të Koncesionarit me SPV-në në Datën e Transferimit,

(a) të gjitha referencat për Koncesionarin do të bëhen referenca për SPV-në me përjashtim të Neneve 2.1, 2.2.1, 3.1.4, 3.2.1 dhe 4, të cilat do të vazhdojnë të mbeten detyruese edhe për Koncesionarin por Nenet 2.1 dhe 3.2.1 do të mbeten detyruese për Koncesionarin deri në Datën e Transferimit;

(b) Koncesionari do të shkarkohet nga të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kontrata, përveç detyrimeve në ngarkim të tij por të papërmbushura, shkeljeve ekzistuese të kësaj Kontrate nga ana e Koncensionarit dhe për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Nenet 2.1, 2.2, 3.1.4, 3.2.1 dhe 4 në përputhje me Nenin 3.1.4 (a) më lart.

(c) Nenet 18 (Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale), 34 (Rastet e Mospërmbushjes) 35 (Periudha e Korrigjimit dhe Përfundimi në Lidhje me një Rast Mospërmbushje) 37 (Përfundimi i Parakohshëm), 38 (Pagesat e Përfundimit të Parakohshëm), 42 (Ligji i Zbatueshëm), 43 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve), 49 (Njoftimet), dhe dispozitat e këtyre neneve të zbatohen për Koncesionarin dhe jo për SPV-në, me kusht që Nenet 34 (Rastet e Mospërmbushjes) 35 (Periudha e Korrigjimit dhe Përfundimi në Lidhje me një Rast Mospërmbushje) 37 (Përfundimi i Parakohshëm), 38 (Pagesat e Përfundimit të Parakohshëm), do të zbatohen për Koncesionarin dhe jo për SPV vetëm nëse ngjarja në fjalë do të ndodhë përpara Datës së Fillimit apo, në lidhje me Nenet 2.1 dhe 3.2.1 përpara Datës së Transferimit.

(d) Partneriteti publik privat mund të përfshijë krijimin e një subjekti për qëllime të veçanta (SPV) me kapital të përzier, që zotërohet bashkërisht nga partneri publik dhe privat"

3.2 Detyrimet e Koncesionarit në lidhje me çështjet e integritetit

3.2.1 Si në Datën Efektive dhe gjatë gjithë Kohëzgjatjes, Koncesionari:

(a) nuk do të autorizojë, lejojë apo tolerojë që asnjë Entitet i Kontrolluar apo Personel Kryesor të përfshihet në ndonjë veprim korruptiv, mashtrues, apo detyrues;

(b) do të zhvillojë dhe mundësojë një sistem kontrolli të brendshëm të projektuar për të garantuar përputhshmërinë me Ligjin e aplikueshëm kundër mashtrimit dhe korrupsionit, sistem i cili do të përfshijë minimalisht:

(i) një politikë të shprehur qartë kundër mashtrimit dhe korrupsionit, përfshirë hollësi për veprimet që ndalohen dhe pasojat e shkeljeve;

(ii) procedurat dhe kontrollet (përfshirë kontrollet e kontabilitetit) të hartuara për zbulimin dhe parandalimin e shkeljeve;

(iii) procedurat e kontrollit për të verifikuar Entitetet e Kontrolluara, Marrëveshjet e Projektit, nën-kontratat për Shërbimet Ndihmëse në bazë të Nenit 41.1., dhe Personelin Kryesor që punëson per zbatimin e Projektit;

(iv) caktimin e përgjegjësive për një ose më shumë persona që janë pjesë e Personelit Kryesor të Koncesionarit për zbatimin dhe mbikëqyrjen e përputhshmërisë me politikat, standardet dhe procedurat, duke i dhënë këtyre personave autoritetin dhe detyrimin për të raportuar shkeljet e kryera apo të dyshuara drejtpërdrejt tek drejtuesit e lartë të Koncesionarit;

(v) një program trajnimi për kriteret që duhet të plotësojnë punonjësit e tij dhe punonjësit e Entiteve të Kontrolluar prej tij, të cilët kryejnë punë për këtë Projekt me qëllim garantimin e përmbushjes së kërkesave;

(vi) një sistem efektiv raportimesh për të mbështetur ata të cilët me mirëbesim raportojnë shkeljet e dyshuara, kriminale apo dhe shkelje të tjera;

(vii) procedura të përshtatshme disiplinore për të adresuar/denoncuar, ndërmjet të tjerave, shkeljet; dhe

(viii) testim periodik të standarteve te përputhshmërisë, procedurave, financave dhe të të dhënave, për të vlerësuar efektivitetin e tyre në zbulimin dhe reduktimin e shkeljeve.

Koncesionari pranon se, me kërkesë të Autoritetit, dhe në çdo rast jo më pak se një herë në vit, të hartojë një raport të hollësishem rreth zbatimit dhe përputhshmërisë me sistemin e kontrolleve të brendshme të detajuara në këtë Nen 3.2.

3.3 Të drejtat e Koncesionarit

3.3.1 Duke pasur parasysh detyrimet e Koncesionarit në këtë Kontratë:

(a) Autoriteti do t'i garantojë Koncesionarit, dhe do të detyrojë Spitalet Referuese që t'i garantojnë Koncesionarit, të drejtat mbi Lokalet dhe Ambientet e përcaktuara në Nenin 8 nga Data e Dorëzimit të Lokaleve deri në mbarim të Kohëzgjatjes apo datën e zgjidhjes së parakohshme të kësaj Kontrate;

(b) Autoriteti do t'i japë dhe do të detyrojë Spitalet Referuese që t'i japin Koncesionarit, nga Data Reale e Komisionimit të Objektit Laboratorik në Spitalin përkatës Referues, ekskluzivitetin për ofrimin e Shërbimeve tek Pacientët e Shtruar të Referuar dhe Pacientët e Urgjencës të Spitalit Referues, përveçse sikundër parashikohet në Nenin 3.3.2; Në lidhje me Pacientët Ambulatorë të Referuar, Autoriteti nuk mund t'i japë ekskluzivitet Koncesionarit për sa kohë që Pacientët Ambulatorë të Referuar janë të lirë të kryejnë Analiza me shpenzimet e kostot e tyre nga ofrues të tjerë të shërbimeve laboratorike por, në asnjë rast

Autoriteti nuk mund të kontraktojë Shërbime nga ofrues të tretë të shërbimeve laboratorike për Pacientët Ambulatorë të Referuar.

Analizat e kryera nga spitale private në Shqipëri si pjesë e protokollit për ndërhyrjet dhe/ose shërbimet e trajtimit mjekësor të specializuar të financuara nga FSDKSH, në përputhje me vendimet e kohëpaskohshme të Këshillit të Ministrave, janë të përjashtuara nga Shërbimet.

(c) Autoriteti do të detyrojë Spitalet Referuese të paguajnë Tarifën e Shërbimeve në mënyrën dhe afatin e përcaktuar; dhe

(d) me përjashtim të matësave të gazit në gjak, Autoriteti dhe/ose çdo subjekt publik (duke përfshirë Spitalet Referuese) nuk do të shfrytëzojë (qoftë (i) drejtpërdrejt ose (ii) me anë të ndonjë rregullimi administrativ me çdo Entitet tjetër Shtetëror, ose (iii) me anë të një Kontrate kontraktuale apo rregullim të përafërt me një palë tjetër të ndryshëm nga Koncesionari), ndonjë objekt laboratorik për realizimin e ndonjë prej shërbimeve të ofruara nga Koncesionari, dhe çdo Pajisje Ekzistuese do të trajtohet në përputhje me Nenin 3.3.5 më poshtë.

3.3.2 Pavarësisht nga sa më sipër dhe me përjashtim të rasteve të parashikuara në Nenin 13.3.3 dhe 22.4 më poshtë, Spitalet Referuese kanë të drejtë të rekomandojnë pacientët e tyre tek palë të treta që ofrojnë shërbime laboratorike mjekësore për kryerjen e Analizave të Pacientëve të Referuar për të cilët Koncesionari, për çfarëdo arsye, ka refuzuar shprehimisht ofrimin e Shërbimeve.

3.3.3 Koncesionari nuk ka të drejtë t'u shërbejë pacientëve të tjerë përveç Pacientëve të Referuar nga Mjekët Referues në përputhje me Shtojcën 8.

3.3.4 Autoriteti deklaron dhe garanton se Sistemi i Referimit të pacientëve dhe rrjedhimisht, pagesa e Tarifës së Shërbimit tek Koncesionari për Pacientët e Referuar (qofshin ata të siguruar, të pasiguruar, të shtruar në spital apo ambulatorë), është në cdo aspekt të rëndësishëm, në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

3.3.5 Në çdo Spital Referues në Lokalet e të cilit janë instaluar Pajisje Ekzistuese në Datën Efektive, Koncesionari me miratimin paraprak të Autoritetit, do të sigurojë disponimin ose transferimin e këtyre Pajisjeve Ekzistuese përpara Datës Reale të Komisionimit për secilin Objekt Laboratorik, në cdo mënyre që e gjykon të përshtatshme, me kostot dhe shpenzimet e tij, duke përfshirë edhe transferimin e tyre jashtë Spitalit Referues, përveç nëse Autoriteti vendos përmes njoftimit me shkrim për Koncesionarin që të mbajë ndonjë Pajisje Ekzistuese ose pjesë të tyre në të cilin rast, Autoriteti me shpenzimet e tij do të marrë masa për çmontimin dhe transferimin e Pajisjeve Ekzistuese apo pjesëve të tyre jashtë Spitalit Referues brenda afatit të përcaktuar në Shtojcën 17.

3.4 Risqet e lidhura me Projektin

3.4.1 Pa cënuar asnjë dispozitë të shprehur në këtë Kontratë, Koncesionari pranon se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, ai, pas një shqyrtimi të plotë dhe të kujdesshëm ka bërë një vlerësim të pavarur të kësaj Kontrate (duke përfshirë Shtojcat e saj dhe në veçanti Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*), të Lokaleve si edhe të gjithë informacionit të ofruar nga Autoriteti, dhe ka përcaktuar sipas gjykimit të tij të përshtatshëm, shkallën e vështirësive, risqet dhe rreziqet që mund të krijohen ose me të cilat mund të përballet Koncesionari gjatë përmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate.

Gjithashtu, Koncesionari njeh, dhe si rrjedhojë pranon rrezikun e pamjaftueshmërisë, gabimin apo fajin në lidhje me ndonjë prej çështjeve të parashikuara në Nenin 3.4.1 më lart

dhe në këtë mënyrë konfirmon se Autoriteti nuk mban asnjë përgjegjësi përpara Koncesionarit në lidhje me to.

3.4.2 Koncesionari kupton dhe pranon se Shërbimet që ai detyrohet të kryejë sipas kësaj Kontrate përbëjnë akte mjekësore, të cilat mund të shkaktojnë përgjegjësi profesionale për Koncesionarin dhe për pjesëtarë të veçantë të stafit të tij dhe se, asgjë në këtë Kontrate nuk do të interpretohet si transferim i përgjegjisë për Shërbimet ndaj palëve të treta tek Autoriteti apo ndonjë prej Spitaleve Referuese.

4. KOHËZGJATJA DHE KUSHTET PARAPRAKE

4.1 Hyrja në fuqi – Kohëzgjatja

Kjo Kontratë është e vlefshme nga Data Efektive. Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të kryer Punimet dhe ofruar Shërbimet janë të kushtëzuara nga Data e Fillimit. Kjo Kontratë do të mbetet në fuqi për (i) dhjetë (10) vjet nga Data Reale e Komisionimit të Objektit të fundit Laboratorik të përfunduar dhe komisionuar sipas kësaj Kontrate ose (ii) dhjetë (10) vjet nga Data e Synuar e Komisionimit, cilado të jetë data më e hershme ("**Kohëzgjatja**") përveç nëse ajo zgjidhet në mënyrë të parakohshme në përputhje me kushtet e saj.

4.2 Kushtet Paraprake

4.2.1 Palët do të sigurohen që kushtet e parashikuara në këtë Nen të plotësohen, apo Palët të kenë hequr dorë prej tyre, jo më vonë se Afati i Fundit.

4.2.2 Koncesionari do të sigurohet që kushtet e mëposhtme të jenë plotësuar ose prej tyre të jetë hequr dorë nga Autoriteti (me përjashtim të kushteve (a) deri në (e) prej të cilave Autoriteti nuk mund të heqë dorë), sa më shpejt që të jetë e mundur pas Datës Efektive dhe, në çdo rast jo më vonë se Afati i Fundit ("**Kushtet në Favor të Autoritetit**"):

(a) Koncesionari të ketë krijuar SPV-në dhe t'i ketë dorëzuar Autoritetit dokumentet e mëposhtme:

i. Kopjet autentike dhe të plota të (x) statutit (të miratuara në formë dhe në përmbajtje nga Autoriteti përpara Datës Efektive) dhe certifikatës së regjistrimit të SPV-së pranë regjistrit tregtar dhe (y) vendimet e miratuara nga ortakët e SPV-së që autorizojnë zbatimin e kësaj Kontrate nga SPV-ja.

ii. emrat dhe kredencialet e Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit Financiar dhe Drejtorit Teknik të Koncesionarit të cilët, sipas pëlqimit të arsyeshëm të Autoritetit, të jenë të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme për të menaxhuar dhe drejtuar Koncesionarin dhe Projektin, mos kenë precedentë penalë dhe mos jenë duke u hetuar për sjellje kriminale.

(b) Koncesionari të ketë paguar ndaj IFC Tarifën e Zhvillimit të Projektit IFC-së në përputhje me Nenin 28;

(c) Koncesionari të ketë dorëzuar informacion në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për Autoritetin mbi Paketën e Financimit të vendosur për qëllimet e Projektit ku do të jenë specifikuar kontributet përkatëse të kapitalit të Ortakëve, duke e shoqëruar me veprime bankare që mbështesin kapitalin, kontrata huamarrje si dhe dokumente të tjera që provojnë besueshmërinë e Paketës së Financimit;

(d) Koncesionari të ketë dorëzuar në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për Autoritetin, Marrëveshjet materiale të Projektit, tek të cilat është apo pritet të bëhet palë, përfshirë:

- një kopje të marrëveshjes të shërbimeve teknike (ose një instrument të ngjashme) ndërmjet Koncesionarit dhe Anëtarit Teknik, në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për Autoritetin, ku tregohet se Anëtari Teknik do të ofrojë shërbime teknike, trajnuese dhe vendosje në dispozicion të stafit deri në një datë që bie (i) 3 vjet nga Data Reale e Komisionimit të Objektit të fundit Laboratorik të përfunduar dhe komisionuar sipas Shtojcës 7 (*Kalendari i Projektit*) dhe (ii) të gjithë Laboratorët janë akreditуar sipas ISO 15189 siç kërkohet në Shtojcën 4 (*Kërkesat Minimale Teknike*),

- një kopje të kontratës ndërmjet Koncesionarit dhe Sealab SELARL ose një letër angazhimi nga Labexa Group (kompania mëmë e Anëtarit Teknik dhe Sealab SELARL) në lidhje me ekspertizën për shërbime histopatologjike, të cilat do të kryhen nga Sealab SELARL në përputhje me Letrën e Konfirmimit dhe Angazhimit të lëshuar nga Labexa Group më 9 Shkurt 2017, bashkëngjitur në Shtojcën 19;

(e) Koncesionari të ketë dorëzuar Garancinë e Performancës, të ekzekutuar rregullisht në përputhje me Nenin 26;

(f) Koncesionari të ketë caktuar Përfaqësuesin e tij në Komitetin Ndërlidhës;

(g) brenda tridhjetë (30) ditëve nga Data Efektive, Koncesionari të ketë kryer rilevimin matës të Ambjenteve dhe t'i ketë dorëzuar Autoritetit dhe Spitaleve përkatës Referues kopje autentike dhe të plota të Dokumenteve të Rilevimit; dhe

(h) Koncesionari të ketë dorëzuar planin e dorëzimit me faza të Lokaleve, në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për Autoritetin, në përputhje me Shtojcën 17 (*Dorëzimi me Faza i Lokaleve*), i cili pas përfundimit do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Koncesionari do të informojë Autoritetin menjëherë sapo gjykon se është në gjendje të përmbushë kushtet e mësipërme (me përjashtim të atyre prej të cilave Autoriteti ka hequr dorë me shkrim).

4.2.3 Autoriteti do të përmbushë apo do të bëjë të mundur që të përmbushen kushtet e mëposhtme (nëse këto nuk janë përmbushur akoma në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate) (**"Kushtet në Favor të Koncesionarit"**):

(a) mirëmbajtjen e Tavanit të Buxhetit Vjetor për vitin e parë të shfrytëzimit të Projektit, në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm;

(b) njoftimin e Përfaqësuesit të Autoritetit dhe Përfaqësuesit të FSDKSH-së tek Koncesionari;

(c) miratimin e një urdhëri nga ministri që përfaqëson Autoritetin, në bazë të të cilit të gjithë Spitalet Referuese dhe FSDKSH-ja urdhërohen dhe udhëzohen të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse në Kontratë gjatë Kohëzgjatjes së saj;

(d) me miratimin e urdhrit të parashikuar në Nenin 4.2.3 (c) më lart, njohjen dhe marrjen përsipër nga Spitalet Referues dhe FSDKSH të detyrimeve përkatëse të tyre sipas kësaj Kontrate me anë të nënshkrimit të një deklarate sipas përmbajtjes së Shtojcës 12 (*Forma e Marrjes Përsipër të Detyrimeve)*, deklaratë kjo e cila bëhet pjesë integrale e kësaj Kontrate;

Autoriteti do të informojë Koncesionarin sapo të gjykojë se është në gjendje të përmbushë kushtet e mësipërme.

4.2.4 Data efektive e kesaj kontrate (kur edhe hyn ne fuqi) do të jetë data e nënshkrimit të kësaj kontrate në mënyrë të rregullt nga të dy palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe publikimit ne Fletoren Zyrtare.

Palët do të takohen më pas për të dëshmuar përmbushjen e kushteve të mësipërme dhe do të nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët për këtë qëllim. Data e nënshkrimit të deklaratës së përbashkët do të quhet si "Data e Fillimit". Të drejtat dhe detyrimet e palëve për të kryer Punimet dhe ofruar Shërbimet janë të kushtëzuara dhe fillojnë nga Data e Fillimit.

4.3 Pasojat e Mosplotësimit të Kushteve Paraprake brenda Afatit

4.3.1 Në rastin kur kushtet e vetme që nuk janë përmbushur, apo nga të cilat nuk është hequr dorë brenda Afatit të Fundit, janë Kushtet në Favor të Autoritetit, Autoriteti mund të vendosë ta zgjidhë këtë Kontratë me anë të njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh për Koncesionarin. Me mbarimin e afatit të njoftimit, Kontrata zgjidhet automatikisht pa patur nevojë për njoftim të dytë, përveçse kur të gjitha kushtet e mbetura përmbushen në atë datë, ose Palët kanë rënë dakord bashkarisht me shkrim për të shtyrë Afatin e Fundit dhe Koncesionari e ka zgjatur Garancinë e Ofertës deri në datën e re të Afatit të Fundit, në të cilin rast kjo Kontratë nuk do të zgjidhet deri në Afatin e Fundit të ri përveç rastit kur të gjithë kushtet e mbetura nuk do të jenë përmbushur në këtë datë të re. Me rastin e zgjidhjes së Kontratës sipas këtij paragrafi, Autoriteti ka të drejtë të tërheqë Garancinë e Ofertës, shuma e të cilës do të konsiderohet se i mbulon të gjitha humbjet, kostot dhe shpenzimet e lindura apo të bëra nga Autoriteti në lidhje me këtë Kontratë dhe veprimet e nevojshme për të gjetur një zgjidhje alternative të ndryshme nga kjo Kontratë;

4.3.2 Në rastin kur kushtet e vetme që nuk janë plotësuar apo nga të cilët nuk është hequr dorë brenda Afatit të Fundit janë Kushtet në Favor të Koncesionarit, Koncesionari mund të vendosë ta zgjidhë këtë Kontratë duke njoftuar Autoritetin me një njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh. Me përfundimin e afatit të njoftimit, kjo Kontratë do të zgjidhet automatikisht, pa patur nevojë për njoftim tjetër, përveç rastit kur të gjitha

kushtet e mbetura janë përmbushur në atë datë, në të cilin rast kjo Kontratë nuk do zgjidhet. Në rastin e zgjidhjes së Kontratës sipas këtij paragrafi palët nuk do të kenë të drejta dhe detyrime të mëtejshme.

5. PËRFAQËSUESIT DHE NDËRLIDHJA

5.1 Përfaqësuesi i Autoritetit dhe Spitalet Referuese

5.1.1 Përfaqësuesi i Autoritetit është një Përfaqësues i caktuar rregullisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5.1.2 Përfaqësuesi i Autoritetit do të ushtrojë funksionet dhe tagrat që i janë dhënë Autoritetit nga kjo Kontratë të njoftuara Koncesionarit nga Autoriteti kohë pas kohe, gjithmonë në përputhje dhe brenda kufijve të tagrave të dhëna Autoritetit nga kjo Kontratë.

Përfaqësuesi i Autoritetit ka të drejtë që në çdo kohë, pas njoftimit të Koncesionarit, të autorizojë çdo person tjetër të ushtrojë funksionet dhe të drejtat e Autoritetit, që i delegohen atij sipas këtij Neni, në mënyrë të përgjithshme ose të posaçme. Çdo veprim i personit të autorizuar për qëllimet e kësaj Kontrate, do të përbëjënjë akt të Përfaqësuesit të Autoritetit dhe, të gjitha referencat ndaj "Përfaqësuesit të Autoritetit" në këtë Kontratë (përveç këtij Neni) do të zbatohen edhe ndaj këtij personi për sa kanë të bëjnë me çështje brenda tagravetë këtij personi.

5.1.3 Autoriteti duke njoftuar Koncesionarin, mund të ndryshojë Përfaqësuesin e Autoritetit. Autoriteti, (për aq kohë sa është e mundur nga ana praktike) do të konsultohet me Koncesionarin përpara emërimit apo zëvendësimit të Përfaqësuesit të Autoritetit, duke marrë parasysh nevojën për ndërlidhje dhe vazhdimësi të Projektit. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në datën e specifikuar në njoftimin me shkrim të Autoritetit (datë e cila, përveçse në raste emergjente, duhet të jetë e tillë që të mos i shkaktojë probleme të rëndësishme Koncesionarit në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate).

5.1.4 Gjatë kohës në të cilën Përfaqësuesi i Autoritetit nuk është emëruar (ose kur Përfaqësuesi i Autoritetit nuk ka mundësi, për shkak sëmundjeje, paaftësie, apo arsye tjetër, cilado qoftë ajo, të kryejë apo ushtrojë funksionet e tij sipas kësaj Kontrate), një përfaqësues tjetër i caktuar rregullisht nga Autoriteti do të kryejë funksionet që përndryshe do të kryheshin nga Përfaqësuesi i Autoritetit.

5.1.5 Asnjë veprim apo mosveprim i Autoritetit, Përfaqësuesit të Autoritetit apo çdo punonjësi tjetër, punëmarrësi apo ndonjë personi tjetër të angazhuar nga Autoriteti, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë:

(a) nuk e çliron apo e shfajëson në asnjë mënyrë Koncesionarin, nuk modifikon, apo shërben si heqje dorë apo mohim i ndonjë detyrimi, përgjegjësie apo detyrimi të Koncesionarit sipas kësaj Konrate; ose

(b) nuk përbën apo autorizon ndonjë ndryshim në këtë Kontratë.

5.1.6 Përveçse kur Koncesionari njoftohet më parë me shkrim nga Autoriteti përpara një veprimi të caktuar, Koncesionari dhe Përfaqësuesi i Koncesionarit kanë të drejtë të konsiderojnë se çdo veprim i Përfaqësuesit të Autoritetit të autorizuar nga nga kjo Kontrate si një veprim që autorizohet shprehimisht nga Autoriteti, dhe Koncesionari dhe Përfaqësuesi i Koncesionarit nuk kanë detyrim të vërtetojnë nëse me të vërtetë Përfaqësuesi i Autoritetit është pajisur me një autorizim të tillë apo jo.

Përfaqësuesi i Spitalit Referues është Drejtori i Spitalit Referues.

të Punimeve, shkallën e kryerjes së Shërbimeve dhe pajtueshmërinë me detyrimet e E&S nga Koncesionari;

(d) Të diskutojë, shqyrtojë dhe japë rekomandime për përshtatjen e Tavanit të Buxhetit Vjetor të Projektit dhe Tavanet e Buxhetit për Spitalet Referuese dhe të propozojë përshtatje periodike tremujore të Tavanit e Buxhetit Vjetor, sipas kërkesave të mundshme të Koncesionarit;

(e) Të sigurojë një forum për diskutime të përbashkëta strategjike, duke shqyrtuar ndryshimet aktuale dhe të parashikuara të kushteve të tregut dhe cështjeve nën përgjegjësinë e Autoritetit dhe ndryshime të mundshme të kësaj Kontrate për të pasqyruar këto ndryshime apo për një performancë më eficente të kësaj Kontrate;

(f) Të japë rekomandime për mosmarrëveshjet në lidhje me faturat e Koncesionarit;

(g) Të shqyrtojë të gjitha raportet tremujore për punën dhe monitorimin e Shërbimeve, në përputhje me Treguesit e Performancës; dhe

(h) Të përgatisë dhe dakordojë për planet e korrigjimeve në përputhje me Treguesit e Performancës.

6.1.3 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, Roli i Komitetit Ndërlidhës është që të japë rekomandime për Palët dhe, sipas rastit (për çështje që lidhen me mosmarrëveshje për faturimevt) për Përfaqësuesin e Spitalit Referues, të cilat mund të pranohen ose jo sipas gjykimit të tyre të pavarur. As Komiteti Ndërlidhës dhe as anëtarët e tij që veprojnë në këtë cilësi, nuk kanë tagër të ndryshojnë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate ose të marrin ndonjë vendim detyrues për Palët. Asnjë Palë nuk mund të mbështetet në ndonjë veprim apo mosveprim të Komitetit Ndërlidhës apo ndonjë prej anëtarëve të Komitetit Ndërlidhës që vepron në këtë cilësi për të kërkuar heqjen dorë apo vendosjen e ndonjë pengese personale për ndonjë të drejtë, përfitim apo detyrim të ndonjë Pale.

6.1.4 Palët njoftojnë emërimin apo largimin e Përfaqësuesve të tyre në Komitetin Ndërlidhës me anë të njoftimit me shkrim drejtuar anëtarëve të tjerë në çdo kohë. Një Përfaqësues në Komitetin Ndërlidhës mund të emërojë apo largojë një anëtar zëvendësues (i cili përfaqëson atë palë) në të njëjtën mënyrë. Nëse një Përfaqësues nuk është i disponueshëm (në të cilin rast Përfaqësuesit e Palës tjetër mund të mbështeten në deklaratën e zëvendësuesit për këtë qëllim), zëvendësi i tij ka të njëjtat të drejta dhe kompetenca sikurse dhe Përfaqësuesi.

6.2 Procedurat dhe praktikat

6.2.1 Në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, anëtarët e Komitetit Ndërlidhës mund të miratojnë sipas gjykimit të tyre të përshtatshëm procedura dhe praktika për kryerjen e aktiviteteve të Komitetit Ndërlidhës herë pas here, dhe:

a) mund të ftojnë në çdo takim të Komitetit Ndërlidhës persona të tjerë për të cilët anëtarët e tjerë bien dakord duke përfshirë Përfaqësuesit e Spitaleve Referuese; dhe

(b) mund të marrin dhe shqyrtojnë një raport nga çdo person për të cilin anëtarët bien dakord.

Rekomandimet dhe vendimet e tjera të Komitetit Ndërlidhës (duke përfshirë ato të parashikuara në Nenin 6.2.1 (a) dhe (b) më lart) duhet të sigurojnë shumicën e votave

5.2 Përfaqësuesi i Koncesionarit

5.2.1 Përfaqësuesi i Koncesionarit është Drejtori i Përgjithshëm i Koncesionarit (apo një person i tillë i emëruar në pajtim me këtë Nen).

5.2.2 Përfaqësuesi i Koncesionarit ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Koncesionarit për të gjitha qëllimet e kësaj Kontrate. Përveçse sikundër i është njoftuar Autoritetit me shkrim nga Koncesionari përpara një veprimi të tillë, Autoriteti dhe Përfaqësuesi i Autoritetit kanë të drejtë të trajtojnë çdo veprim të Përfaqësuesit të Koncesionarit, në lidhje me këtë Kontrate, si një veprim i autorizuar shprehimisht nga Koncesionari, dhe Autoritetit dhe Përfaqësuesi i Autoritetit nuk kanë detyrim të vërtetojnë nëse me të vërtetë Përfaqësuesi i Koncesionarit është pajisuar me një autorizim të tillë apo jo.

5.2.3 Koncesionari mund të ndryshojë Përfaqësuesin e Koncesionarit duke njoftuar Autoritetin. Kur Koncesionari dëshiron të bëjë këtë ndryshim, ai i propozon Autoritetit me me shkrim një zëvendësues dhe kërkon miratimin e tij duke marrë parasysh nevojën për ndërlidhje dhe vazhdimësi të Projektit. Emërimi i nënshtrohet miratimit të Autoritetit (dhe nuk refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme)

5.2.4 Koncesionari siguron që inxhinierët e tij të Projektit në terren, parashikuar në Nenin 11.1, të vazhdojnë angazhimin e tyre gjatë gjithë fazave të Projektimit dhe Punimeve.

6. NDËRLIDHJA

6.1 Komiteti Ndërlidhës

6.1.1 Gjatë gjithë Kohëzgjatjes së Projektit do të ngrihet dhe mbahet një komitet i përbashkët ndërlidhës ("**Komiteti Ndërlidhës**"), i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

(i) Përfaqësuesi i Autoritetit, që është Kryetari i Komitetit Ndërlidhës;

(ii) Përfaqësuesi i Koncesionarit;

(iii) Përfaqësuesit e FSDKSH-së;

[*Opcionale*: deri në dy ekspertë të pavarur të caktuar me konsensusin e Palëve.]

Secila Palë do të përballojë vetë kostot në lidhje me përfaqësuesin e saj në Komitetin Ndërlidhës (ku, për të shmangur cdo paqartësi, kostot e përfaqësuesit të FSDKSH do të përballohen nga Autoriteti ose FSDKSH). Nëse Palët bien dakord për të caktuar një ose më shumë ekspertë të pavarur, secila Palë do të paguajë pesëdhjetë për qind (50%) të kostove të këtij/këtyre ekspertëve të pavarur.

6.1.2 **Funksionet e Komitetit Ndërlidhës janë:**

(a) Të ofrojë një mundësi për të diskutuar dhe shqyrtuar Dokumentet e Projektimit;

(b) Të asistojë në administrimin e proçesit të zgjidhjes së çështjeve të ndërveprimit, sikurse parashikohet në Nenin 16;

(c) Të ofrojë një mundësi për shqyrtimin e përbashkët të çështjeve që lidhen me të gjitha aspektet e përditshme të realizimit të kësaj Kontrate, duke përfshirë monitorimin e progresit

të të gjithë atyre që votojnë mbi çështjen, votë e cila duhet të përfshijnë Kryetarin e caktuar nga Autoriteti dhe Përfaqësuesin e Koncesionarit.

6.2.3 Secili anëtar i Komiteti Ndërlidhës ka një (1) votë. Kryetari ka të drejtë të vendosë në rast barazimi.

6.2.4 Komiteti Ndërlidhës mblidhet të paktën një herë në tre muaj (përveç nëse anëtarët bien dakord ndryshe) dhe herë pas here, sipas nevojës, në zyrat e Autoritetit, ose në cdo vend tjetër të dakorduar nga të gjithë përfaqësuesit pjesëmarrës.

6.2.5 Çdo anëtar i Komitetit Ndërlidhës mund të kërkojë një mbledhje të Komitetit Ndërlidhës në çdo kohë.

6.2.6 Takimet e Komitetit Ndërlidhës zhvillohen pas një njoftimi paraprak prej jo më pak se 15 ditësh (duke përcaktuar pikat e axhendës që do të diskutohen në takim), me kusht që në raste urgjente, takimi mund të organizohet në çdo kohë sipas një njoftimi të arsyeshëm në varësi të rrethanave.

6.2.7 Kur Komiteti Ndërlidhës e vlerson të përshtatshme, takimet mund të realizohen edhe me telefon apo me cdo formë tjetër komunikimi që i jep mundësi secilitpjesëmarrës qëtë dëgjojë dhe flasë njëherazi me të gjithë pjesëmarrësit e tjerë. Gjithsesi, Komiteti Ndërlidhës të paktën një (1) herë në vit realizon një takim fizik.

6.2.8 Procesverbalet e të gjithë takimeve të Komiteti Ndërlidhës (përfshirë ato të mbajtura me telefon apo me forma të tjera komunikimi) mbahen nga Koncesionari dhe kopjet e tyre u shpërndahen menjëherë Palëvesi rregull brenda pesë (5) ditësh ngatakimi. Procesverbalet përfshijnë çdo rekomandim të bërë si edhe rekomandimet e propozuara por të pamiratuara dhe çdo pikë tjetër të pazgjidhur të mosmarrëveshjes midis Përfaqësuesve. Të gjitha procesverbalet janë të hapura për kontroll nga secila Palë në çdo kohë, me kërkesën e saj.

II SHFRYTËZIMI I LOKALEVE

7. DORËZIMI DHE DEKLARIMET DHE GARANCITË E AUTORITETIT

7.1 Dorëzimi i Lokaleve

7.1.1 Lokalet do të dorëzohen tek Koncesionari me faza, të lidhura me përgatitjen me faza të Projektit, sikurse përcaktohet në Shtojcën 17 (*Dorëzimi me Faza i Lokaleve*).

7.1.2 Autoriteti dhe Koncesionari në një datë dhe kohë të dakorduar bashkërisht, do të inspektojnë Lokalet, sipas rastit, dhe do të përgatisin një protokoll që përmban inventarin e Lokaleve në fjalë, duke përfshirë strukturat, dhe çdo pronë tjetër të paluajtshme të lidhur me Lokalet. Autoriteti do t'i sigurojë Koncesionarit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e specifikuar në Shtojcën 17 akses në pjesën e Lokaleve të rënë dakord dhe do t'i dorëzojë Koncesionarit kartelat e rifreskuara të pasurisë (jo më të hershme se 30 ditë kalendarike) të lëshuara rregullisht nga regjistri përkatës i pasurive të paluajtshme për secilin Lokal dhe Ambient ose, çdo dokument tjetër të ngjashëm që mund të kërkohet për qëllimin e Lejeve; data e dorëzimit nga Autoriteti tek Koncesionari konsiderohet si "**Data e Dorëzimit të Lokalit**".

Në rast se ka vonesë nga Autoriteti për çdo arsye të ndryshme nga një Ngjarje e Forcës Madhore apo shkelje të kësaj Kontrate nga Koncesionari, Autoriteti do t'i paguajë

Koncesionarit shumën e caktuar të dëmshpërblimit për vonesëtë barabartë me 300 (treqind) EURO në ditë për çdo 100 (njëqind) metra katrorë apo pjesë përbërëse të kësaj sipërfaqeje të padorëzuar. Parënë dakord që në rastin e një vonese të tillë për çfarëdo arsye, Kalendari i Projektit (duke përfshirë Datën e Synuar të Komisionimit) të zgjatet përkatësisht.

Çdo shumë e paguar Koncesionarit nga Autoriteti si dëmshpërblim, sipas Nenit 7.1, përbën mjetin e vetëm dhe ekskluziv kompensues për Koncesionarin për raste të tilla dhe paguhet si përllogaritje e vërtetë e humbjes të pësuar nga Koncesionari

7.2 Deklarimet dhe garancitë e Autoritetit

7.2.1 Autoriteti deklaron dhe garanton se duke filluar nga Data Efektive dhe gjatë gjithë Kohëzgjatjes, Autoriteti ose Spitalet Referuese, kanë të drejta pronësie të vlefshme mbi Lokalet dhe Ambientet. Në rastin kur Entitet tjetër Shtetëror ose një Palë private pretendon se ka, në çdo kohë, titull të vlefshëm dhe të plotë pronësie mbi çdo Lokal apo Ambient, Autoriteti garanton, për gjithë Kohëzgjatjen e Projektit, të drejtën e përdorimit të qetë nga Koncesionari të Ambienteve dhe/ose cdo pjesë të Lokaleve të nevojshme për kryerjen e Shërbimit dhe, se do të zhdëmtojë dhe nuk do mbajë përgjegjës Koncesionarin për pretendimet e mundshme për dëmshpërblim të ngritura nga ndonjë Entitet Shtetëror apo Palë e tretë lidhur me përdorimin apo shfrytëzimin e Lokalit apo Ambienteve nga Koncesionari.

7.2.2 Gjithashtu, Autoriteti do të garantojë që çdo difekt (apo mungesë) në dokumentet e pronësisë së Lokaleve apo Ambienteve apo në lidhje me vlefshmërinë e tyre në përputhje me Nenin 7.1.2, do të trajtohet nga Autoriteti në mënyrë të tillë që Koncesionari mos pësojë vonesa në aplikimet e kryera për Leje dhe Punime.

Çdo shkelje e Nenit 7.2.1 nga Autoriteti përbën Rast të Mospërmbushjes se detyrimeve nga ana e Autoritetit.

7.3 Përgjegjësia e Autoritetit

7.3.1 Në rast se Koncesionari ndesh kufizime në gëzimin paqësor të të drejtave të përdorimit të Ambienteve dhe/ose ndonjë pjesë të Lokaleve të nevojshme për kryerjen e Shërbimeve në një Spital Referues, Autoriteti do t'i sigurojë ose do të mundësojë që t'i sigurohen Koncesionarit të drejta përdorimi në përputhje me Nenin 8 vijues mbi ambiente të barazvlershme brenda ambjenteve të Spitalit Referues. Autoriteti dëmshpërblem dhe nuk e mban përgjegjës Koncesionarin për çdo kosto apo humbje të pësuar prej tij si rezultat i zhvendosjes së Objekteve Laboratorike të Koncesionarit.

7.3.2 Autoriteti mban përgjegjësi përpara Koncesionarit për dëme që rrjedhin nga e ndotje që ndikojnë në çdo Lokal dhe/ose Ambient, të cilat kanë ekzistuar përpara Datës së Dorëzimit të Lokalit..

7.3.3 Autoriteti mban përgjegjësi përpara Koncesionarit për humbjet, kostot dhe dëmtimet që rrjedhin nga ekzistenca e ndonjë difekti në strukturën fizike të ndërtesave në të cilat janë vendosur Ambientet, në masën që:

a) ai defekt kërcënon tërësinë e Ambienteve përkatëse dhe/ose ofrimin e sigurtë të Shërbimeve, dhe

b) ai defekt nuk rezulton nga Punimet, Shërbimet apo çdo veprim apo mosveprim tjetër i Koncesionarit.

7.3.4 Çdo shumë që i paguhet Koncesionarit nga Autoriteti si kompensim sipas Nenit 7.3 përbën mjetin kompensues të vetëm dhe ekskluziv për Koncesionarin për të tilla raste dhe të paguhet si përllogaritje reale e humbjes së pësuar nga Koncesionari.

8. TË DREJTAT E KONCESIONARIT MBI LOKALET

8.1 Duke patur parasysh detyrimet e Koncesionarit në këtë Kontratë, Autoriteti i siguron Koncesionarit të drejtat e mëposhtme mbi Lokalet dhe Ambientet dhemundëson sigurimin e këtyre të drejtave edhe nga Spitalet Referuese në favor të Koncesionarit, duke filluar nga Data e Dorëzimit të Lokaleve dhe deri në përfundim të Kohëzgjatjes apo ndërprerjes së parakohshme të kësaj Kontrate:

(a) Koncesionari gëzon të drejtën e përdorimit (por jo pronësinë) dhe të gëzimit paqësor të Lokaleve dhe Ambienteve;

(b) Punimet edhe Ambientetpasi të jenë ndërtuar, bëhen pronë e Autoritetit;

(c) Deri në përfundimin të Kohëzgjatjes apo përfundimit të parakohshëm të kësaj Kontrate, Koncesionari ka të njëjtat të drejta dhe detyrime të parashikuara në këtë Kontratë në lidhje me Punimet dhe Ambientet të tilla që Koncesionari merr përsipër të gjitha risqet dhe kostot që lindin nga, ose në lidhje me,Punimet dhe Ambientet, dhe gëzon të drejtat e përdorimit të nevojshme për realizimin e kësaj Kontrate.

8.2 Të drejtat e Koncesionarit mbi Lokalet dhe Ambientet rregullohen me këtë Kontratë, dhe në mënyrë të veçantë nga Neni 8. Prandaj, do të konsiderohet se kjo Kontratë kënaq në mënyrë të mjaftueshme kërkesat për të provuar të drejtat e Koncesionarit mbi Lokalet dhe Ambintet, kërkesa këto të cilat duhen plotesuar në rastin kur Koncesionari aplikon në emrin e tij apo për llogari të Autoritetit apo çdonjërit prej Spitaleve Referuese përpara ndonjë Entiteti Qeveritar kompetent për të kërkuar, marrë apo rinovuar Lejet e kërkueshme për Punimet dhe Shërbimet si përshembull, lejet e lidhura me ndërtimin.

III PROJEKTIMI, PUNIMET DHE PROVA

9. LEJET DHE MIRATIMET

9.1 Koncesionari do të kërkojë, marrë dhe rinovojë në kohë të gjitha Lejet e kërkueshme për Punimet dhe Shërbimet sipas Ligjit të Zbatueshëm dhe në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, përfshirë Lejet për të përdorur Objektet Laboratorike dhe, të gjitha certifikimet dhe miratimet nga cdo Entitetet Shtetërore që kontrollon ose kanë lidhje me ndërtimin dhe shfrytëzimin e Objekteve Laboratorike. Koncesionari përballon vetë të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë ndonjë tarifë aplikimi dhe Tatimet) në lidhje me përgatitjen, paraqitjen e kërkesës dhe marrjen e të gjitha Lejeve.

9.2 Autoriteti ofron, dhe siguron që Spitalet Referuese të ofrojnë të gjithë ndihmën e arsyeshme administrative që mund të kërkohet për përshpejtimin e kërkesave dhe dhënien e Lejeve të kërkuara nga Koncesionari në emrin e tij ose për llogari të Autoritetit ose ndonjërit prej Spitaleve Referuese.

9.3 Për ato Leje të cilat kërkohen në emër të pronarit të Lokaleve apo Ambienteve, Koncesionari do të veprojë në emër dhe për llogari të pronarit në aplikimin për këto Leje dhe Autoriteti siguron ai vetë apo Spitalet Referuese dhe/ose çdo Entitet tjetër Shtetëror të ofrojë cdo prokurë dhe dokument tjetër të nevojshëm për t'i mundësuar Koncesionarit që të përfaqësojë pronarin.

9.4 Koncesionari e mban Autoritetin rregullisht rregullisht të informuar për:
(a) cdo aplikim për dhënien, rinovimin dhe/ose modifikimin e një Lejeje; dhe
(b) të gjitha vendimet e Entiteteve përkatëse Shtetërore mbi aplikimet për leje të parashikuara në pikën e mësipërme (a).

9.5 Me përjashtim të Nenit 11.3.3, Koncesionari siguron që të gjitha Lejet e kërkueshme për të shfrytëzuar një Objekt të caktuar Laboratorik, ose për të ofruar Shërbimet, të jetë marrë jo më vonë se Data Reale e Komisionimit të zbatueshme në lidhje me një Objekt Laboratorik.

10. PROJEKTIMI

10.1 Përgatitja e skicave të projektimit

10.1.1 Koncesionari, nën përgjegjësinë dhe kostot e tij, përgatit dhe prodhon Dokumentet e Projektimit për Objektet Laboratorike, në përputhje me:

(a) Dokumentet e Rilevimit,

(b) ~~Kërkesat Teknike Minimale;~~

(c) Ligjet e Zbatueshme dhe Praktikën e Mirë të Industrisë,

(d) Shtojcat e Projektit,

(e) Standardet e Performancës të IFC-së, dhe

(f) Të gjitha detyrimet dhe kërkesat e Kontrates;

me kusht që të mos bëhet asnjë ndryshim strukturor në ndërtesat e Spitaleve Referuese.

10.1.2 Në veçanti, Koncesionari për projektimin dhe zbatimin e punimeve përshtatëse të tilla si rimodelimi dhe rinovimi i Objekteve Laboratorike, do të udhëhiqet nga aspektet e zbatueshme të Udhëzimeve të Përgjithshme Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore dhe Udhëzimeve Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë për Objektet e Kujdesit Shëndetësor të Bankës Botërore. Koncesionari dizenjon punimet për përshtatjen e Objekteve Laboratorike në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm e standardet e sigurisë arkitekturore, kërkesat për akses nga njerëzit me paaftësi, rregulloreve për mbrojtjen nga zjarri dhe kërkesat vendore ligjore/të sigurimeve.

10.1.3 Autoriteti do t'i dorëzojë Koncesionarit dhe sigurojë që Spitalet përkatës Referues t'i dorëzojnë Koncesionarit të gjitha dokumentet ekzistues deri në Datën Efektive mbi skica dhe kushtet fizike të ndërtesave ku do vendosen Objektet Laboratorike dhe Lokaleve, brenda tridhjetë (30) ditësh nga Data Efektive.

10.1.4 Koncesionari do t'i dorëzojë Autoritetit dhe Komitetit Ndërlidhës kopje të të gjithë Dokumenteve të Projektimit brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga Data Efektive. Autoriteti ka të drejtën por jo detyrimin që të shqyrtojë dhe komentojë Dokumentet e Projektimit të përgatitura nga Koncesionari brenda tridhjetë (30) ditëve. Në rast se Autoriteti kërkon modifikim të dokumenteve të projektimit, Koncesionari e shqyrton kërkesën dhe në mënyrë të arsyeshme përpiqet ta plotësojë atë, duke qënë i lirë të vendosë nëse do t'i pranojë apo do t'i hedhë poshtë këto kërkesa por gjithsesi, me kusht që:

(a) Koncesionari ka detyrimin për të justifikuar me shkrim përpara Autoritetit çdo vendim për të refuzuar një kërkesë për modifikim,

(b) Koncesionari ka detyrimin për të modifikuar Dokumentet e Projektimit në rast se kërkesa për modifikim synon të korrigjojë një mospërputhje me ndonjë kërkes të Nenit 10.1.1; dhe

(c) pranimi nga Koncesionari i ndonjë kërkese nga Autoriteti për të modifikuar Dokumentet e Projektimit nuk e çliron Koncesionarin nga përgjegjësia për Dokumentet e Projektimit apo projektet e Objekteve Laboratorike.

10.1.5 Koncesionari nuk ka detyrim që të presë apo të marrë parasysh vërejtjet e Autoritetit për Projektin nëse kalojnë tridhjetë (30) ditësh nga dorëzimi i tyre dhe, mund të nisë Punimet.

11. PUNIMET DHE PAJISJA

11.1 Përgjegjësia e Koncesionarit

11.1.1 Koncesionari me kostot e tij dhe nën përgjegjësinë e tij individuale do të kryejë Punimet për Objektet Laboratorike në përputhje me:

(a) Kërkesat Teknike Minimale;

(b) Ligjin e Zbatueshëm (përfshirë të gjitha Lejet dhe miratimet e marra nga Koncesionari në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm) dhe Praktikën e Mirë të Industrisë, angazhim ky i cili përshin:

(i) garancinë për sigurinë e plotë të Lokaleve dhe garancinë që Punimet të mos shkaktojnë asnjë rrezik për sigurinë, duke ofruar mbrojtjen e përshtatshme për Lokalin dhe vendosjen e shenjave përkatëse për kryerjen e Punimeve;

(ii) garancinë që Punimet mos shkaktojnë ndërprerje në aktivitetet ekzistuese të Spitalit përkatës Referues;

(iii) garancinë që shqetësimet, duke përfshirë zhurmat që rezultojnë nga Punimet, të mbahen në minimum;

(iv) garancinë në lidhje me pastërtinë e përgjithshme të Lokaleve dhe largimin në kohë të gjithë mbetjeve dhe mbeturinave që vijnë apo rezultojnë nga Punimet;

(c) Standardet e Performancës së IFC-së 1 deri në 4 dhe të udhëzohen mëtej nga aspektet e zbatueshme të Udhëzimeve të Përgjithshme Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore dhe Udhëzimeve Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë për Objektet e Kujdesit Shëndetësor të Bankës Botërore;

(d) Dokumentet përfundimtare të Projektimit (për aq kohë sa janë në përputhje me pikat (a) dhe (b) më lart); dhe

(e) Kalendarin e Projektit.

1.2 Në rast se konstatohet se ndonjë pjesë e Punimeve nuk është e plotë, ka difekt dhe/ose nuk përputhet me ndonjë prej pikave të mësipërme, Koncesionari është i detyruar që

nën përgjegjësinë e tij individuale dhe me kostot e tij, të korrigjojë mungesën, difektin dhe/apo mospërputhjen.

11.1.3 Në përputhje me Nenin 11.3.3, për çdo Objekt Laboratorik, Koncesionari duhet që jo më vonë se Data e Synuar e Komisionimit të Objektit Laboratorik,:

a) të përfundoje Punimet në përputhje me Nenin 11.5;

b) t'i dorëzojë Autoritetit kopje të nënshkruara të marrëveshjeve përkatëse të Projektit, të cilat në cdo rast duhet të parashikojnë (për sa kohë është e mundur bazuar në kushte tregtare të arsyeshme) mundësinë e kalimit të të drejtave tek Autoriteti apo tek Spitalet përkatëse Referuese.

11.1.4 Punimet do të kryhen në mënyrë të tillë që të mos ketë ndërprerje në vazhdimësinë dhe sigurinë e ofrimit të shërbimeve laboratorike në Spitalet Referues përpara Datës Reale të Komisionimit. Koncesionari do t'i propozojë Komitetit Ndërlidhës një plan rinovimi brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga Data e Fillimit i cili pasqyron këtë nevojë.

11.2 Në çdo kohë gjatë Punimeve, Koncesionari do të siguroje që një menaxher i kualifikuar projekti, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi "Për rregullat e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve", të mbikëqyrë dhe monitorojë Punimet për secilin Lokal.

11.3 Vonesat, Ngjarjet e Çlirimit nga Detyrimi dhe Dëmshpërblimet

11.3.1 **Vonesat – informacioni dhe plani korrigjues**

Nëse ndodh një ngjarje, e cila mund të shkaktojë vonesë në kryerjen e Punimeve ose në arritjen e Datës së Synuar të Komisionimit për çdo Objekt Laboratorik, Koncesionari duhet t'i dërgojë një raport Autoritetit brenda shtatë (7) ditëve nga zbulimi i saj, duke paraqitur arsyet që çuan, apo që do të çonin në një vonesë të tillë, dhe masat që do të merren për të shmangur apo minimizuar vonesën në përfundimin e Punimeve deri në Datën e Synuar të Komisionimit për Objektin Laboratorik në fjalë. Ky Nen nuk paragjykon shtyrjet në kohë të Datës së Synuar të Komisionimit për ndonjë Objekt Laboratorik që mund t'i ofrohen Koncesionarit në përputhje me Nenin 11.3.3.

11.3.2 **Vonesat – dëmet e likuidueshme**

Përveç rasteve të parashikuara në Nenin 11.3.3 të Kontrates, kur Data Reale e Komisionimit për çdo Objekt Laboratorik zgjatet përtej Datës së Synuar të Komisionimit, Koncesionari i paguan Autoritetit dëmet e likuidueshme në përputhje me Nenin 24. Për të shmangur çdo dyshim, Koncesionari ka detyrimin t'i paguajë Autoritetit shumën e caktuar të dëmeve të likuidueshme për secilin Objekt Laboratorik në lidhje me të cilin Data Reale e Komisionimitt është shtyrë sikurse parashikohet në këtë Nen.

11.3.3 **Vonesat – Shkaqe për zgjatje të afatit**

Data e Synuar e Komisionimit për një Objekt Laboratorik të caktuar mund të zgjatet vetëm në rastet e mëposhtme:

(a) një Ngjarje e Forcës Madhore (sipas parashikimit në Nenin 31.1) e cila pengon drejtëpërdrejtë komisionimin e një Objekti Laboratorik të caktuar;

(b) një Ngjarje e Forcës Madhore Politike (sipas parashikimit në Nenin 32.1) që pengon drejtëpërdrejtë komisionimin e një Objekti Laboratorik të caktuar;

(c) një Rast Mospërmbushje nga ana e Autoritetit (siaps parashikimit në Nenin 34.2) që pengon drejtëpërdrejtë komisionimin e një Objekti Laboratorik të caktuar;

(d) një kërkesë e Autoritetit për pezullimin e Punimeve (siç parashikimit në Nenin 11.4.3) për një Objekt Laboratorik të caktuar;

(e) një Njoftim Difektesh nga Autoriteti (sipas parashikimit në Nenin 11.5.4) mbi Objektin Laboratorik në fjalë i cili është kundërshtuar nga Koncesionari dhe është pranuar nga Autoriteti;

(f) cdo vonesë nga Autoriteti për dorëzimin me faza të Lokalit në fjalë sipas Nenit 7.2 dhe Shtojcës 17 (*Dorëzimi me Faza i Lokaleve*);

(g) cdo vonesë nga Autoriteti në përmbushjen e detyrimit të parashikuar në Nenin 23.2.1;

(h) cdo vonesë nga Spitalet Referuese apo Autoriteti në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Nenin 16; ose

(i) cdo vonesë nga Koncesionari në marrjen e Lejeve për arsye që lidhen me mungesën e dokumenteve të pronësisë apo cdodokumenti tjetër të barasvlefshëm me dokumentet e pronësisë për Lokalet.

Në rast se vërtetohet ndonjë nga rastet e sipërpërmendura në lidhje me një apo disa Objekte Laboratorike, Data e Synuar e Komisionimit për Objektin apo Objektet Laboratorike në fjalë shtyhet në kohë për një periudhë të barasvlershme me kohëzgjatjen e ngjarjes që shkakton vonesën. Koncesionari përfiton nga shtyrja e Datës së Synuar të Komisionimit për Objektin apo Objektet Laboratorike në fjalë, por nuk ka në asnjë rast të drejtë kompensimi në lidhje me këtë shtyrje. Koncesionari nuk ka të drejtë të përfitojë shtyrje për ndonjë shkak të ndryshëm nga rastet e parashikuara në mënyrë shteruese në këtë Nen 11.3.3.

11.4 Monitorimi dhe Inspektimi

11.4.1 Përveç çdo monitorimi dhe inspektimi nga Entiteti Shtetëror përkatës sipas Ligjit të Zbatueshëm, Autoriteti mund të monitorojë dhe inspektojë Punimet në praninë e Koncesionarit me një njoftim paraprak të arsyeshëm drejtuar Koncesionarit; por me kusht që ky monitorim dhe inspektim të mos shkaktojë pengesa të paarsyeshme apo të ndërhyjë në ecurinë e ndërtimit apo të ndërpresë padrejtësisht ndërtimin. Rezultatet e monitorimit dhe inspektimit përmblidhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja Palët menjëherë pas inspektimit.

11.4.2 Autoriteti merr përsipër vetë kostot e monitorimit dhe inspektimit të Punimeve të kryera nga Autoriteti.

11.4.3 Autoriteti mund t'i kërkojë Koncesionarit me anë të një njoftimi që të pezullojë menjëherë të gjitha apo një pjesë të Punimeve nëse, për mendimin e arsyeshëm të Autoritetit, punime të tilla kërcënojnë sigurinë e Spitaleve Referuese, objekteve të tij, punëmarrësve, Pacientëve apo publikut.

~~Koncesionari, bazuar në njoftimin sipas Nenit 11.4.3 i pezullon Punimet për aq kohë dhe në~~ mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti dhe për këtë arsye merr masa rregulluese për të garantuar sigurinë e Punimeve të pezulluara.

Koncesionari mund t'i dërgojë një raport Autoritetit ku rekomandon heqjen e pezullimit sapo të jetë zgjidhur situata e sigurisë.

Të gjitha kostot e arsyeshme për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e Punimeve gjatë periudhës së pezullimit përballohen nga Koncesionari me kusht që nëse pezullimi ndodh si pasojë e ndonjë shkeljeje të kësaj Kontrate nga Autoriteti, këto kosto të përballohen nga Autoriteti.

Nëse pezullimi i Punimeve bëhet për arsye që nuk i atribuohen Koncesionarit, Autoriteti vendos për shtyrjen Datave të Synuara të Komisionimit për të cilat Koncesionari ka të drejtë në mënyrë të arsyeshme.

Në rastin kur Data e Synuar e Komisionimit shtyhet në përputhje me këtë Nen, Kohëzgjatja e kësaj Kontrate zgjatet për një kohëzgjatje të të barabartë me zgjatjen e Datës së Synuar të Komisionimit.

11.5 Komisionimi dhe pranimi

11.5.1 Koncesionari kryen komisionimin dhe testin e performancës të secilit Objekt Laboratorik, në përputhje me procedurat e parashikuara në Shtojcën 13 (*Komisionimi*).

11.5.2 Për secilin Objekt Laboratorik, pas përfundimit me sukses të gjithë testeve të të komisionimit dhe performancës, dhe me marrjen e të gjitha Lejeve të nevojshme për ofrimin e Shërbimeve në Objektin Laboratorik në fjalë, Koncesionari i dërgon një njoftim Autoritetit, dhe në vijim Palët organizojnë një inspektim të përbashkët të Objektit Laboratorik të caktuar jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas njoftimit të Koncesionarit. Nëse Autoriteti bindet se Objekti Laboratorik në fjalë është në përputhje me Kërkesat Teknike Minimale, Dokumentet e Projektimit dhe të gjitha kërkesat e tjera sipas kësaj Kontrate, ai menjëherë bën një njoftim për Koncesionarin në lidhje me përfundimin e punëve kontraktuale (**"Njoftimi i Përfundimit"**) në lidhje me atë Objekt Laboratorik.

11.5.3 **"Data Reale e Komisionimit"** e zbatueshme për çdo Objekt Laboratorik është data më e hershme midis datave të mëposhtme:

(a) Data e Njoftimit të Përfundimit në lidhje me Objektin Laboratorik në fjalë; ose,

(b) përfundimi i periudhës dhjetë (10) ditore të parashikuar më lart në lidhje me Objektin Laboratorik në rastin kur Autoriteti nuk arrin të kryejë inspektimin e Objektit Laboratorik në fjalë ose kryen një inspektim por nuk bën njoftimin me shkrim për të informuar Koncesionarin për mospërfundimin e punëe kontraktuale për Objektin Laboratorik në fjalë brenda periudhës së caktuar dhjetë (10) ditore.

Gjatë inspektimit të përbashkët, Autoriteti dhe Koncesionari hartojnë një listë të defekteve të vogla dhe afatin brenda të cilit këto do të riparohen nga Koncesionari, duke pranuar se defekte të tilla duhet të korigjohen brenda tre (3) muajve nga Data Reale e Komisionimit për Objektin Laboratorik në fjalë, apo cdo datë të mëvonshme të rënë dakord mes Palëve. Mos-riparimi i të gjithë defekteve brenda afatit të rënë dakord përbën një Rast të Mospërmbushjes së Koncesionarit.

11.5.4 Në rastin kur pas inspektimit të përbashkët, Autoriteti konstaton defekte materiale, ai i dërgon një njoftim për këto defekte Koncesionarit (**"Njoftimi i Defekteve"**) brenda periudhës së parashikuar në Nenin 11.5.2. Koncesionari dhe Autoriteti konsultohen brenda dhjetë (10) ditëvepër të arritur marrëveshje për masat e kërkuara nga Koncesionari për riparimin e defekteve. Nëse një marrëveshje mes Palëve nuk arrihet brenda dhjetë (10) ditëve pas dërgimit të Njoftimit të Defekteve, atëherë secila prej Palëve mund të dërgojë një Njoftim për Mosmarrëveshje ose Neni 43 do të zbatohet.

11.5.5 Nëse Palët arrijnë një marrëveshja në përputhje me Nenin 11.5.4, Koncesionari zbaton masat e përcaktuara në marrëveshje. Më pas Koncesionari ri-thërret procedurën e inspektimit të përbashkët sipas Nenit 11.5.2.

11.6 Detyrimet pas Përfundimit

Jo më vonë se katër (4) muaj pas Datës Reale të Komisionimit të çdo Objekti Laboratorik, Koncesionari i dorëzon Autoritetit materialet e mëposhtme në lidhje me atë Objekt Laboratorik:

(a) të gjitha të dhënat teknike (përfshirë raportin e projektimit, dokumentet e llogaritjeve dhe të projektit, në kopje fizike dhe elektronike duke përfshirë të gjitha udhëzimet e nevojshme të softuerit) të lidhura me projektimin dhe ndërtimin e Objektit Laboratorik në fjalë (në dy (2) kopje);

(b) materialet teknike dhe vizatimet e pajisjeve, duke përfshirë vizatimet origjinale (bashkë me vizatimet e përditësuara gjatë punës), dokumentet, udhëzimet dhe certifikatat e cilësisë, procesverbalet e instalimit dhe inspektimit (në dy (2) kopje); dhe

(c) cdo dokument tjetër teknik apo material në lidhje me Objektin Laboratorik në fjalë sipas kërkesave të arsyeshme të Autoritetit (dy (2) kopje).

DETYRIMI I PËRGJITHSHËM I KONCESIONARIT

Koncesionari mban përgjegjësi individuale për ndonjë mungesë apo mospërputhje në projektimin e ndonjë apo të gjithë Objekteve Laboratorike (kurdo që zbulohet) dhe në realizimin e Punimeve. Moskundërshtimi apo mungesa e monitorimit të ndonjë projektim,

vizatim të projektit, specifikim, proces pune, apo komponent ndërtimi nga Autoritetinuk do të interpretohet si heqje dorë nga Autoriteti ngandonjë prej të drejtave të tij në këtë Kontrate dhe nuk do ta shkarkojë Koncesionarin në asnjë mënyrë nga detyrimet e tij sipas Kontrates. Përveçse sa më sipër, Koncesionari:

(a) pranon se asnjë rishikim i kryer nga Autoriteti në lidhje me projektin e ndonjë prej Objekteve Laboratorike nuk e çliron Koncesionarin nga detyrimee tij sipas kësaj Kontrate dhe Autoriteti nuk mban asnjë përgjegjësi në lidhje me cilësinë e punëve inxhinierike apo të ndërtuese të projektit të ndonjë prej Objekteve Laboratorike apo komponentë të tij;

(b) nuk bën deklarime apo nuk nënkupton tek palë të treta se Autoriteti është përgjegjës për sigurinë inxhinierike apo të ndërtimit të projektit të ndonjë prej Objekteve Laboratorike apo të ndonjë komponenti të tij si pasojë e rishikimit të tij nga Autoriteti; dhe

(c) mban përgjegjësi individuale për fizibilitetin teknik, kapacitetin operacional dhe sigurinë e projektit për të gjitha Objektet Laboratorike dhe për secilin komponent të tij.

IV FAZA E SHFRYTËZIMIT – SHËRBIMET

13. OBJEKTI I SHËRBIMEVE

Duke filluar nga Data Reale e Komisionimit të secilit Objekti Laboratorik, Koncesionari ofron në atë Objekt Laboratorik për Spitalin Referues në të cilin është vendosurObjekti Laboratorik, Shërbimet e parashikuara në Nenin 13, në përputhje me standartet dhe detyrimet e parashikuara në Nenin 14 (kolektivisht "**Shërbimet**").

13.1 Menaxhimi i Objekteve Laboratorike

13.1.1 Koncesionari është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të secilit Objekt Laboratorik, duke përfshirë:

(a) mirëmbajtjen rutinë dhe punimet riparuese dhe ndryshimet e vogla;

(b) mirëmbajtjen, riparimin dhe rinovimin/zëvendësimin e Pajisjeve me pajisje të njëjta ose të ngjashme (por edhe më të avancuara) duke marrë parasysh ndryshimin e teknologjisë;

(c) mirëmbajtjen, riparimin dhe rinovimin/zëvendësimin e të gjitha FF&E-ve;

(d) pastrimin dhe higjenën e Objekteve Laboratorike dhe kontrollin e sëmundjeve infektive brenda Objekteve Laboratorike;

(e) sigurinë dhe sigurimin e personave dhe të pronës brenda Objektit Laboratorik; dhe

(f) menaxhimin dhe heqjen e të gjitha mbetjeve mjekësore dhe mbetjeve të tjera të krijuara në Objektet Laboratorike, duke u kushtuar vëmendje të posaçme protokolleve dhe detyrimeve të parashikuara në Ligjin e Zbatueshëm.

13.1.2 Në veçanti, Koncesionari i shfrytëzon dhe mirëmban Objektet Laboratorike në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe Standardet e Performancës të IFC-së 1 deri në 4 dhe vazhdimisht në përputhje me aspektet e zbatueshme të Udhëzimeve të Përgjithshme Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore dhe

Udhëzimeve Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë për Objektet e Kujdesit Shëndetësor të Bankës Botërore, cilado qoftë më e rreptë.

13.1.3 Koncesionari përgatit dhe zbaton një grup procedurash ESMS të përshtatshme për natyrën, gamën, risqet dhe ndikimet sociale të Projektit dhe ia bën ato të ditura me shkrim Autoritetit, të paktën tridhjetë (30) ditë përpara fillimit të Punimeve. ESMS-të përgatiten në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, Standardet e Performancës së IFC-së dhe në përputhje me aspektet e zbatueshme të Udhëzimeve të Përgjithshme Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore dhe Udhëzimeve Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë për Objektet e Kujdesit Shëndetësor të Bankës Botërore, cilado qofshin më të rrepta. ESMS-të mund të jenë ose një sistem që qëndron më vete, ose mund të përfshihen në një sistem të përgjithshëm të menaxhimit të integruar, apo në një sistem menaxhimi të sigurimit të cilësisë të tillë si ISO 9001, ose të ngjashëm, me kusht që të plotësohen gjithë komponentët e parashikuar në Shtojcën 18 (*Procedurat ESMS*).

13.1.4 Koncesionari ngre një mekanizëm për të marrë komunikime të jashtme dhe adresuar ankesat për Objektet Laboratorike gjatë Punimeve të përshtatjeve/rinovimeve dhe gjatë fazës së shfrytëzimit. Mekanizmi duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm, i kuptueshëm dhe duhet t'u bëhet mjaftueshëm i njohur palëve të interesuara dhe të sigurojë besimin e njerëzve që bëjnë ankesa.

13.1.5 Koncesionari kontrakton persona të licencuar rregullisht për menaxhimin, trajtimin dhe largimin e infeksioneve, mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme mjekësore, për ta ofruar shërbimin në përputhje me planin e menaxhimit të mbetjeve të Projektit, Ligjin e Zbatueshëm, Standardet e Performancës së IFC-së dhe aspektet e zbatueshme të Udhëzimeve të Përgjithshme të Grupit të Bankës Botërore mbi Mjedisin, Shëndetin dhe të Sigurinë dhe të Udhëzimeve të Grupit të Bankës Botërore mbi Mjedisin, Shëndetin dhe të Sigurinë e Objekteve Shëndetësor, cilido qofshin më të rrepta. Koncesionari nuk përdor as vetë por as nuk lejon personat e tjerë të kontraktuar prej tij të përdorin ndonjë shërbim të incineratorëve të Spitalit publik në Shqipëri, pa siguruar prova dokumentare se incineratori është në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm për shkarkimet në ajër, dhe se incineratorë të tillë shfrytëzohen ligjërisht dhe janë të licencuar në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

13.2 Shërbimet komunale

13.2.1 Koncesionari siguron kontraktim dhe lidhje të drejtëpërdrejtë për Objektet Laboratorike me furnizuesin përkatës të ujit në Shqipëri dhe në lidhje me këtë detyrim do të vendosë pajisjet matëse në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm jo më vonë se Data Reale e Komisionimit për çdo Objekt Laboratorik. Autoriteti do të detyrojë cdo Spital Referues që të pranojë në sistemin e tij të kanalizimeve, shkarkimet e zakonshme të ujërave të zeza nga Objekti Laboratorik që ndodhet në atë Spital Referues, pa pagesë. Koncesionari është përgjegjës për punimet e shtrimit të tubacioneve të ujit dhe të kanalizimeve për dërgimin e tyre në pikën e lidhjes. Çdo rregullim, punim apo përmiresim eventual që koncesionari do të bëjë deri në një pikë lidhje në periferi të lokalit do të jetë tërësisht në ngarkim dhe me shpenzimet e vetë koncesionarit.

13.2.2 Koncesionari siguron kontraktim dhe lidhje të drejtëpërdrejtë për Objektet Laboratorike me furnizuesin përkatës për energji elektrike në Shqipëri dhe në lidhje me këtë detyrim do të vendosë pajisjet matëse në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, jo më vonë se Data Reale e Komisionimit për çdo Objekt Laboratorik. Autoriteti nuk është përgjegjës për ndërprerjet e energjisë apo për furnizimin e pamjaftueshëm të energjisë, përveçse kur ndërprerje apo pamjaftueshmëri të tilla shkaktohen drejtpërdrejt nga Autoriteti, ose Spitalet Referuese.

Pavarësisht nga sa më sipër, Koncesionari është përgjegjës për të siguruar furnizim me energji elektrike të vazhdueshëm dhe uniform në çdo kohë në cdo Objekt Laboratorik për garantuar furnizim të pandërprerë në cdo kohë (në raste kur nuk ka energji elektrike të mjaftueshme), me qëllim për të përmbushur Kërkesat Teknike Minimale.

13.3 Shërbimet Mjekësore

13.3.1 Në bazë të Nenit 13.3.6, Koncesionari:

(a) Kryen analizat për Pacientët e Referuar dhe zbaton standardet e shërbimit parashikuar në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*) dhe në Shtojcën 20 (*Standardet e Shërbimit*) përkatësisht;

(b) Shfrytëzon dhe mirëmban Lokalet dhe Pajisjet, siç parashikohet në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*);

(c) U jep rezultatet e Analizave Pacientëve të Referuar, në formën e një raporti të shkruar/elektronik të nënshkruar nga personeli i autorizuar i Koncesionarit në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

("**Shërbimet Mjekësore**").

13.3.2 Koncesionari nuk do të lejojë dhe do të sigurohet që (i) punonjësit dhe/ose përfaqësuesit e tij, (ii) Palët e lidhura të tij, dhe/ose (iii) punonjësit dhe/ose përfaqësuesit e Palëve të Lidhura, të mos kryejnë asnjë pagesë për ndonjë person, përfshirë kundrejt ndonjë Spitali Referues apo Autoritetin, për Referime (apo veprim në lidhje me ndonjë Referim). Çdo pagesë e tillë përbën një Rast Mospërmbushjeje së Koncesionarit.

13.3.3 Kur, gjatë një Periudhe Buxhetore individuale, Tarifat e Shërbimit që paguhen për numrin e përgjithshëm të Analizave të kryera nga Koncesionari për një Spital Referues arrijnë Tavanin e Buxhetit për atë Spital Referues, Koncesionari nuk është i detyryar të ofrojë Shërbim Mjekësor për asnjë pacient të atij Spitali Referues deri në fund të asaj Periudhe Buxhetore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në Nenin 22.4. Të gjithë Pacientët e tjerë të Referuar nga ai Spital do të vendosen në listë pritjeje dhe do të trajtohen me përparësi duke filluar nga Periudha tjetër Buxhetore.

13.4 Shërbimet dhe Softueri mbështetës

13.4.1 Koncesionari ofron të gjitha shërbimet ndihmëse të Shërbimeve Mjekësore, duke përfshirë:

(a) regjistrimin e pacientëve, pyetjet që u bëhen pacientëve, raportimin dhe kujdesin;

(b) administrimin e të dhënave dhe dokumenteve të pacientit (ose në kopje elektronike ose të shtypur) për periudhën e kërkuar sipas Ligjit të Zbatueshëm, duke përfshirë ofrimin e aksesit në të dhënat dhe dokumentet e pacientit, stafit përkatës dhe të kualifikuar të Spitalit Referues përkatës, sikundër mund të kërkohet në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm;

(c) shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë Softuerëve të lidhur me Shërbimet, duke përfshirë softuerin e sistemit të informacionit të përdorur për regjistrimin, administrimin dhe nxjerrjen e të dhënave, ose çdo softuer që mbështet Pajisjet në Objektet Laboratorike.

13.4.2 Në rastin kur ndonjëri prej Spitaleve Referuese zbaton një sistem rrjeti informacioni me teknologji të informacionit të integruar për Shërbimet Mjekësore, Koncesionari i ofron atij Spitali asistencë të arsyeshme në projektimin dhe zbatimin e një sistemi të tillë, me qëllim për të siguruar ndërveprim me Softuerin e Koncesionarit, por duke pranuar që:

(a) për sa kohë Pajisjet, FF&E-të dhe Softueri i Koncesionarit në Spitalin Referues në fjalë të jenë në përputhje me kërkesat e parashikuara sipas kësaj Kontrate, asgjë në këtë Nen nuk krijon detyrime për Koncesionarin (i) tpër të blerë harduerë apo FF&E të tjera, apo të ndërmarrë ndonjë punim fizik (duke përfshirë shtrimin e ndonjë kabilloje shtesë) apo (ii) për të zëvendësuar ndonjë Softuer apo Pajisje; dhe

(b) pa cenuar detyrimin e tij të mësipërm për të ofruar asistencë të arsyeshme, Koncesionari nuk mban përgjegjësi për ndonjë defekt gjatë ndërveprimit të Softuerit të tij dhe softuerit të Spitalit Referues.

13.5 Akreditimi

13.5.1 Përveç respektimit të Ligjit të Zbatueshëm, duke përfshirë të gjitha standardet e detyrueshme dhe akreditimin, Koncesionari do të bëjë kërkesë për:

(a) Akreditimin e DPA-së, pas kërkesës me shkrim të Autoritetit (kërkesë e cila nuk mund të bëhet para se të kalojnë njëzet e katër (24) muaj nga Data Reale e Komisionimit për të gjithë Objektet Laboratorike), rast në të cilin Koncesionari duhet të sigurojë Akreditimin e DPA-së brenda tetë (8) muajsh nga koha e kërkesës për të gjithë Objektet Laboratorike;

(b) Akreditimin e kërkuar në Shtojcën 4 (*Kërkesat Teknike Minimale*) në përputhje me Kalendarin e Projektit

13.5.2 Spitalet Referuese bëjnë përpjekjet maksimale për të ndihmuar Koncesionarin që të sigurojë këtë akreditim.

13.5.3 Koncesionari i ruan dhe i rinovon akreditimet, sipas rastit, gjatë Kohëzgjatjes.

13.5.4 Koncesionari bën përpjekje të arsyeshme për të plotësuar kërkesat e sakta të paraqitura nga çdo Spital Referues në rastin kur një Spital Referues/Spitalet Referues dëshiron/jnë të zbatojnë një program akreditimi me kusht që kjo kërkesë mos parashtrojë nevojën për modifikime të Kontratës (përfshirë të *Kërkesave Teknike Minimale*).

13.6 Protokollet e përshkrimit të analizave

Koncesionari siguron, sipas rastit, në çdo kohë, respektimin e protokolleve për përshkrimin e analizave, të vendosura dhe të zbatuara nga Autoriteti dhe FSDKSH-ja herë pas here (nëse ka të tilla).

13.7 Trajnimi dhe Aksesi në Objektet Laboratorike

13.7.1 Koncesionari, pas njoftimit të arsyeshëm nga Autoriteti apo Spitali Referues përkatës, lejon studentët e regjistruar në Universitetin Shtetëror të Mjekësisë Tiranë të lidhur me Spitalet Referuese ("**Studentët**") dhe të dërguar nga ai institucion mësimor në fjalë, që gjatë studimeve të tyre të kenë mundësi të hyjnë në Objektet Laboratorike të një Spitali Referues me qëllim marrjen e trajnimit praktik, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga programi i tyre i trajnimit. Studentë të tillë shoqërohen nga një mësues i caktuar nga Universiteti Publik i Mjekësisë Tiranë. Koncesionari mund të ofrojë një hapësirë të veçantë brenda Objekteve Laboratorike për Studentët, për të shmangur ndërprerjen e proceseve të punës së Koncesionarit. Në çdo vit të caktuar akademik, numri maksimal i Studentëve të lejuar për të ndjekur një trajnim të tillë propozohet nga Spitali Referues përkatës në fillim të një viti të tillë, por jo më vonë se data 30 Nëntor e atij viti, dhe i njoftohet rregullisht Koncesionarit, i cili duhet të japë miratimin e tij për numrin e Studentëve ose të propozojë një numër të përshtatshëm në përputhje me kapacitetin e Objekteve Laboratorike dhe ngarkesën e punës. Koncesionari do të marrë në konsideratë dhe do të miratojë çdo kërkesë tëAutoritetit për të lejuar studentët të regjistruar në universitete private mjekësore që të kryejnë trajnim praktik pranë Objekteve Laboratorikë, rast pas rasti.

13.7.2 Është rënë dakord shprehimisht se Koncesionari nuk është përgjegjës për ofrimin e një trajnimi të tillë dhe se Studentët do të jenë gjatë gjithë kohës nën drejtimin, mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e një mësuesi të kualifikuar të mjekësisë, të atashuar me institucionin mësimor apo Autoritetin.

13.7.3 Spitalet Referuese dhe Autoriteti janë bashkërisht përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar nga Studentët dhe dëmshpërblejnë e shkarkojnë Koncesionarin nga cdo përgjegjësi për pretendime apo kërkesa që rrjedhin nga veprimet, mosveprimet apo prania e një Studenti në Objektet Laboratorike.

13.7.4 Koncesionari ka të drejtë të refuzojë hyrjen apo pjesëmarrjen e ndonjë personi që paraqet një kërcënim të caktuar ndaj sigurisë së pacientëve apo stafit të Koncesionarit, rast në të cilin Koncesionari njofton menjëherë Autoritetin dhe Spitalin Referues për një vendim të tillë.

13.7.5 Për të shmangur çdo dyshim, Koncesionari nuk bën deklarime apo jep garanci në lidhje me respektimin nga ndonjëprej Objekteve Laboratorike të kërkesave të përgjithshme të një trajnimi të caktuar.

13.7.6 Koncesionari merr përsipër të bashkëpunojë dhe të diskutojë me Spitalet Referuese për të përcaktuar procedura të pranuara në mënyrë të ndërsjellë, me qëllim për të lehtësuar

sa më sipër dhe minimizuar ndikimin e një kërcënimi të tillë në Shërbimet e ofruara në Objektet Laboratorike.

13.8 Çështjet Mjeko-Ligjore

13.8.1 Koncesionari pranon në këtë Kontrate se raportet që duhen përgatitur për Çështjet Mjeko-Ligjore të një Pacienti të Referuar, me kërkesën e Autoritetit apo të Spitalit Referues, do të përgatiten nga stafi i kualifikuar i Koncesionarit të Objektit Laboratorik përkatës, por se në fund, është detyra e Spitalit Referues të përgatisë dhe nënshkruajë raportin përfundimtar për të cilin ai ka përgjegjësi në lidhje me Pacientin e Referuar. Për shmangien e çdo dyshimi, është sqaruar se Koncesionari është përgjegjës vetëm për ato raporte që përgatiten në Objektin Laboratorik përkatës. Çdo detyrim ligjor për të marrë pjesë më pas në procese ligjore si dëshmitar apo ekspert në lidhje me një Çështje Mjeko-Ligjore është përgjegjësi e Spitalit Referues, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë kërkohet shprehimisht nga një gjykatë. Për shmangien e çdo dyshimi, Koncesionari është përgjegjës për të gjitha raportet e përgatitura prej tij, me përjashtim të atyre në lidhje me Çështjet Mjeko-Ligjore.

13.8.2 Dokumentet dhe raportet e Çështjeve Mjeko-Ligjore do të ruhen nga Koncesionari gjatë gjithë kohës në mënyrën e specifikuar nga Spitali Referues.

14. NIVELI I SHËRBIMIT

14.1 Koncesionari:

(a) performon dhe kryen të gjitha Shërbimet, duke përfshirë edhe administrimin e të gjitha Objekteve Laboratorike, rregullisht dhe me korrektësi, në përputhje me (i) Kërkesat Teknike Minimale, (ii) Treguesit e Performancës, (iii) Praktikën e Mirë të Industrisë (iv) Standardet e Shërbimit, dhe të gjitha standardet, kërkesat dhe zotimet e tjera të parashikuara në tekstin e kësaj Kontrate dhe në Shtojcat e saj;

(b) kërkon dhe merr në kohë dhe mban në fuqi dhe rinovon të gjitha Lejet që mund të kërkohen për ofrimin e çdo Shërbimi; dhe

(c) i ofron Shërbimet në përputhje me të gjitha Ligjet e Zbatueshme dhe me Lejet.

15. STAFI DHE PUNËSIMI

15.1 Në përputhje me Nenet 15.2, 15.3 dhe 15.4, Koncesionari në gjykimin e tij të vetëm dhe me shpenzimet e tij, merr të gjitha masat e përshtatshme për të punësuar dhe shpërblyer në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, stafin mbështetës dhe personelin në një numër të përshtatshëm dhe me kualifikimet, akreditimet dhe përvojën e kërkuar, me qëllim për t'i realizuar Shërbimet në përputhje me këtë Kontratë. Koncesionari, në çdo kohë, respekton Planin e Rekrutimit në përputhje me Shtojcën 5. Në këtë drejtim, Koncesionari ka detyrimin të plotësojë të gjitha vendet e punës të parashikuara në Shtojcën 5 (*Plani i Rekrutimit)* përpara Datës Reale të Komisionimit të një Objekti Laboratorik.

15.2 Stafi Ekzistues i Spitaleve Referuese nuk transferohet tek Koncesionari, megjithatë, Koncesionari i jep përparësi Stafit Ekzistues të Spitaleve Referuese përpara punësimit të personelit, në përputhje me Planin e tij të Rekrutimit dhe, sipas gjykimit të tij të vetëm mund të vendosë të punësojë anëtarët e Stafit Ekzistues të Spitaleve Referuese, me kusht që (i) të ekzistojë pëlqimi i shprehur i tyre (ii) Stafi Ekzistues të ketë dhënë dorëheqjen nga

marrëdhënia e tyre ekzistuese e punësimit me Spitalin Referues ose Autoritetin, sipas rastit (iii) punëdhësi të ketë dhënë miratimin e tij për këtë dorëheqje, e për pasojë zgjidhjen e marrëveshjes. Në përputhje me pikën e mësipërme, Koncesionari sipas gjykimit të tij, vlerëson dhe zgjedh atë personel nga Stafi Ekzistues që ka shprehur interes për një vend pune që, për mendimin e tij të arsyeshëm dhe duke përdorur kritere të dokumentuara objektive të punësimit, bazuar në përshkrimin e punës dhe parimet e mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta, ka kualifikimin dhe përvojën e duhur për të punuar në njëvend pune të caktuar.

15.3 Në lidhje me Stafin Ekzistues që mbetet në vendet ekzistuese të punës, Autoriteti:

15.3.1 do të kryejë një analizë të punësimit alternativ të Stafit Ekzistues, përpara se të kryejë shkurtime kolektive nga puna (**"Plani i Punësimit Alternativ"**). Nëse analiza nuk përcakton ndonjë alternativë tjetër të suksesshme ndaj shkurtimeve, shkurtimet përgatiten dhe zbatohen për të zbutur ndikimet negative të shkurtimit ndaj punonjësve, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe pasqyron konsultimet e Autoritetit me punonjësit, organizatat e tyre në përputhje me marrëveshjet kolektive të punës. Në të gjitha fazat e procesit, Autoriteti respekton të gjitha kërkesat e Ligjit të Zbatueshëm dhe ato kontraktuale në lidhje me njoftimin e autoriteteve publike dhe dhënien e informacionit dhe konsultimet me punonjësit dhe organizatat e tyre. Autoriteti siguron që të gjithë punonjësit të marrin njoftim për largimin nga puna dhe pagesën e shkëputjes të detyruar me ligj dhe, nëse ka, sipas marrëveshjeve kolektive, në kohë. Të gjitha pagesat e prapambetura të papaguara dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore dhe kontributet e pensionit u paguhen punonjësve (i) në apo përpara përfundimit të marrëdhënies së punës, (ii) kur është e përshtatshme në favor të punonjësve, ose (iii) pagesa bëhet në përputhje me një afat kohor të rënë dakord përmes marrëveshjes kolektive. Kur bëhen pagesat në favor të punonjësve, punonjësve u jepen evidenca të pagesave të tilla. Autoriteti u siguron punonjësve një mekanizëm për adresimin e ankesave që rezultojnë nga hartimi dhe zbatimi i planit, dhe

15.3.2 punëson një ekspert të pavarur të punës që ka njohuri për Ligjin e Zbatueshëm dhe Standartin e Performancës 2 të IFC-së, me qëllim për të mbështetur Autoritetin në hartimin e Planit të Punësimit Alternativ, duke ndërmarrë procesin e konsultimeve dhe zbatuar planin në përputhje me detyrimet e këtij Neni 15.3.

Për shmangien e çdo dyshimi, Koncesionari nuk mban përgjegjësi ndaj Stafit Ekzistues në lidhje me marrëdhënien e tyre të punësimit (dhe përfundimin e saj) me Spitalet Referuese dhe/ose Autoritetin. Autoriteti do të dëmshpërblejë dhe do të përjashtojë Koncesionarin nga çdo pretendim i ngritur nga Stafi Ekzistues në lidhje me punësimin e tyre apo zgjidhjen e marrëdhënies së punës me Spitalet Referuese dhe/ose Autoritetin. Gjithashtu, asgjë në këtë Nen nuk interpretohet si një e drejtë e Koncesionarit për të shkelur apo vonuar kryerjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate në rast se Autoriteti nuk i përmbush pjesërisht apo plotësisht detyrimet e tij sipas këtij Neni 15.3

15.4 Personeli Kyç duhet të jetë staf i përhershëm i Koncesionarit, ose i Palëve të Lidhura të tij dhe duhet të jetë plotësisht i aftë, kompetent, i kualifikuar, dhe me përvojë në fushën dhe për vendin e punës të specifikuar në Planin e Rekrutimit, në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm, dhe kërkesat përkatëse për laboratorët mjekësorë.

Në rast zëvendësimi të ndonjë anëtari të Personelit Kyç, Koncesionari menjëherë i paraqet Autoritetit për koment dhe shqyrtim planin për zëvendësimin e këtij personi, përfshirë biografinë e detajuar të personit (personave) të përcaktuar si zëvendësues, me kusht që zëvendësuesi i Personelit Kyç të ketë të paktën kualifikime, akreditime, dhe (por jo ose) përvojë të barasvlershme me atë të personit që po zëvendësohet. Për aq sa është e mundur,

Koncesionari siguron që të ketë një periudhë minimumi prej dhjetë (10) ditësh mbivendosjeje midis personave në fjalë, për të lejuar një transferim të lehtë të përgjegjësive. Zëvendësimi i një anëtari të stafit të Koncesionarit, përfshirë edhe Personelin Kyç, bëhet vetëm me koston dhe shpenzimin e Koncesionarit. Autoriteti ka vetëm të drejtën e vetos për emërimin e Personelit Kyç brenda dhjetë (10) ditësh nga njoftimi, në rastet kur personat e propozuar nuk kanë kualifikimet, akreditimet dhe përvojën e personit që zëvendësohet.

15.5 Koncesionari miraton dhe zbaton politikat e burimeve njerëzore dhe procedurat e përshtatshme për madhësinë dhe numrin e punonjësve të tij, që përcaktojnë qasjen e tij ndaj administrimit të punonjësve në përputhje me kërkesat e Ligjit të Zbatueshëm. Koncesionari u jep punonjësve informacion të dokumentuar, që është i qartë dhe i kuptueshëm, në lidhje me të drejtat e tyre sipas Ligjit të Zbatueshëm për punësimin dhe çdo marrëveshje të zbatueshme kolektive, duke përfshirë të drejtat e tyre të lidhura me orët e punës, pagat, punën jashtë orarit, kompensimin dhe përfitimet kur fillojnë marrëdhënien e punës dhe kur ndodhin ndryshime me rëndësi materiale.

15.6 Koncesionari zhvillon dhe ruan praktika të shëndetit në punë dhe praktika të administrimit të sigurisë në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe Standardet e Performancës së IFC-së, për çdo punë që lidhet me ndërtimin /përshtatjen dhe si dhe gjatë operimit të Projektit dhe siguron që punonjësit të jenë të trajnuar si duhet për detyrën që u caktohet dhe që të jenë të pajisur me pajisjet e përshtatshme për mbrojtjen personale.

15.7 Gjatë Kohëzgjatjes së Kontrates, Koncesionari merr masa dhe ruan kapacitetet për trajnimin e personelit siç parashikohet në Shtojcën 19 (*Standardet e Shërbimit*).

16. NDËRVEPRIMI

16.1 Secila nga Palët punon me mirëbesim me qëllim lidhjen dhe nënshkrimin nga Koncesionari dhe secili Spital Referues, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve por në asnjë rast jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë pas Datës Efektive, të një Kontrate që parashikon masa të posaçme nga Koncesionari dhe secili prej Spitaleve Referuese në lidhje me çështjet e mëposhtme ("**Marrëveshjet e Ndërveprimit**"), dhe rreptësisht në përputhje me parimet parashikuara në këtë Kontrate në lidhje me këto çështje:

(a) realizimin e shërbimeve mjekësore laboratorike gjatë punëve rinovuese në periudhën midis Datës së Fillimit dhe Datës Reale të Komisionimit;

(b) shërbimet e zjarrfikëseve dhe të shpëtimit;

(c) shërbimet e sigurisë;

(d) hyrjet/daljet e pacientëve, pacientët e urgjencës dhe jo të urgjencës;

(e) hartimin e formularëve të referimit/rekomandimit të Spitalit Referues për Analizat në përputhje me Shtojcën 8 (*Procesi i Referimit*);

(f) trajnimin e studentëve të mjekësisë;

(g) procesin dhe dokumentacionin për referimin e pacientëve në përputhje me Procesin e Referimit;

(h) protokollet për bërjen e Analizave;

(i) menaxhimin administrativ të dokumenteve dhe të dhënave të pacientëve;

(j) përdorimin e Pajisjeve Ekzistuese në secilin prej Spitaleve Referuese;

(k) furnizimin me ujë dhe energji;

(l) çështje operative që nuk janë adresuar ndryshe në këtë Kontratë;

(m) të drejtat e përdorimit të Koncesionarit për Lokalet dhe Ambientet;

(n) kërkesat për marrjen e kampionëve të gjakut; dhe

(o) çdo çështje tjetër që mund të kërkohet për qëllime ndërveprimi.

16.2 Koncesionari i propozon Autoritetit një model Kontrate ndërveprimi dhe Autoriteti do të sigurojë dhe bëjëqë Spitalet Referuese të ofrojnë të gjithë asistencën e arsyeshme për të përfunduar dhe nënshkruar këtë kontratë. Nëse ndonjë nga Spitalet Referuese nuk bashkëpunon dhe në fund nuk nënshkruan marrëveshjet e ndërveprimit siç kërkohet në Nenin 16, Autoriteti do të ndërhyjë për të autorizuar Koncesionarin që të veprojë në bazë të marrëveshjes model të ndërveprimit njësoj sikur ajo të jetë nënshkruar nga Spitali Referues përkatës.

V MJETET E PUNËS DHE TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

17. ASETET E PROJEKTIT – SIGURIA

17.1 Gjatë gjithë Kohëzgjatjes, dhe pa cenuar Nenin 39, Koncesionari ruan titull të vlefshëm pronësie ndaj (i) Pajisjeve dhe (ii) FF&E-ve që nuk janë të trupëzuar në Ambiente.

17.2 Koncesionari nuk ka të drejtë të vendosë ndonjë interes sigurie (përveç garancisë që krijohet automatikisht me ligj) mbi Lokalet, Objektet Laboratorike, Marrëveshjet e Projektit ose policat e sigurimit, në favor të personave të tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit, i cili nuk duhet të mos jepet pa arsye.

18. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

18.1 Koncesionari do të sigurojë nga palë të treta përkatëse të drejta të tilla, duke përfshirë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, që i nevojiten për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë detyrimin sipas Nenit 18.2 më poshtë.

18.2 Koncesionari nëpërmjet kësaj Kontrate i jep Autoritetit një licensë jo përjashtuese, të pakthyeshme, dhe të përhershme pa pagesa honorarësh për të përdorur, dhe kopjuar për përdorimin e tij, të gjitha të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (i) ndaj të cilave Koncesionari ka titull pronësie dhe/ose (ii) të cilat Koncesionari ka të drejtë t'i përdorë, por vetëm në masën që të Drejta të tilla të Pronësisë Intelektuale kërkohen për ndonjërin nga Shërbimet.

18.3 Koncesionari dëmshpërblen dhe nuk fajëson Autoritetin dhe punëmarrësit, punonjësit, drejtorët, këshilltarët dhe agjentët e tij për ndonjë, apo për të gjithë paditë, proceset gjyqësore apo proceset administrative, kërkesat për dëmshpërblime, pretendimet, humbjet, dëmet e drejtpërdrejta,kostot dhe shpenzimet e çfarëdolloj natyre qofshin, duke përfshirë pagesat dhe shpenzimet e avokatit, të cilat mund t'i lindin Autoritetit si rrjedhojë e një shkeljeje apo shkeljeje të pretenduar të ndonjë të Drejte të Pronësisë Intelektuale, e cila rrjedh nga, dhe në lidhje me, ndonjë projekt, ndërtim, punë inxhinierike, material apo çdo punë apo shërbim tjetër të dhënë, të furnizuar apo realizuar nga, ose në emër të Koncesionarit; rast në të cilën zbatohen dispozitat e Nenit 40.4.

18.4 Dispozitat e këtij Neni 18 mbeten në fuqi edhe pas përfundimit apo mbarimit të kësaj Kontrate për çfarëdo arsye dhe janë pakufizuara në kohë.

VI RAPORTIMI DHE KONTROLLI

19. DETYRIMET E KONCESIONARIT PËR TË RAPORTUAR

19.1 Koncesionari i dorëzon Autoritetit duke vendosur në kopjePërfaqësuesin e FSDKSH-së, raportet e specifikuara në Shtojcën 2 (*Mekanizmi i Raportimit*) në numrin dhe shpeshtësinë e parashikuar në këtë Kontrate. Për formën e raporteve është rënë dakord me Autoritetin. Çdo raport që kërkohet të dorëzohet nga Koncesionari në lidhje me një periudhë kohe sipas Shtojcës 2, siç u tha më lart (qoftë raport mujor, tremujor apo vjetor apo ndryshe), dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh nga fundi i një periudhe të tillë.

19.2 Në rastin që Autoriteti mendon se një raport nuk është përgatitur si duhet apo përmban informacion apo të dhëna të gabuara, ai mund t'i dërgojë një njoftim Koncesionarit për këtë çështje brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e raportit, duke shprehur kundërshtimet e tij. Nëse një kundërshtim i tillë nuk zgjidhet me marrëveshje midis Palëve brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh pas dërgimit të njoftimit, atëherë secila nga Palët mund të dërgojë një Njoftim për Mosmarrëveshje Palës tjetër dhe në këtë rast zbatohen parashikimet e Nenit 43.

19.3 Nëse zgjidhja e një kundërshtimi të bërë sipas këtij Neni kërkon rishikim apo përshtatje të një raporti, atëherë Koncesionari, sa më shpejt që të jetë e praktikisht e mundur, përgatit një version të rishikuar të raportit të tij dhe një raport i tillë i rishikuar, për të gjitha qëllimet e kësaj Kontrate, zëvendëson raportin fillestar.

20. TË DREJTAT E AUTORITETIT PËR AUDITIM

20.1 Autoriteti ka të drejtë, sipas gjykimit dhe me shpenzimet e tij dhe me një njoftim paraprak një javor, të auditojë llogaritë dhe operacionet e biznesit të Koncesionarit që lidhen me Projektin në çdo kohë gjatë kësaj Kontrate, por jo më shpesh se një herë në vit. Auditimi nuk duhet të ndërpresë operacionet e biznesit të Koncesionarit.

20.2 Koncesionari i siguron Autoritetit qasje të plotë në llogaritë e tij, në masën që është e nevojshme për kryerjen e auditimeve të përshkruara në këtë Nen dhe i ofron Autoritetit asistencë të arsyeshme për të kryer auditimet e tij sipas këtij Neni.

20.3 Në lidhje me procedurat ESMS (Sistemet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social), Autoriteti ka mundësi që në çdo kohë, pas një njoftimi të arsyeshëm dërguar tek Koncesionari, të kryejë dhe t'i kërkojë një pale të tretë të kryejë kontrollin financiar (auditimin) e operacioneve të Koncesionarit në Objektet Laboratorike dhe Koncesionari bashkëpunon plotësisht me palën në fjalë për ta bërë të mundësuar një gjë të tillë dhesiguruar bashkëpunimin e stafit dhe nënkontraktorëve të tij.

20.4 Për të shqyrtuar përmbushjen nga Koncesionari të detyrimeve të tij mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë ("E&S") të parashikuara në këtë Kontratë dhe për t'i raportuar Autoritetit çështjet e mospërputhjes, Autoriteti ka të drejtë të caktojë një zyrtar/specialist nga sektori publik me ekspertizë në çështje E&S dhe njohuri të Standardeve të Performancës së IFC-se për t'u përgjigjur për sa më poshtë:

(a) të shqyrtojë ESMS të propozuar dhe procedurat e E&S para fillimit të Punimeve;

(b) gjatë punimeve, të ndërmarrë të paktën një vizitë inspektimi të objekteve për të verifikuar që procedurat standarde të veprimit dhe praktikat e mira të menaxhimit

resa: Rruga e I

janë ndjekur, në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar vetëm në to, procedurat dhe praktikat e shëndetit dhe sigurisë në punë. Në rast të mospërputhjes, të këshillojë për masat korrigjuese që duhet të ndërmerren nga Koncesionari dhe të bjerë dakord për afatin kohor për zbatimin e tyre dhe të verifikojë se ato do të zbatohen saktë dhe në kohë:

(c) gjatë vitit të parë të Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate dhe minimalisht për 3 vitet pasuese, të shqyrtojë që

- procedurat për trajtimin e mbetjeve mjekësore dhe materialeve të rrezikshme janë të njohura nga stafi përgjegjës dhe aplikohen në mënyrë korrekte;

- mbahen të dhëna të duhura për mbetjet e krijuara, objektet që përdoren për trajtimin dhe deponimin e tyre, dhe që leja e tyre është e vlefshme;

- procedurat në rast të emergjencës janë në vend dhe të njohura nga stafi përgjegjës;

(d) kontrollojë nëse ka pasur ankesa, dhe a janë adresuar ato; dhe

- Në fund të 3 viteve, të vlerësojë dhe përgatisë një raport ku të vërë në dukje nëse: (i) detyrimet E&S të parashikuara në këtë Kontrate janë plotësuar; dhe Koncesionari i ka gati procedurat dhe praktikat e përshtatshme për të menaxhuar (i) rreziqet dhe ndikimet E&S,. ii) monitorimin/zbatimin e E&S-së nga Entitetet përkatëse Shtetërore, për të mbuluar mjaftueshëm aspektet E&S të Projektit. Nëse plotësohen të dy kushtet, nuk do të ketë nevojë për kontrolle të mëtejshme vjetore. Në rastin që të paktën një prej të dy kushteve nuk plotësohet, Palët bien dakord për një plan të përgjithshëm kontrolli për Kohëzgjatjen e mbetur të Kontrates bazuar në risqet e identifikuara.

21. AUDITIMI I FSDKSH-SË

21.1 Koncesionari pranon se FSDKSH-ja ka të drejtë të auditojë të gjitha Analizat e porositura, faturat dhe raportet sipas kësaj Kontrate.

21.2 Në bazë të shqyrtimit të këtyre raporteve, FSDKSH-ja verifikon respektimin nga Mjekët Referues dhe Spitalet Referuese të protokolleve të porosive të Analizave dhe saktësinë e faturave të lëshuara nga Koncesionari sipas Nenit 23.2. FSDKSH-ja ka të drejtë të kryejë inspektime në vend, kontrolle dhe verifikime në Objektet Laboratorike të Koncesionarit në çdo kohë në rastin kur mendon se raportet apo informacioni i paraqitur nga Koncesionari mund të jetë i paplotë, ose mund të mos pasqyrojë drejtë situatën aktuale.

21.2.1 Gjatë auditimeve dhe inspektimeve në vend të FSDKSH-së, Koncesionari i mundëson FSDKSH-së akses të plotë në Objektet Laboratorike, në llogaritë e vetn dhe në çdo dokument dhe të dhënë rreth Pacientëve të Referuar, dhe raportet e Analizave, në masën që është e nevojshme për të kryer auditimet e përshkruara në këtë Nen dhe i jep asistencën e arsyeshme FSDKSH-së për të kryer auditimet e saj.

21.2.2 Auditimi nuk pengon veprimtarinë e punës së Koncesionarit.

VII ÇËSHTJE FINANCIARE

22. TARIFAT DHE TAVANET E BUXHETIT

22.1 Tarifat

Duke filluar nga Data Reale e Komisionimit të Objektit Laboratorik për secilin Spital Referues, Autoriteti siguron që këto Spitale Referuese t'i paguajnë Koncesionarit Tarifën e Shërbimit për të gjitha Analizat e kryera në bazë të rekomandimeve të Mjekëve Referues, gjithmonë mbi bazën e Tavanit të Buxhetit.

22.1.1 Tarifa e Shërbimit për një Spital Referues llogaritet në përputhje me tarifat e parashikuara në Shtojcën 3 (*Analizat dhe Tarifat e Shërbimit*) në bazë të Analizave të kryera nga Koncesionari gjatë një Periudhe Buxhetore për Pacientët e Referuar nga ai Spital Referues.

22.2 Tarifat e Shërbimit janë të përcaktuara për Kohëzgjatjen e kësaj Kontrate. Ato mund t'iu nënshtrohen rishikimeve për shkak të inflacionit dhe/ose kursit të këmbimit, në përputhje me formulat e mëposhtme:

22.2.1 **Rishikimi prej Inflacionit**

Rishkimi i Tarifës së Shërbimit prej inflacionit bëhet çdo tre vjet duke filluar prej Datës Reale të Komisionimit për Objektin e fundit Laboratorik të kompletuar dhe të komisionuar, rishikim ky i cili do të kryhet për herë të parë në datën e përvjetorit të tretë të Datës Reale të Komisionimit (ose nëse treguesi përkatës nuk ka qenë i publikuar në këtë datë, në datën e parë të publikimit të këtij treguesi); kjo do të quhet **"Data e Rishikimit"**.

Në rast se kjo normë është më pak se tre për qind (3%), nuk do të bëhet rishikim. Megjithatë, në rast se nuk ka korrigjim në një vit të veçantë, pas një periudhe tjetër tre vjecare, rishikimi do të bazohet në treguesit CPI të kohës t0 (dmth CPI6 deri CPI0).

Çmimi i rishikuar për këtë qëllim do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$If \left\{\left(\frac{CPI_3 - CPI_0}{CPI_0}\right) x\ 0.45 + \left(\frac{CPI_3^{Medical\ Care} - CPI_0^{Medical\ Care}}{CPI_0^{Medical\ Care}}\right) x\ 0.55\right\} \geq 0.03$$

$$Then\ P_i = P_0\ x\ [(\left(\frac{CPI_{t0+3} - CPI_{t0}}{CPI_{t0+3}}\right) x\ 0.45 + \left(\frac{CPI_{t0+3}^{Medical\ Care} - CPI_{t0}^{Medical\ Care}}{CPI_{t0+3}^{Medical\ Care}}\right) x\ 0.55) + 1]$$

ku,

P_0	është çmimi i referencës për çdo Analizë në Datën Efektive sipas listës së çmimeve në Shtojcën 3;
P_i	është çmimi i rishikuar për çdo Analizë;
T_0	është koha referencë, e cila për herën e parë do të jetë Data Reale e Komisionimit;
T_0+3	përvjetori i tretë pas datës së rishikimit të parë;
CPIi	është Indeksi i Çmimit të Konsumatorit në përvejtorin përkatës (ose data e publikimi të indeksit) minus Indeksin e Çmimit të Konsumatorit në Datën Efektive (ose në datën e parë të publikimit të tij pas Datës Efektive)/ Indeksin e Çmimit të Konsumatorit në Datën Efektive (ose në datën e parë të publikimit pas Datës Efektive), të publikuar nga Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT) sipas formulës së mëposhtme:

$$CPI_i = \left(\frac{CPI_{t0+3} - CPI_{t0}}{CPI_{t0}}\right)$$

CPIi Kujdesi Shëndetësor është Indeksi i Çmimit të Konsumatorit për Kujdesin Shëndetësor në përvjetorin përkatës (ose data e publikimit të indeksit) minus Indeksin e Çmimit të Konsumatorit për Kujdesin Shëndetësor në Datën Efektive (ose në datën e parë të publikimit të tij pas Datës Efektive)/ Indeksin e Çmimit të Konsumatorit për Kujdesin Shëndetësor në Datën Efektive (ose në datën e parë të publikimit pas Datës Efektive), siç është publikuar nga Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë (INSTAT), sipas formulës së mëposhtme:

$$CPI_{t}^{Medical\ Care} = \left(\frac{CPI_{t0+3}^{Medical\ Care} - CPI_{t0}^{Medical\ Care}}{CPI_{t0}^{Medical\ Care}}\right)$$

Pas miratimit të ndryshimeve, çmimi i ri i rishikuar (Pi) do të bëhet çmimi i referencës dhe CPIi dhe CPIi për Kujdesin Shëndetësor do të bëhet indeksi i referencës për përcaktimin e çmimit të rishikuar në çdo përvjetor të tretë të Datës Reale të Komisionimit për Objektin e fundit Laboratorik.

22.2.2 **Rishikimi prej rrezikut të kursit të këmbimit**

Rishikimi i Tarifës së Shërbimit për shkakt të rrezikut të kursit të këmbimit kryhet në bazë vjetore, duke filluar prej Datës Efektive, me kusht që ndryshimi vjetor mesatar i kursit të këmbimit EUR/LEK sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë për vitin e kaluar menjëhere pas datës përkatëse të përvjetorit të jetë më i lartë se 10%. Tarifa e Shërbimit për të gjitha Analizat do të rishikohet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Nëse } \left(\frac{P_i - P_0}{P_0}\right) > 10\% \text{ si pasojë e } \left(\frac{ER_i - ER_0}{ER_0}\right)$$
$$\text{atëherë } P_i = P_0 \times \left\{\left(\frac{ER_i - ER_0}{ER_0}\right) \times 0.3 + 1\right\}$$

ku,

P_0 është çmimi i referencës për çdo Analizë në Datën Efektive sipas listës së çmimeve në Shtojcën 3,

P_i është çmimi i rishikuar për çdo Analizë,

ER_0 është kursi i këmbimit i referencës EUR/LEK i publikuar nga Banka e Shqipërisë në Datën Efektive,

ER_i është kursi i këmbimit EUR/LEK publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën përkatëse të përvjetorit (nga Data Efektive).

por vetëm në rastin e rishikimit të çmimit për shkak të riskut të kursit të këmbimit në bazë të këtij Neni 22.2.2, normat e rishikuara për Tarifat e Shërbimit nuk mund të jenë më të ulta se Tarifat e Shërbimit të miratuara në Shtojcën 3.

Pas miratimit të ndryshimeve çmimi i ri i rishikuar (Pi) do të bëhet çmimi i referencës dhe ERi do të bëhet kursi i këmbimit të referencës për përcaktimin e çmimit të rishikuar në çdo përvjetor të Datës Efektive.

Për sa kohë nuk ka rishikim në një vit të veçantë, në vitin pasardhës rishikimi do të bazohet në treguesit përkatës të CPI në kohën t0 (dmth ER 2 deri ER0).

22.2.3 Rishikimet e Tarifës së Shërbimit prej inflacionit dhe rrezikut të kursit të këmbimit do të përllogariten nga Koncesionari dhe verifikohen nga Autoriteti. Rishikimi do të kryhet në rast se Tarifa e Shërbimit për një Analizë të veçantë apo një set Analizash është ndryshuar sipas kushteve të përcaktuara në pikat 22.2.1 dhe 22.2.2.

22.3 Kur, në një Periudhë të caktuar Buxhetore, Tarifa e përllogaritur e Shërbimit e kalon Tavanin e Buxhetit, Koncesionari ka të drejtë të përfitojë Tarifë Shërbimi mbi Tavanin e Buxhetit vetëm për Analizat e kryera për Pacientët e Referuar të pranuar pas datës në të cilën është arritur Tavani i Buxhetit dhe vetëm në bazë të Nenit 22.4 më poshtë.

22.4 Tavanet e Buxhetit

22.4.1 Në cdo Periudhë të caktuar Buxhetore, Koncesionari, do të njoftojë Drejtorin e Spitalit Referues, duke vënë në dijeni gjithshtu edhe Përfaqësuesin e Autoritetit dhe Përfaqësuesin e FSDKSH-së, brenda dy (2) ditëve nga data kur Tarifat e Shërbimeve të pagueshme për numrin e përgjithshëm të Analizave të kryera nga Koncesionari për çdo Spital Referues tejkalojnë:

(i) Pesëdhjetë përqind (50%),

(ii) Shtatëdhjetë e pesë përqind (75%), dhe

(iii) Njëqind përqind (100%),

përkatësisht të Tavanit të Buxhetit të zbatueshëm për atë Spital Referues.

22.4.2 Kur, në një Periudhë të vetme Buxhetore, Tarifat e Shërbimeve të pagueshme për numrin e përgjithshëm të Analizave të kryera nga Koncesionari për një Spital Referues arrijnë 75% të Tavanit të Buxhetit dhe Koncesionari e ka njoftuar Drejtorin e Spitalit Referues në përputhje me Nenin 22.4.1, Drejtori i Spitalit Referues brenda tre (3) ditësh informon me shkrim Koncesionarin, duke vënë në kopje Autoritetin dhe FSDKSH-në, në lidhje me vendimin e tij për të:

(a) vazhduar marrjen e Shërbimeve Mjekësore për të gjithë Pacientët e Referuar deri sa të arrihet 100% e Tavanit të Buxhetit (**Alternativa A**), ose

(b) vazhduar marrjen e Shërbimeve Mjekësore vetëm për Analizat Urgjente deri sa të arrihet 100% e Tavanit të Buxhetit (**Alternativa B**).

Nëse Koncesionari nuk merr përgjigje brenda tre (3) ditësh, ai vazhdon të ofrojë Shërbimet Mjekësore për Spitalin Referues në bazë të Alternativës B.

22.4.3 Kur arrihet plotësisht 100% e Tavanit të Buxhetit në muajin përkatës, Koncesionari ka detyrimin të ofrojë Analiza Urgjente pa pagesë për Spitalin Referues, brenda një vëllimi të lejuar që mbulon 5% të vëllimit të Analizave Urgjente të kryera për Spitalin Referues deri në përmbushjen e Tavanit të Buxhetit ("**Vëllimi i Lejuar**"). Përtej

Vëllimit të Lejuar, Koncesionari nuk ka detyrim të ofrojë ndonjë Shërbim Mjekësor për ndonjë pacient tjetër deri në fund të asaj Periudhe Buxhetore, përveçse kur udhëzohet shprehimisht me shkrim nga Drejtori i Spitalit Referues, sipas një buxheti shtesë së miratuar me shkrim nga Autoriteti osc FSDKSH-ja.

22.4.4 Të gjithë Pacientët e tjerë shtesë të Referuar përfshihen në një listë pritjeje dhe trajtohen me përparësi duke filluar nga Periudha tjetër Buxhetore e Spitalit Referues.

22.4.5 Pjesa e papërdorur e Tavanit Buxhetor për një Spital Referues për një Periudhë Buxhetore mund të alokohet tek një apo më shumë Spitalë të tjerë Referues sipas Nenit 23.1.3.

23. KUSHTET E PAGESËS

23.1 Financimi i Spitaleve dhe Buxhetimi Vjetor

23.1.1 Autoriteti garanton dhe Koncesionari pranon, se në lidhje me vitin e parë të shfrytëzimit (pra, viti financiar i Datës Reale të Komisionimit) një shumë e barabartë me Tavanin e Buxhetit për Periudhat Buxhetore të mbetura për vitin e parë të shfrytëzimit, caktohet nga FSDKSH-ja në llogarinë e Spitalit Referues në Thesarin e shtetit ekskluzivisht për pagesat e Koncesionarit për Tarifën e Shërbimit kur këto bëhen të pagueshme.

23.1.2 Në lidhje me vitin e dytë të shfrytëzimit (pra, viti financiar pas vitit të parë të shfrytëzimit) dhe çdo vit të ardhshëm të shfrytëzimit gjatë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, në përputhje me të gjithë Ligjet e Zbatueshëm, Autoriteti siguron që:

(a) në buxhetin vjetor të miratuar nga Këshilli i Ministrave (ose çdo Entitet Shtetëror tjetër, sic mund të jetë e zbatueshme kohë pas kohë) në lidhje me kujdesin spitalor, të përcaktohet një zë i posaçëm buxheti (për vit dhe për çdo Spital Referues) të dedikuar për pagesën e Tarifës së Shërbimit për Koncesionarin (**"Buxheti i Laboratorëve PPP"**), i cili, pra Tavani i Buxhetit Vjetor, mund të përshtatet herë pas here në përputhje me këtë Nen 23.1.3 të kësaj Kontrate;

(b) Buxheti i Laboratorëve PPP transferohet nga FSDKSH-ja në llogarinë e Spitalit Referues në thesarin e shtetit dhe përdoret nga Spital Referues vetëm për pagesën e Tarifës së Shërbimit në përputhje me këtë Kontratë.

23.1.3 Në lidhje me të gjithë vitet e shfrytëzimit, Autoriteti dhe FSDKSH-ja, *ex officio*, ose me kërkesën e Koncesionarit ose sipas rekomandimeve të Komitetit Ndërlidhës, mund të bëjnë përshtatje mujore ose tremujore në Tavanin e Buxhetit të një Spitali Referues përmes (i) rritjes së Tavanit të Buxhetit Vjetor dhe/ose (ii) shpërndarjes së pjesës së papërdorur të Tavanit të Buxhetit të një Spitali Referues për një Periudhë Buxhetore tek një apo më shumë Spitale të tjera Referuese. Përshtatje të tilla u bëhen të ditura me shkrim Spitaleve Referuese, Koncesionarit dhe Autoritetit.

23.2 Faturat – koha e pagesës

23.2.1 Analizat i referohen Koncesionarit nga Spitali Referues vetëm nëpërmjet Mjekëve Referues të identifikuar nga Autoriteti në bazë të të të dhënave unike identifikuese për ta dhe të njoftuara me shkrim Koncesionarit tridhjetë (30) ditë përpara Datës së Synuar të Komisionimit për secilin Objekt Laboratorik. Autoriteti e përditëson rregullisht bazën e të dhënave unike identifikuese të Mjekëve Referues dhe dëmshpërblen dhe e mban Koncesionarin të padëmtuar për çdo referim të parregullt për Analiza për shkak të mosnjoftimit nga Autoriteti të ndryshimeve në bazën e të dhënave unike

a: Rruga e Kavajës

identifikuese të Mjekëve Referues, siç kërkohet sipas këtij Neni 23.2.1. Është rënë dakord shprehimisht se në rastin e ndonjë vonese nga Autoriteti në njoftimin e Koncesionarit mbi të dhënat për Mjekët Referues përpara Datës së Synuar të Komisionimit, Kalendari i Projektit (duke përfshirë Datën e Synuar të Komisionimit) zgjatet përkatësisht me kohëzgjatjen e vonesës. Në çdo rast, Koncesionari nuk do të mbajë përgjegjësi për referime të gabuara nga Mjekët Referues.

23.2.2 Spitalit Referues në të cilin gjenerohet referimi i Analizave, do t'i faturohet nga Koncesionari Tarifa e Shërbimit për Analizat e referuara, pavarësisht nga Objekti Laboratorik ku do të kryhen këto Analiza. Referimi nga një Spital Referues në kuptim të këtij Neni përfshin referimin nga Mjekët Referues të qendrave të shërbimit shëndetësor parësor të lidhura me Spitalet Referuese sipas listës së njoftuar Koncesionarit mbi bazën e nenit 23.2.1.

23.2.3 Koncesionari do të lëshojë në datën e fundit të çdo muaji pas Datës Reale të Komisionimit të Objektit të parë Laboratorik për Tarifat e Shërbimit në ngarkim të Spitalit Referues për Periudhën aktuale Buxhetore (një faturë për çdo Spital Referues), fatura të cilat do të përfshijnë numrin e identifikimit të Spitalit Referues, Periudhën përkatëse Buxhetore, dhe do të shoqërohen me një raport të detajuar elektronik i cili do të përfshijë informacionin e mëposhtëm (i) kohën dhe orën (ii) numrin identifikues të pacientit (iii) numrin identifikues të Analizës (iv) numrin e identifikimit të Spitalit Referues (v) të dhënat unike identifikuese të Mjekut Referues (vi) numrin e referencës të formularit të referimit dhe, (vii) një nga dy kopjet e e formularit të referimit të marrë nga Koncesionari. Koncesionari do të sigurojë dorëzimin e faturës në Spitalin Referues brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e lëshimit.

23.2.4 Koncesionari, në diskrecionin e tij të vetëm, mund të zgjedhë t'u dërgojë Spitaleve Referuese fatura javore.

23.2.5 Spitali Referues paguan Tarifat e faturuara të Shërbimit brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e faturës bashkë me të gjitha dokumentet shoqëruese të kërkuara sipas Nenit 23.2.3

23.2.6 Nëse Spitali Rekomandues kundërshton shumat e paraqitura në ndonjë faturë të lëshuar nga Koncesionari, ai (i) brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja e faturës, i dërgon njoftim Koncesionarit me arsyet e tij për këtë kundërshtim, dhe (ii) i paguan Koncesionarit pjesën e pakundërshtuar të faturës pasi ky i fundit të ketë ri-lëshuar një faturë të korrigjuar në lidhje me pjesën e kundërshtuar, duke marrë parasysh komentet e dërguara nga Spitali Referues, dhe/ose (ii) i bën një kërkesë Autoritetit për të verifikuar dhe vërtetuar faturën. Për shmangien e çdo dyshimi, një faturë e pakundërshtuar brenda afatit, konsiderohet e pranuar.

23.2.7 Autoriteti është përgjegjës për verifikimin dhe vërtetimin e shumës së kundërshtuar, që është e kërkueshme dhe e pagueshme nga Spitali Referues për Koncesionarin dhe lëshon një vërtetim për faturën e kundërshtuar, apo për atë pjesë të kundërshtuar të faturës ("**Vërtetim Pagese**") për Koncesionarin brenda 7 (shtatë) ditësh nga data e marrjes së faturës që është në verifikim. Autoriteti njëkohësisht i lëshon Spitalit Referues një kopje të Vërtetimit të Pagesës.

23.2.8 Autoriteti duhet të garantojë që Spitali Referues do të paguajë të gjithë shumat e verifikuara me një Vërtetim Pagese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve punë nga marrja e Vërtetimit të Pagesës.

23.3 Pagesat e kundërshtuara

23.3.1 Nëse Koncesionari kundërshton një vendim të marrë nga Autoriteti në një Vërtetim Pagese, ai, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve punë nga marrja e Vërtetimit të Pagesës, mund të përshkallëzojë mosmarrëveshjen duke e paraqitur përpara Komitetit Ndërlidhës, i cili nga ana e tij e shqyrton mosmarrëveshjen e paraqitur nga Koncesionari në takimin tjetër të parë të parashikuar, i cili nuk duhet të zhvillohet më vonë se tre (3) muaj nga data e njoftimit të Koncesionarit. Nëse Komiteti Ndërlidhës konfirmon me shkrim pagesën e faturës ose pjesën e kundërshtuar të faturës në favor të Koncesionarit, Autoriteti siguron që Spitalet Referuese të paguajnë të gjitha shumat e konfirmuara nga Komiteti Ndërlidhës me shkrim, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve punë nga vendimi i Komitetit Ndërlidhës. Në rast se kundërshtimi nuk zgjidhet nga Komiteti Ndërlidhës brenda një periudhe prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e njoftimit të kundërshtimit nga Koncesionari, Koncesionari ka të drejtë t'i dërgojë Autoritetit një Njoftim për Mosmarrëveshje dhe në këtë rast zbatohen parashikimet e Nenit 43.

23.4 Pagesat e vonuara

Në rastin kur Tarifa e Shërbimit, sipas rastit: (i) e pakundërshtuar nga Spitali Referues; ose (ii) e vërtetuar rregullisht me një Vërtetim Pagese; ose (iii) e konfirmuar nga Komiteti Ndërlidhës, nuk është paguar brenda periudhës së përcaktuar në Nenin 23.2 dhe Nenin 23.3, Autoriteti siguron që Spitali Rekomandues t'i paguajë Koncesionarit interesin e pagesës së vonuar të llogaritur sipas Ligjit të Zbatueshëm, ose në rast të mungesës së parashikimit në Ligjin e Zbatueshëm, pesë për qind (5%) në vit mbi shumat e papaguara të Tarifës së Shërbimit. Një interes i tillë paguhet tridhjetë (30) ditë pasi fatura bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme.

24. DËMET E LIKUIDUESHME DHE PENALITETET E PERFORMANCËS

24.1 Faza e Punimeve

24.1.1 Koncesionari i paguan Autoritetit sanksionet e mëposhtme (**"Dëmet e Likuidueshme"**) në përputhje me Nenin 11.3.2:

(a) 500 Euro (pesëqind) për çdo ditë vonese nga dita e parë (1) deri në ditën e 30-të nga Data e Synuar e Komisionimit për secilin Spital Referues;

(b) 700 Euro (shtatëqind) për çdo ditë vonese nga dita e 31-të deri në ditën e 60-të nga Data e Synuar e Komisionimit për secilin Spital Referues; dhe

(c) 1,000 Euro (një mijë) për çdo ditë vonese nga dita e 61-të deri në ditën e 90-të nga Data e Synuar e Komisionimit për secilin Spital Referues, pas të cilës Autoriteti ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë për Rast Mospërmbushje të Koncesionarit në përputhje me Nenin 37.1.

24.1.2 Çdo shumë që i paguhet Autoritetit nga Koncesionari si Dëm i Likuidueshëm, sipas këtij Neni 24.1, përbën dëmshpërblimin e vetëm dhe ekskluziv për Autoritetin për këto raste dhe vleërsohet si një përllogaritje e saktë e dëmit të pësuar nga Autoriteti.

24.1.3 Pa cenuar dispozitën e përgjithshme të Nenit 26.1, Dëmet e Likuidueshme paguhen brenda tridhjetë (30) ditësh nga kërkesa e Autoritetit, në rast të kundërt Autoriteti ka të drejtë të tërheqë shumën e barasvlefshme nga Garancia e Performancës.

24.1.4 Në rastin kur Dëmet e Likuidueshme nuk paguhen brenda periudhës së parashikuar në Nenin 24.1.3, Koncesionari detyrohet t'i paguajë Autoritetit një interes prej 5% për pagesën e vonuari cili bëhet i kërkueshëm tridhjetë (30) ditë pas marrjes nga

Koncesionari të kërkesës për të paguar Dëmet e Likuidueshme.

24.2 Periudha e Shërbimeve

24.2.1 Nëse është e zbatueshme, Autoriteti i kërkon Koncesionarit të paguajë në baza tremujore, Penalitetet e Performancës të lidhura me shkeljet prej Koncesionarit të Treguesve të Performancës gjatë Periudhave përkatëse Buxhetore për tremujorin përkatës dhe të llogaritura në përputhje me Shtojcën 14 (*Treguesit e Performancës dhe Penalitetet*) me kusht që, kur shuma e Penaliteteve të Performancës që duhet paguar sipas këtij Neni e kalon shumën prej 700,000 Euro (shtatëqind mijë), pjesa e tejkaluar e kësaj shume shtyhet për Periudhën tjetër Buxhetore tremujore.

24.2.2 Të gjitha Penalitetet e Performancës sipas këtij Neni përbëjnë dëmshpërblimin e vetëm dhe ekskluziv për Autoritetin për këto raste dhe vlerësohen si një përllogaritje e saktë e dëmit të pësuar nga Autoriteti.

24.2.3 Pa cenuar dispozitën e përgjithshme të Nenit 26.1, Penalitetet e Performancës paguhen brenda tridhjetë (30) ditësh nga kërkesa e Autoritetit ose ashtu siç parashikohet ndryshe në Nenin 24.2.1, në rast të kundërt Autoriteti ka të drejtë të tërheqë një shumë të barasvlershme nga Garancia e Performancës.

24.2.4 Në rastin kur Penalitetet e Performancës nuk janë paguar brenda periudhës së parashikuar në Nenin 24.2.3, Koncesionari është ka detyrimin t'i paguajë Autoritetit një interes prej 5% për pagesën e vonuar i cili bëhet i kërkueshëm tridhjetë (30) ditë pas marrjes nga Koncesionari të kërkesës për të paguar Penalitetet e Performancës, ose pas ditës kur pagesa bëhet e kërkueshme në përputhje me Nenin 24.2.1.

24.2.5 Rasti i mëposhtëm përbën një Rast i Mospërmbushjes së Koncesionarit: shuma e përgjithshme e Penaliteteve të Performancës që është paguar nga Koncesionari sipas kësaj Kontrate arrin shumën maksimale të përcaktuar në Nenin 24.2.1 për dy Periudha Buxhetore tremujore të njëpasnjëshme.

25. DËMET INDIREKTE

Për sa kohë lejohet nga Ligji i Zbatueshëm, as Autoriteti as Koncesionari nuk do të mbajnë përgjegjësi ndaj Palës tjetër sipas kësaj Kontrate për dëme indirekte ose shkakësoreqë mund t'i jenë shkaktuar Palës tjetër.

26. GARANCIA E PERFORMANCËS

26.1 Si garanci për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të Koncesionarit sipas Kontratës, qoftë kur penalizohet nga pagesa e Dëmeve të Likuidueshme apo në ndonjë rast tjetër, Koncesionari i dorëzon Autoritetit, në përputhje me Nenin 4, një garanci të nënshkruar rregullisht në formën e parashikuar në Shtojcën 15 (*Forma e Garancisë së Performancës*) e lëshuar nga një bankë e njohur e pranueshme për Autoritetin, të një shume të barabartë me 700,000 Euro (shtatëqind mijë) e cila do të ruhet gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Pasi Autoriteti merr Garancinë e Performancës, ai menjëherë i kthen Koncesionarit Garancinë e Ofertës. Garancia e Performancës i kthehet Koncesionarit brenda tridhjetë (30) ditësh nga tejkalimi i Kohëzgjatjes ose nga data kur kjo Kontratë zgjidhet para kohe, cilado qoftë e para. Garancia e Performancës do të jetë një garanci e lëshuar nga një nga bankat më të mëdha në Shqipëri, sa i takon totalit të aktiveve, e regjistruar nga Banka e Shqipërisë dhe që nuk është në proces likuidimi dhe që renditet në Raportin e Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë si bankë e nivelit më të lartë të mundshëm në Shqipëri.

26.2 Kur Garancia e Performancës i nënshtrohet, sipas kushteve të saj, një date fikse përfundimi, Koncesionari, jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë përpara kësaj date, e ndryshon ose e zëvendëson Garancinë e Performancës, sipas rastit, me një garanci të ndryshuar rregullisht apo një garanci zëvendësuese. Çdo zëvendësim i Garancisë së Performancës bëhet nga një bankë e njohur me rankim të barasvlershëm me lëshuesin e parë dhe miratohet nga Autoriteti dhe do të ketë kushte identike. Nëse Koncesionari nuk arrin të sigurojë një Garanci Performance, të ndryshuar apo të zëvendësuar sikurse kërkohet në këtë Nen, Autoriteti mund të tërheqë nga Garancia ekzistuese e Performancës shumën e plotë të disponueshme në të dhe ka të drejtë ta mbajë një shumë të tillë si garanci për përmbushjen e detyrimeve nga Koncesionari sipas kësaj Kontrate deri sa Koncesionari të sigurojë zëvendësimin e Garancisë së Performancës (në të cilin moment shuma e tërhequr i kthehet Koncesionarit pa detyrim për të paguar interes).

26.3 Koncesionari ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që shuma e Garancisë së Performancës së parashikuar në Nenin 26.1 të jetë e disponueshme në çdo kohë.

27. SIGURIMET

27.1 Koncesionari me shpenzimet e veta nënshkruan dhe mban në fuqi gjatë gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate të gjitha sigurimet e përcaktuara në Shtojcën 16 (*Sigurimet e kërkuara*) dhe çdo sigurim tjetër shtesë që mund të kërkohet nga Ligjet e Zbatueshme që mbulojnë Punimet dhe Shërbimet. Mosrespektimi i këtij Neni përbën një Rast Mospërmbushje të Koncesionarit.

27.2 Të gjitha policat e sigurimit që Koncesionari nënshkruan dhe mban gjatë gjithë Kohëzgjatjes së kësaj Kontrate përfshijnë, sipas praktikës së arsyeshme të tregut, heqjen dorë nga e drejta e regresit të siguruesve kundrejt Autoritetit dhe punonjësve të tij dhe do të emërojnë Autoritetin si të bashkësiguruar me çdo palë tjetër që mban sigurimin.

27.3 Sigurimet e nënshkruara nga Koncesionari konsiderohen gjithnjë si sigurime parësore në lidhje me çdo sigurim të nënshkruar nga Autoriteti.

27.4 Pa cenuar kushtet e Shtojcës 16 (*Sigurimet e kërkuara*), pas ndodhjes së një ngjarjeje apo një seri ngjarjesh që mund të bëhen shkak për pretendime të mundshme sipas policave të sigurimit të kërkuara nga Koncesionari, Palët bien dakord që të takohen sa më shpejt për të (i) diskutuar rrethanat që mund të bëhen shkak për një pretendim apo pretendime të mundshme, dhe (ii) mbulimin e disponueshëm sipas policave të sigurimit të Koncesionarit. Pas një takimi të tillë, Koncesionari bie dakord që:

(a) të kërkojë të gjitha riparimet dhe kompensimet e disponueshme sipas policave të sigurimit dhe

(b) të ardhurat e marra nga siguruesit të përdoren plotësisht për të mbuluar kostot apo shpenzimet që kanë lindur, ose që do të lindin, si rrjedhojë e një ngjarjeje apo rrethane prej të cilës lind pretendimi, duke përfshirë riparimin apo rindërtimin e ndonjë Objekti Laboratorik apo zëvendësimin e ndonjë Pajisjeje apo FF&E.

28. TARIFA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT

28.1 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga miratimi i kësaj Kontrate nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenin 4.2.4, Koncesionari i paguan International Financial Corporation (IFC) një shumë prej 600,000 Euro (gjashtëqind mijë euro) ("**Tarifa e Zhvillimit të Projektit**") në një apo dy këste të barabarta, sipas diskrecionit të Koncesionarit, por në cdo rast si kusht paraprak për Datën e Fillimit sipas Nenit 4.2.2 (b). Tarifa e Zhvillimit të Projektit do të paguhet në llogarinë bankare të njoftuar Koncesionarit nga IFC-ja, në Euro, me fonde të disponueshme menjëherë, pa asnjë zbritje për efekt tatimesh, taksash apo pagesash të tjera ose pa zbritur pagesa të tjera (të cilat përballohen të gjitha nga Koncesionari).

28.2 Pa cënuar Nenin 4.2.2, nëse Koncesionari nuk i paguan IFC-së Tarifën e Zhvillimit të Projektit në përputhje me Nenin 28.1 mësipër, atëherë Autoriteti ka të drejtë të:

(a) të zbresë shumën që duhet t'i paguhet Koncesionarit nga shumat që bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme nga çdo Spital Referues dhe/ose nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në favor të Koncesionarit,

dhe nga këto të ardhura t'i paguajë IFC-së Tarifën e Zhvillimit të Projektit.

Nëse një shumë që i paguhet IFC-së nga Autoriteti në emër të Koncesionarit është e pamjaftueshme për të paguar të gjithë Tarifën e Zhvillimit të Projektit, atëherë pjesa e papaguar e Tarifës së Zhvillimit të Projektit përbën një borxh kundrejt IFC-së, i cili është i kërkueshëm në cdo kohë.

VIII NDRYSHIMI

29. [*NUK PËRDORET*]

30. NDRYSHIMI

30.1 Për aq sa lejohet nga Ligji i Zbatueshëm, Autoriteti ka të drejtë të propozojë herë pas here gjatë Kohëzgjatjes ndryshime, modifikime, shtesëa apo heqje në lidhje me Objektet Laboratorike, Shërbimet apo Tarifën e Shërbimit ("**Ndryshim**"), duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në to, shtimin e Analizave të reja në Shtojcën 3 (*Analizat dhe Tarifat e Shërbimit*) apo heqjen e Analizave të caktuara. Kur Autoriteti dëshiron të shtojë Analiza të reja, ai e njofton Koncesionarin për qëllimin e tij dhe për vëllimin e pritshëm të këtyre Analizave. Koncesionari nuk bën asnjë Ndryshim përpara se Autoriteti të miratojë një Urdhër Ndryshimi sipas Nenit 30.3.

30.2 Koncesionari ka të drejtë që herë pas here, gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, t'i propozojë Autoritetit ndonjë Ndryshim të cilin Koncesionari e konsideron të nevojshëm apo të dëshirueshëm për të përmirësuar cilësinë, efikasitetin apo sigurinë e Shërbimeve ose për arsye ekonomike. Autoriteti mundet sipas gjykimit të tij të miratojë apo refuzojë një Ndryshim të propozuar nga Koncesionari. Koncesionari nuk do të kryejë asnjë Ndryshim deri sa Autoriteti të ketë miratuar një Urdhër Ndryshimi në bazë të Nenit 30.3.

30.3 Nëse njëra nga Palët propozon një Ndryshim, atëherë Koncesionari përgatit dhe i jep Autoritetit sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur, por gjithsesi brenda tridhjetë (30)

ditësh nga data e Ndryshimit të propozuar, një memorandum me shkrim ku përcakton hollësitë e plota të një Ndryshimi të tillë, duke përfshirë:

(a) arsyet e tij;

(b) përshkrimin e Ndryshimit (Shërbimet që kërkohen apo nuk kërkohen më, Pajisjet apo softueri që duhet ndryshuar, shtimi i Analizave të reja, etj);

(c) një vlerësim të kostos për zbatimit e Ndryshimit, shoqëruar me një propozim për financimin dhe pagesën e saj. Në rastin e një propozimi për të shtuar një analizë të re, Koncesionari propozon një çmim për analizat e reja, duke përfshirë një përshkrim të hollësishëm të llogaritjes të çmimit, si edhe 3 referenca nga shtete të tjera. Në rastin e propozimit për ndryshimin e Tarifës së Shërbimit, Koncesionari propozon tarifat e reja nëse këto janë të justifikuara nga rritja e shpenzimeve operacionale ose vlerësime e referenca nga shtete të tjera.

(d) çdo ndryshim të kësaj Kontrate që do të nevojitej në lidhje me Ndryshimin;

(e) çdo efekt që një Ndryshim i tillë mund të ketë ndaj Shërbimeve dhe Objekteve Laboratorike; dhe

(f) një plan (duke përfshirë një kalendar) për zbatimin e Ndryshimit.

30.4 Kur çmimi i propozuar nga Koncesionari për analizat e reja nuk është i kënaqshëm për Autoritetin, Autoriteti mund të propozojë çmime të reja bazuar në një shqyrtim të pavarur të çmimeve apo kuotime për çmime nga ofrues të tjerë. Nëse Autoriteti dhe Koncesionari arrijnë një marrëveshje për të gjitha çështjet e identifikuara në deklaratën me shkrim të dhënë nga Koncesionari, atëherë Autoriteti mund të miratojë një Urdhër Ndryshimi i cili mundëson zbatimin e ndryshimeve(një **"Urdhër Ndryshimi"**). Një Urdhër Ndryshimi përmban një përshkrim të Ndryshimit, çdo përshtatje të kushteve financiare të Kontrates (duke përfshirë çdo ndryshim të Tarifës së Shërbimit) dhe të gjitha modifikimet e tjera të kësaj Kontrate dhe nënshkruhet nga Autoriteti dhe Koncesionari. Një Ndryshim i tillë bëhet kështu pjesë e Kontratës.

30.5 Kur Autoriteti dhe Koncesionari nuk mund të bien dakord në lidhje me një Ndryshim brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e memorandumit të përmendur në Nenin 30.3 për shtimin e analizave të reja në Shtojcën 3 (*Analizat dhe Tarifat e Shërbimit*) apo Spitalet Referuese të Projektit sipas Nenit 3.3, Autoriteti është i lirë të kërkojë këtë Ndryshim përmes një procesi konkurrues në të cilin mund të marrë pjesë edhe Koncesionari.

30.6 Asnjë udhëzim, koment, miratim apo mosmiratim nga Autoriteti (qoftë me iniciativën e tij apo në përgjigje të një propozimi të Koncesionarit) muk do të konsiderohet si Ndryshim. Në rast se Koncesionari mendon se një udhëzim, koment, miratim apo mosmiratim nga Autoriteti është apo duhet të jetë subjekt i një Ndryshimi, ai duhet të përgatitë dhe t'i japë Autoritetit një deklaratë me shkrim që përmban hollësitë e parashikuara në Nenin 30.3 brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, apo brenda një afati më të gjatë të rënë dakord mes Palëve, nga data e udhëzimit, komentit, miratimit apo mosmiratimit, rast në të cilin Autoriteti ose (i) kërkon zyrtarisht një Ndryshim, (ii) tërheq udhëzimin, komentin, miratimin apo mosmiratimin, ose (iii) e udhëzon Koncesionarin se nuk bëhet fjalë për një Ndryshim. Në rast se Koncesionari e përmbush udhëzimin, komentin, miratimin apo mosmiratimin e Autoritetit, pa e bërë një deklaratë të tillë brenda afatit të përcaktuar, ose përpara se të bëjë një deklaratë të tillë, atëherë konsiderohet se Koncesionari pranon se përmbushja nga ana e tij nuk përbën Ndryshim ose ai nuk ka të drejtë të përfitojë ndonjë pagesë shtesë, zgjatje të afatit, apo ndonjë ndryshim tjetër të të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas Kontratës.

30.7 Pavarësisht çdo dispozite të kundërt, çdo ndryshim që bëhet për shkak të ndonjë mospërmbushje të detyrimeve kontraktore të Koncesionarit gjatë zbatimit së kësaj Kontrate, nuk i jep të drejtë Koncesionarit të rrisë Tarifën e Shërbimit, të marrë ndonjë pagesë shtesë nga Autoriteti, apo nga një Spital Referues, ose të bëjë ndonjë përshtatje të Kërkesave Teknike Minimale.

IX FORCA MADHORE, FORCA MADHORE POLITIKE DHE NDRYSHIMI NË LIGJ

31. FORCA MADHORE

31.1 Një **"Ngjarje e Forcës Madhore"** është çdo rrethanë që nuk është nën kontrollin e arsyeshëm, të drejtpërdrejt apo të tërthortë, të Palës së prekur (**"Pala e Prekur"**) që rezulton, apo shkakton dështim të plotë apo të pjesshëm të Palës së Prekur në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate (me përjashtim të pagesës së parave), por vetëm kur dhe në masën që:

(i) kjo rrethanë, pavarësisht nga ushtrimi i korrektesës së arsyeshme, nuk mund të pengohet apo nuk mund ishte penguar, shmangur apo hequr nga Pala e Prekur;

(ii) Pala e Prekur mori apo ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, ka treguar kujdesin e duhur dhe marrë masat e arsyeshme alternative për të shmangur efektin e një ngjarjeje të tillë në mundësinë e Palës së Prekur për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;

(iii) ngjarja nuk është, ose nuk ishte, rezultat i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i shkeljes nga Pala e Prekur e ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate; dhe

(iv) Pala e Prekur i ka dhënë njoftim Palës tjetër brenda shtatë (7) ditëve pas zbulimit të Palës së Prekur të ngjarjes, bashkë me një raport që përcakton natyrën e kësaj ngjarjeje dhe masave që ka marrë dhe planifikon të marrë në mënyrë që të shmangë ose zbusë efektet e ngjarjes.

Ngjarjet e Forcës Madhore përfshijnë rrethanat e mëposhtme me kusht që ato të plotësojnë kriteret e parashikuara në përkufizimin e Ngjarjes së Forcës Madhore më lart:

(i) akt lufte, pushtim, apo akt i një armiku të jashtëm, apo akt terrorizmi, bllokadë, embargo, racionim, që në secilin rast ndodh brenda apo që përfshin Republikën e Shqipërisë;

(ii) akte rebelimi, trazira civile, greva me natyrë politike, akte fushate terrorizmi, apo sabotazh me natyrë politike që në çdo rast ndodhin brenda Republikës së Shqipërisë;

(iii) rrufe, zjarr, tërmet, stuhi, ciklon, tajfun, tornado apo fatkeqësi të tjera natyrore; dhe

(iv) greva, punë minimale apo ngadalësim të punës gjatë grevave (me përjashtim të punëmarrësve të Palës që pretendon se ajo është një Ngjarje e Forcës Madhore apo ndonjërit prej aksionarëve të një Pale të tillë, ose punëmarrësve të një pale të lidhur drejtpërdrejt apo tërthorazi me të, të shoqërisë mëmë apo të filialit të ndonjë aksionari të kësaj Pale).

Pavarësisht çdo parashikimi të kundërt në këtë Nen 31.1, epidemitë nuk përbëjnë një Ngjarje të Forcës Madhore, përveçse kur Spitali Referues mbyllet për të njëjtën arsye me urdhër administrativ.

31.2 Pala e Prekur justifikohet për mospërmbushjen e detyrimeve dhe nuk interpretohet se është në shkelje të detyrimeve të saj në lidhje me Kontratës për sa kohë që, dhe në masën që, një mospërmbushje e tillë vjen për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore. Pala e Prekur ka për detyrë të zbusë efektet e Ngjarjes së Forcës Madhore.

31.3 Pala e Prekur ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë, në përputhje me Nenin 37, në rrethanat e mëposhtme:

(a) përfundimi i Punimeve apo kryerja e Shërbimeve pengohet, vështirësohet apo vonohet në mënyrë të konsiderueshme për më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë të njëpasnjëshme për shkak të një apo më shumë Ngjarjesh të Forcave Madhores; ose

(b) ndodhia e Ngjarjeje të Forcës Madhore është e tillë që efektet e saj duken qartë dhe pa mëdyshje se do të pengojnë apo vonojnë përfundimin e Punimeve apo kryerjen e Shërbimeve për një periudhë të vazhdueshme prej të paktën nëntëdhjetë (90) ditësh, ku

(secila është një **"Ngjarje e Zgjatur e Forcës Madhore"**).

32. FORCË MADHORE POLITIKE

32.1 **"Ngjarja Politike e Forcës Madhore"** është çdo veprim apo mosveprim i një Entiteti Shtetëror i përcaktuar në Nenin 32.2 që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe që nuk mund të ishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme, që ka një efekt të keq material në (i) mundësinë e Koncesionarit për të respektuar dhe përmbushur një prej të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas Kontratës, dhe/ose (ii) realizuar koston apo fitimet e një pune të tillë.

32.2 Rrethanat e mëposhtme përbëjnë Ngjarje Politike e Forcës Madhore me kusht që këto rrethana të plotësojnë kriteret e parashikuara në Nenin 32.1:

(a) mosdhënia e ndonjë lejeje që kërkohet për qëllimet e përmbushjes së rregullt nga Koncesionarit të detyrimeve të tij dhe zbatimit të të drejtave të tij sipas kësaj Kontrate në vijim dhe për aq sa Koncesionari ka depozituar një aplikim të plotë për këtë qëllim dhe ka përmbushur të gjitha hapat e nevojshëm dhe të dëshirueshem për të marrë këtë Leje me përpjekjet e tij, përveç se kur ky mosveprim provohet se rezulton drejtpërdrejt dhe ekskluzivisht nga mosrespektimi i Ligjit të Zbatueshëm prej Koncesionarit;

(b) shpronësimi, rekuizimi, konfiskimi apo shtetëzimi i Objekteve Laboratorike ose ndonjë pjesë të tyre;

(c) ndalimi apo kufizimi i (i) shpërndarjes së dividendëve të ortakëve të Koncesionarit apo mjeteve të tjera të ri-atdhesimit apo transferueshmërisë së fitimeve apo të ardhurave të Koncesionarit dhe/ose (ii) shërbimet e huasë me përparësi nga Koncesionari (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet e këmbimit të monedhës së huaj);

(d) urdhri për të mbyllur një apo disa apo të gjithë Spitalet Referuese për një kohë që i kalon shtatë (7) ditë për çdo arsye të ndryshme nga ato të parashikuara në Nenin 31.1; dhe

(e) çdo akt që prek ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese apo zbatueshmërinë e Kontratës.

32.3 Brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i Autoritetit për një Ngjarje Politike të Forcës Madhore, Autoriteti siguron zgjidhje ligjore të Ngjarjes Politike të Forcës Madhore në fjalë.

32.4 Nëse Autoriteti nuk mund të sigurojë një zgjidhje të Ngjarjes Politike të Forcës Madhore përpara përfundimit të periudhës tridhjetë (30) ditore, Palët diskutojnë menjëherë mundësinë për të arritur një zgjidhje të kënaqshme për të dyja Palët me qëllim për ta rikthyer Koncesionarin në pozitën që do të kishte qenë (duke përfshirë kompensim për kostot dhe fitimin e munguar) në rast se një Ngjarje e tillë Politike e Forcës Madhore nuk do të kishte ndodhur. Në rast se Autoriteti nuk arrin të korrigjojë apo rikthejë situatën brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i një konsultimi të tillë (ose nëse Autoriteti nuk ka arritur apo nuk ka pranuar të diskutojë), Koncesionari ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me Nenin 37.2.

33. NDRYSHIMI NË LIGJ

33.1 **"Ndryshimi në Ligj"** është miratimi dhe hyrja në fuqi, pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, të një ligji, statuti, rregulloreje, urdhri, udhëzimi, standardi detyrues, apo ndonjë instrumenti tjetër ligjor, apo shpalljes së një interpretimi apo gjykimi me efekt detyrues, nga një Entitet Shtetëror, i cili (i) nuk ishte i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme në datën e nënshkrimit të Kontratës; dhe (ii) ndryshon koston e përgjithshme vjetore të Koncesionarit, duke përfshirë tatimet e përgjithshme të pagueshme nga Koncesionari mbi xhiron e tij (qoftë si rezultat i tatimeve të reja, rritjes së shkallës së tatimeve, ndryshimeve në bazën tatimore apo në metodën e llogaritjeve, modifikimeve të rregullave për përjashtimet, zbritjet apo tavanet, ose të tjera por, duke përjashtuar çdo ndryshim për tatimin mbi fitimin) për të respektuar dhe përmbushur të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate në mënyrë normale me më shumë se 5%.

33.2 Secila nga Palët mund ta njoftojë Palën tjetër për rastet e një Ndryshimi në Ligj. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i Palës tjetër për një Ndryshim në Ligj, Pala tjetër paraqet një propozim për të ndryshuar Kontratën, me qëllim për t'i kthyer Palët në pozitën që do të kishin pasur nëse një Ndryshim i tillë në Ligj nuk do të kishte ndodhur (**"Propozimi Korrigjues"**).

33.3 Në rastin kur Pala që njofton Ndryshimin në Ligj nuk është e kënaqur me Propozimin Korrigjues, ose në rast se nuk hartohet asnjë Propozim Korrigjues brenda periudhës kohore të deklaruar më lart, Palët diskutojnë menjëherë me qëllim për të arritur një zgjidhje të kënaqshme për të dy palët që do t'i kthente Palët në pozitën që do të kishin qenë po të mos kish ndodhur një Ndryshim i tillë në Ligj. Nëse Palët nuk arrijnë të bien dakord brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i konsultimeve të tilla, Koncesionari (kur Ndryshimi në Ligj rezulton në rritjen e kostove apo në fitime më të ulta), apo Autoriteti (kur Ndryshimi në Ligj rezulton në kosto më të ulëta apo fitim më të madh për Koncesionarin) ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë në përputhje me Nenin 37.

X RASTET E MOSPËRMBUSHJES– NDËRHYRJA E AUTORITETIT

34. RASTET E MOSPËRMBUSHJES

34.1 Një **"Rast Mospërmbushje i Koncesionarit"** nënkupton çdo:

(a) mospërmbushje e Koncesionarit për të paguar Dëmet e Likuidueshme brenda afatit të përcaktuar, ose për të siguruar në cdo kohë Garancinë e Performancës siç parashikohet në Kontratë;

(b) mospërmbushje të Koncesionarit të ndonjë prej Kërkesave Teknike Minimale dhe Ligjit të Zbatueshëm në të paktën një prej Objekteve Laboratorike për më shumë se (i) tridhjetë (30) ditë të njëpasnjëshme ose (ii) nëntëdhjetë (90) ditë gjatë dymbëdhjetë (12) Periudhave Buxhetore;

(c) rast falimentimi që prek Koncesionarin;

(d) cdo shtrembërim, deklaratë e pavërtetë ose e gabuar apo shkelje e deklarimeve nga Koncesionari që ndikon negativisht këtë Kontrate, Projektin dhe/ose kryerjen e Shërbimeve nga Koncesionari;

(e) çdo pasqyrim mashtrues nga ana e Koncesionarit;

(f) dënimi Koncesionarit për ndonjë akte korrupsioni, bashkëpunimi, pastrimi të parave ose vepra të ngjashme;

(g) çdo shkelje tjetër materiale e kësaj Kontrate nga Koncesionari; ose

(h) marrja nga Koncesionari apo ndonjë prej punëmarrësve të tij të pagesave nga një palë e tretë për ofrimin e Shërbimeve Mjekësore për ndonjë pacient.

34.2 Një "**Rast Mospërmbushje i Autoritetit**" nënkupton çdo:

(a) shkelje të detyrimeve në Nenin 3.3.1, 8 dhe 23;

(b) mospagim të faturave për një periudhë prej më shumë se një qind e njëzetë (120) ditësh nga momenti që bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme;

(c) çdo shkelje tjetër që konsiderohet shprehimisht një Rast Mospërmbushje i Autoritetit në një dispozitë specifike e kësaj Kontrate; dhe/ose

(d) cdo shtrembërim, deklarim i pavërtetë apo i gabuar apo shkelje e deklarimeve të Autoritetit që ndikon negativisht këtë Kontrate.

35. PERIUDHA E KORRIGJIMIT DHE PËRFUNDIMI NË LIDHJE ME NJË RAST MOSPËRMBUSHJE

35.1 Njoftimi

Në rast se ndodh një Rast Mospërmbushje i Koncesionarit, ose një Rast Mospërmbushje i Autoritetit, Pala që nuk ka kryer shkeljen i dërgon njoftim për rastin në fjalë Palës në mospërmbushje ("**Njoftim Mospërmbushje**").

35.2 Periudha e Korrigjimit

Konform Nenit 36 më poshtë, Pala në shkelje e korrigjon mospërmbushjen që bëhet shkak për dërgimin e Njoftimit të Mospërmbushjes brenda tridhjetë (30) ditësh (apo një periudhë më të gjatë siç mund të jetë parashikuar në Njoftimin e Mospërmbushjes, ose siç Palët mund të bien bashkërisht dakord) pas Njoftimit të Mospërmbushjes ("**Periudha e Korrigjimit**"), por vetëm nëse një Rast i tillë Mospërmbushjeje mund të korrigjohet. Përjashtimisht, një shkelje e Koncesionarit në lidhje me cështjet e sigurisë duhet riparuar brenda pesë (5) ditësh.

Në mbarim të Periudhës së Korrigjimit, nëse:

(i) Rasti i Mospërmbushjes nuk është korrigjuar; dhe

(ii) Palët nuk kanë rënë dakord të zgjasin Periudhën e Korrigjimit,

Pala që nuk ka bërë shkelje ka të drejtë t'i dërgojë Palës në shkelje një Njoftim për Zgjidhjen e Kontrates.

36. NDËRHYRJA E AUTORITETIT

36.1 Shkaku për ndërhyrje

Nëse ndodh një Rast Mospërmbushjeje i Koncesionarit që (i) është aq i rëndësishëm sa barazvlerësohet me braktisjen e Projektit, ose në rast Shërbimet mungojnë në mënyrë thelbësore në ndonjë prej Spitaleve Referuese, qoftë për shkak të mungesës së stafit, për shkak defekti të Pajisjeve, apo për ndonjë arsye tjetër dhe kur (ii) kjo mospërmbushje nuk është korrigjuar brenda dyzetë e tetë (48) orësh nga data e dërgimit të Njoftimit të Mospërmbushjes nga Autoriteti në lidhje me një Rast Mospërmbushjeje të Koncesionarit, Autoriteti ka të drejtë (por nuk jo detyrim) që të veprojë menjëherë në përputhje me Nenin 36.2 më poshtë.

36.2 E Drejta e Ndërhyrjes

36.2.1 Nëse Neni 36.1 zbatohet për një apo më shumë Spitale Referuese, Autoriteti mund të njoftojë Koncesionarin me shkrim për sa më poshtë:

(a) një përshkrim të veprimit urgjent korrigjues që ka ndërmend të ndërmarrë, i cili mund të përfshijë marrjen përsipër të të gjithë apo një pjesë të Objekteve Laboratorike të Spitalit(ve) Referues përkatës, duke përfshirë kufizimin e aksesit të Koncesionarit në Objektet Laboratorike në një apo më shumë Spitale Referues, për të shfrytëzuar ai vetë Pajisjet në vend të Koncesionarit, dhe për të udhëzuar stafin (përfshirë edhe Personelin Kyç) të Koncesionarit;

(b) arsyen për një veprim të tillë;

(c) datën kur ai dëshiron të nisë një veprim të tillë (datë e cila mund të jetë data e vetë njoftimit);

(d) periudhën kohore që ai beson se është e nevojshme për një veprim të tillë; dhe

(e) pasojat mbi Koncesionarin dhe detyrimin e tij për të ofruar Shërbime gjatë periudhës që ndërmerret një veprim i tillë.

("E drejta e Ndërhyrjes").

36.2.2 Autoriteti mund ta ushtrojë të Drejtën e Ndërhyrjes drejtpërdrejt, apo mund të udhëzojë një Palë të tretë të zgjedhur prej tij për të vepruar për llogari të tij (duke përfshirë Spitalin(et) Referues përkatës(e)). Në çdo rast, në çdo kohë gjatë ushtrimit të të Drejtës së Ndërhyrjes, Autoriteti ushtron dhe siguron që çdo Palë e Tretë që vepron për llogari të tij, të ushtrojë kujdesin dhe korrektesën e duhur në lidhje me Objektet Laboratorike por megjithatë Autoriteti nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi dëmet që mund t'i shkaktohen pronës së Koncesionarit (duke përfshirë Pajisjet dhe FF&E-të) gjatë ushtrimit të së Drejtës së Ndërhyrjes, me përjashtim të rasteve kur dëmi është rezultat i një neglizhence të madhe apo shkelje të qëllimshme nga ana e Autoritetit, apo e palës së tretë që vepron për llogari të Autoritetit.

36.2.3 Autoriteti mund t'i faturojë Koncesionarit të gjitha kostot e arsyeshme që lindin në lidhje me sipërmarrje të tilla (qofshin të kryera nga kontraktues të tretë, nga Spitali(et) Referues ose nga vetë Autoriteti), por vetëm në masën që kosto të tilla:

(a) evidentohen me dokumente që konfirmojnë shpenzime të tilla, dhe

(b) të jenë në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë.

Pa cenuar dispozitën e përgjithshme të Nenit 26.1, Autoriteti ka të drejtë të tërheqë pagesat e kërkueshme nga Koncesionari në lidhje me këto kosto nga Garancia e Performancës nëse këto nuk paguhen brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i Autoritetit për pagesën e tyre (dhe për shmangien e çdo paqartësi, Koncesionari do të paguajë drejtpërdrejt tek Autoriteti cdo shumë në lidhje me këto pagesa e cila tejkalon vlerën e Garancisë së Performancës).

36.3 Procedura dhe kohëzgjatja

36.3.1 Autoriteti dhe Koncesionari do të takohen menjëherë pas ushtrimit të së Drejtën së Ndërhyrjes në njëapo më shumë Spitale Referuesepër të rënë dakord për një plan veprimi për të korrigjuar situatën dhe kthyer Palët në situatën normale për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas Kontratës. Në rastin kur (i) nuk arrihet një marrëveshje, ose (ii) arrihet një marrëveshje, por Koncesionari nuk e përmbush apo zbaton një marrëveshje të tillë, brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur Autoriteti fillon të ushtrojë të Drejtën e Ndërhyrjes në Spitalin(et) Referues përkatës, Autoriteti i dërgon një Njoftim për Zgjidhjen e Kontrates Koncesionarit, në përputhje me Nenin 37, për Rast Mospërmbushje të Koncesionarit dhe në zbatim të Neneve 38 dhe 39.2. E Drejta e Ndërhyrjes mbetet në fuqi gjatë gjithë periudhës së njoftimit të përcaktuar sipas Nenit 37.

36.3.2 Në rastin kur Autoriteti nuk lëshon një Njoftim për Zgjidhje të Kontrates në përputhje me Nenin 37, Koncesionari rivendoset në të drejtat dhe detyrimet e tij, sipas kësaj Kontrate.

36.4 Të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari çlirohet prej detyrimeve të tij për të ofruar Shërbime në Spitalin përkatës Referues, por vetëm në masën dhe periudhën e kohës që Shërbimet janë marrë përsipër nga Autoriteti gjatë ushtrimit të së Drejtës së tij të Ndërhyrjes. Koncesionari, përveç ndërmarrjes së të gjithë veprimeve të përshtatshme për të korrigjuar Rastin e Mospërmbushjes së Koncesionarit, i cili bëhet fillimisht shkak për të ushtrimin e të Drejtës së Ndërhyrjes, i ofron Autoritetit të gjithë asistencën e nevojshme për ushtrimin e të Drejtës së Ndërhyrjes. Çdo pengesë e parregullt në ushtrimin e të drejtave të Autoritetit sipas këtij Neni nga Koncesionari, i jep të drejtë Autoritetit t'i dërgojë menjëherë Koncesionarit një Njoftim për Zgjidhjen e Kontratës në përputhje me Nenin 37, për Rast Mospërmbushje të Koncesionarit,

por Zgjidhja në këtë rast hyn menjëherë në fuqi (pavarësisht dispozitës së Nenit 37.3) dhe Nenet 38 dhe 39.2 do të zbatohen.

XI PËRFUNDIMI I KONTRATËS

37. PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM

37.1 Përfundimi nga Autoriteti

Pa cenuar Nenin 4.3, Autoriteti ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë bazuar në:

(i) një Rasti Mospërmbushje të Koncesionarit që nuk është korrigjuar gjatë Periudhës së Korrigjimit;
(ii) një Ngjarjeje të Zgjatur të Forcës Madhore;
(iii) një Ndryshimi në Ligj, në rrethanat e parashikuara në Nenin 33.3; ose
(iv) për shkak të politikave/interesit publik.

37.2 Përfundimi nga Koncesionari

Koncesionari ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontrate bazuar në:

(i) një Rast Mospërmbushje të Autoritetit që nuk është korrigjuar brenda Periudhës së Korrigjimit;
(ii) një Ngjarjeje të Zgjatur e Forcës Madhore;
(iii) një Ngjarjeje Politike të Forcës Madhore që nuk është korrigjuar apo zgjidhur sipas Nenit 32.4; ose

37.3 Procedura e Zgjidhjes

Çdo Palë që ka të drejtë të zgjidhë Kontratën në përputhje me Nenet 37.1 dhe 37.2 dhe që dëshiron ta bëjë këtë, i dërgon një njoftim Palës tjetër ku e informon për qëllimin e saj për zgjidhjen e Kontratës dhe ku deklaron arsyet për zgjidhjen e saj (**"Njoftimi për Zgjidhjen e Kontratës"**).

Marrëveshja zgjidhet efektivisht dhe automatikisht me tejkalimin e afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas Njoftimit për Zgjidhjen e Kontratës.

38. PAGESAT E PËRFUNDIMIT TË PARAKOHESHËM

38.1 Shumat e kompensimit

Në rastin e zgjidhjes së parakohshme të Kontratës, Autoriteti i paguan Koncesionarit një kompensim të përllogaritur si më poshtë:

(i) zgjidhja nga Autoriteti për një Rast Mospërmbushje të Koncesionarit = 0.8 x A, minus shumën e Garancisë së Performancës që është e disponueshme për t'u tërhequr dhe shumën e sigurimit të paguar apo që i duhet paguar Koncesionarit;
(ii) zgjidhja nga Autoriteti për arsye të politikave/interesit publik = A + B + C
(iii) zgjidhja nga Koncesionari për shkak të një Rasti Mospërmbushje të Autoritetit, , Ndryshimi në Ligj = A + B + C
(iv) zgjidhja nga Autoriteti për mospërmbushje të koncesionarit që nuk është korrigjuar gjatë Periudhës së Korrigjimit sipas nenit 37.1 = sipas nenit 36 "NDËRHYRJA E AUTORITETIT"

A = nënkupton vlerën neto kontabël e Pajisjeve dhe FF&E-ve në pronësi të Koncesionarit dhe transferuar Autoritetit, e përshtatur sipas inflacionit, bazuar në Indeksin e Çmimeve me Shumicë – Mallra dhe shërbime të ndryshme;

B = nënkupton kostot e ndërprerjeve për de-mobilizimin e stafit të Koncesionarit dhe kostot e përfundimit të nënkontraktorëve, të cilat janë të barabarta me kostot e zgjidhjes së kontratave që Koncesionari i paguan stafit të tij në përfundim të punësimit, plus kostot e Koncesionarit për përfundimin e kontratave me palët e treta;

C = nënkupton një kompensimi shtesë të llogaritur si mëposhtë: (i) midis Datës së Fillimit dhe Datës Reale të Komisionimit për Objektin e parë Laboratorik: vlerës më të lartë midis pesëmbëdhjetë përqind (15%) të Tavanit të Buxhetit Vjetor të vitit të zgjidhjes së Kontrates dhe 1,500,000 Euro; (ii) midis Datës Reale të Komisionimit për Objektin e parë Laboratorik dhe fundit të vitit të parë të veprimtarisë, (100%) të Tavanit të Buxhetit Vjetor për atë vit operativ; (iii) për vitet vijuese, (100%) të pagesës së Tarifës totale të Shërbimit të vitit të mëparshëm, nga e cila zbritet vlera e barabartë me 1/120 për secilën Periudhë Buxhetore të kaluar nga Data Reale e Komisionimit[1].

38.2 Vlerësimi nga Auditori i Pavarur

38.2.1 Koncesionari përgatit për Autoritetin një përllogaritje të kompensimit për zgjidhjen e Mosmarrëveshjes sipas Nenit 38.1 të shoqëruar me dokumentet përkatës që konfirmojnë përllogaritjet e tij. Autoriteti informon Koncesionarin me shkrim nëse është dakord apo jo me vlerësimin e propozuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Nëse Autoriteti nuk është dakord me vlerësimin e dhënë nga Koncesionari, vlerat "A" "B" dhe "C" do të përcaktohen nga një Auditor i Pavarur i caktuar në përputhje me Nenin 38.2.2 dhe Nenin 38.2.3.

38.2.2 Auditori i pavarur duhet (i) të jetë i regjistruar si ekspert kontabël i autorizuar në Shqipëri, (ii) të ketë të paktën dhjetë (10) vjet përvojë profesionale si ekspert kontabël i autorizuar, përfshirë të paktën pesë (5) vite në Shqipëri, dhe (iii) nuk duhet të ketë konflikt interesi ("Auditori i Pavarur"). Auditorit të Pavarur i kërkohet të paraqesë një raport me shkrim që përcakton konstatimet e tij brenda tridhjetë (30) ditësh nga emërimi. Në cdo rast vendimi i tij mund të kundërshtohet nga palët sipas nenit 43. Vendimi nuk mund të bëhet i detyrueshëm për t'u zbatuar nga palët kontraktore.

38.2.3 Auditori i Pavarur do të caktohet si më poshtë dhe, me kusht që dispozitat e këtij Neni të jenë respektuar, konsiderohet se është emëruar bashkërisht nga Autoriteti dhe Koncesionari:

(a) **Auditori i Pavarur do të zgjidhet nga AK, në një procedurë konkurimi siç e mundëson legjislacioni në fuqi, dhe në të cilën koncesionari do të jetë në rolin e vëzhguesit. Pavarësisht mosmarrëveshjeve apo kalimit të kontratës në arbitazh, koncesionari detyrohet të vazhdoje aktivitetin.**

38.2.4 Palët i ofrojnë të gjithë asistencën e arsyeshme Auditorit të Pavarur për të mundësuar realizimin e detyrave të tij brenda afateve të parashikuara, duke përfshirë, për sa i takon Koncesionarit, aksesin e plotë në llogaritë e tij.

38.2.5 Tarifat, kostot dhe shpenzimet e Auditorit të Pavarur të caktuar në përputhje me Nenin 38.2.2, përballohen bashkërisht nga Koncesionari dhe Autoriteti. Pa cenuar mjetet e disponueshme të Auditorit të Pavarur, në rastin kur ndonjë nga Palët nuk paguan pjesën përkatëse të shpërblimit, zbatohen dispozitat vijuese:

(a) në rastin kur Koncesionari nuk paguan, Autoriteti ka të drejtë të kompensojë shumën përkatëse me tarifat që Autoriteti i paguan Koncesionarit sipas Nenit 38.1.

(b) pa cënuar dispozitën e përgjithshme të Nenit 26.1, në rastin kur Autoriteti nuk paguan tarifat që i detyrohet Auditorit të Pavarur, Koncesionari mund t'i paguajë këto tarifa për llogari të Autoritetit dhe mund të zbresë një shumë të barasvlershme nga Garancia e Performancës.

38.3 Pagesat për Zgjidhjen e Kontrates

Pagesat për Zgjidhjen e Kontrates bëhen brenda njëqind e njëzet (120) ditësh pas (i) miratimit nga ana e Autoritetit të vlerësimit të Koncesionarit sipas Nenit 38.2.1, ose, (ii) datës së raportit të Auditorit të Pavarur sipas Nenit 38.2.2, në rastin kur zbatohet ky nen.

39. DORËZIMI

39.1 Përgatitja për Dorëzim

39.1.1 Në gjashtë (6) muajt e fundit të Kohëzgjatjes, Koncesionari bashkëpunon dhe i ofron të gjithë aksesin dhe informacionin Autoritetit (ose çdo palë të tretë të caktuar prej tij), që mund të kërkohetbëhet i nevojshëm për të marrë përsipër shfrytëzimin e Objekteve Laboratorike.

39.1.2 Gjatë kësaj periudhe, Autoriteti ka të drejtë të kontrollojë punëmarrësit e Koncesionarit dhe, në bazë diskrecionare, të zgjedhë që të vazhdojë punësimin e ndonjë punëmarrësi (por duke përjashtuar Personelin Kyç, përveçse nëse autorizohet shprehimisht nga Koncesionari) që e konsideron me dobishëm për vazhdimësinë e ofrimit të Shërbimeve, ose për ta transferuar atë tek një ofrues i ri. Koncesionari mban përgjegjësi individuale për kostot dhe përgjegjësitë e lidhura me zgjidhjen e kontratave të punëmarrësve të tjerë.

39.2 Procesi

Në datën e mbarimit të Kohëzgjatjes ose zgjidhjes së parakohshme të Kontratës:

(a) aksesi në, osc të drejtat e përdorimit të Koncesionarit në lidhje me Lokalet dhe Ambientet e dhëna përfundojnë dhe Koncesionari menjëherë zhvishet nga cdo e drejte për të përdorur Lokalet dhe Ambientet. Koncesionari do të largohet nga Lokaletpa asnjë ngurrim apo vonesë, absolutisht dhe plotësisht i lirë dhe i pastër nga çdo barrë apo të drejta servituti, pavarësisht pretendimeveqë mund të ekzistojë midis Palëve ose nga cdo palë e tretë;

(b) Koncesionari nuk ka më (i) të drejtën e përdorimit, shfrytëzimit dhe /ose gëzimit të Objekteve Laboratorike; dhe

(c) Koncesionari i transferon menjëherë Autoritetit (ose Spitalit Referues përkatës, nëse udhëzohet nga Autoriteti) të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e Koncesionarit lidhje me Projektin, të çliruara dhe të pastra nga çdo barrë apo interes tjetër bllokues, duke përfshirë (për aq kohë sa ato janë pjesë përbërëse ose përdoren për Projektin), sa më poshtë:

(i) Ambientet;

(ii) të gjithë pasuritë personale të trupëzuara, duke përfshirë Pajisjet në gjendje të mirë (me përjashtim të amortizimit të zakonshëm); Pajisjet duhet të kenë në përputhje me Kërkesat Teknike Minimale dhe jetëgjatësinë e dobishme tyre të deklaruar në Listën e Pajisjevenjë jetëgjatësi të dobishme të mbetur prej 3 vjetësh;

(iii) softuerin dhe të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, nëse kërkohet, dhe vetëm në masën e kërkuar për t'i dhënë mundësi Autoritetit të vazhdojë përdorimin e Pajisjeve;

(iv) të gjitha FF&E-të;

(v) shënime, raporte, të dhëna dhe informacione, vizatime, rezultate analizash, dokumente, elektronike ose jo (duke përfshirë dokumentet e projektimit të Ambienteve);

(vi) të gjitha garancitë e Pajisjeve, materialeve dhe Punimeve;

(vii) të gjitha policat e sigurimit dhe të gjitha të drejtat e tjera të kontratave, duke përfshirë kontratat e qerasë (nëse këto mund të cedohen në përputhje me termat e tyre);

(viii) të gjitha punimet në progres e sipër sipas kontratave me shitësit, furnitorët, sipërmarrësit dhe nënkontraktorët; dhe

(ix) cdo të drejtë mbi të ardhurat e arkëtueshme nga polica sigurimi të pajtuara nga Koncesionari apo për llogari të Koncesionarit, por të papaguara deri në datën e përfundimit të kësaj Kontrate, në lidhje me të drejtat, titullin dhe interesat e Koncesionarit në Projekt.

XII MARRËDHËNIET ME PALËT E TRETA

40. DËMSHPËRBLIMET

40.1 Koncesionari dëmshpërblen Autoritetin për çdo detyrim apo kërkesë për dëmshpërblim për shkak:

(a) vdekje apo dëmtim të pësuar nga ndonjë person;

(b) humbje apo dëmtim të pronës (përfshirë pronën që i përket Autoritetit për të cilën është përgjegjës Koncesionari); dhe/ose

(c) të gjitha dëmet ose humbjet e tjera

që mund të rrjedhin apo janë pasojë e një veprimi apo mosveprimi për përmbushjen apo mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate (përveç dëmeve ose humbjeve të shkaktuara nga neglizhenca e rëndë ose shkelja e qëllimshme e Autoritetit).

40.2 Autoriteti dëmshpërblen Koncesionarin për çdo detyrim apo kërkesë për dëmshpërblim që rrjedh nga:

(a) vdekja apo dëmtimi personal i një personi; dhe/ose

(b) humbja apo dëmtimi i pronës;

që mund të rrjedhin apo janë pasojë e:

(c) Analizave të bëra nga një person që nuk është i punësuar iAutoritetit ndonjë Spitali Referues përveç rastit kur Analiza të tilla konfirmojnë rezultatet e nxjerra nga personeli i Koncesionarit,

(d) një trajtimi mjekësor (apo mungesën e tij) të dhënë një pacienti drejtpërdrejt nga Autoriteti ose nga ndonjë Spital Referues (ose nga agjentë dhe/ose punëmarrës të tyre p) përpara ose pas ofrimit të Shërbimeve Mjekësore për atë pacient nga Koncesionari,

por në çdo rast, përjashtuar dëmet ose humbjet eshkaktuara nga neglizhenca e rëndë ose shkelja e qëllimshme e Koncesionarit.

40.3 Në masën që një Palë (**"Zhdëmtuesi"**) i paguan Palës tjetër (**"i Zhdëmtuari"**) një shumë kompensimi për shkak të veprimeve të një pale të tretë, Zhdëmtuesi përfiton të drejtat e të Zhdëmtuarit kundër kësaj pale të tretë dhe ka të drejtë t'i kundërdretojë palës së tretë të gjitha prapësimet e të Zhdëmtuarit.

40.4 Trajtimi i Pretendimeve

(a) Nëse një Palë (**"Pala e Zhdëmtuar"**) merr një njoftim, kërkesë, letër apo dokument tjetër mbi pretendime për dëmshpërblim nga e cila duket se Pala e Zhdëmtuar duhet apo mund të bëhet subjekt dëmshpërblimi sipas këtij Neni 40, Pala e Zhdëmtuar duhet të njoftojë me shkrim Palën tjetër (**"Zhdëmtuesin"**) sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur. Çdo detyrim tjetër i Zhdëmtuesit që vjen si pasojë e një vonese të paarsyeshme nga Pala e Zhdëmtuar për dhënien e këtij njoftimi është, si rrjedhojë, e përjashtuar nga masa e dëmshpërblimit të Zhdëmtuesit në favor të Palës së Zhdëmtuar.

(b) Kur duket se Pala e Zhdëmtuar mund të bëhët subjekt dëmshpërblimi nga Zhdëmtuesi për cdo përgjegjësi që rrjedh nga veprimet apo mosveprimet që janë objekt i kërkesës

për dëmshpërblim, Zhdëmtuesi mund ta kundërshtojë këtë pretendim në emër të Palës së Zhdëmtuar, rast në të cilin Zhdëmtuesi mund të përdorë çdo prapësim, mosmarrëveshje, zgjidhje, kompromis apo apelim të pretendimit për dëmshpërblim dhe çdo negociatë tjetër të lidhur, dhe Pala e Zhdëmtuar i siguron Zhdëmtuesit të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm, aksesin dhe asistencën për qëllimet e shqyrtimit dhe kundërshtimit të një kërkese të tillë.

41. NËNKONTRAKTORËT

41.1 Të përgjithshme

41.1.1 Pa rënë ndesh me paragrafët e mëposhtëm, Koncesionari merr përsipër që të kryejë i vetëm përmes personelit të tij, aktivitetet kryesore si Shërbimet Mjekësore, kryerjen e analizave, raportimin dhe aktivitete të tjera kryesore që lidhen me shfrytëzimin e Shërbimeve. Koncesionari nuk mund të cedojë, transferojë, ose japë me të drejta franshize aktivitetet kryesore. Çdo nënkontratë e lidhur nga Koncesionari pa miratimin e Autoritetit konsiderohet si Rast Mospërmbushje i Koncesionarit.

~~Pa rënë ndesh me Nenin 3.1.3, Koncesionari mund të lidhë nënkontrata që nuk e kalojnë~~ 40% të vlerës së përgjithshme të Projektit pa miratimin e Autoritetit për aktivitete ndihmëse të Shërbimeve Mjekësore, të tilla si furnizimi dhe mirëmbajtja e Pajisjeve, administrimi, siguria, me Nënkontraktorë që kanë aftësi të mjaftueshme, reputacion dhe burime të mjaftueshme për të marrë përsipër këto detyrime dhe të cilët nuk janë kundërshtuar në përputhje me Nenin 3.2.1 (b) (iii).

41.1.2 Koncesionari siguron që të gjitha Nënkontratat të përmbajnë dispozitat e mëposhtme:

(a) dispozita që mundësojnë që të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit në këto kontrata t'i transferohen (pa pagesë) Autoritetit me kërkesën me shkrim të tij, në rastin e zgjidhjes së kësaj Kontrate;

(b) dispozita që caktojnë kërkesa sigurimi mbi Nënkontraktorin përfshirë kërkesa për përgjegjësinë profesionale, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë; dhe

(c) dispozita që caktojnë detyrime të konfidencialitetit të ngjashëm me atë të parashikuar në Nenin 37.

(d) ndalime për angazhime në veprime korruptive, mashtruese apo shtrënguese, apo veprime të tjera të jashtëligjshme.

41.1.3 Pavarësisht nga pëlqimi apo miratimi i Autoritetit për një Nënkontratë dhe/ose Nënkontraktor:

(a) Koncesionari në asnjë mënyrë nuk çlirohet nga ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate për shkak të ekzistencës apo zbatimit të ndonjë Nënkontrate nga ndonjë Nënkontraktor, dhe

(b) pëlqimi apo miratimi i dhënë nga Autoriteti nuk krijon asnjë përgjegjësi apo detyrim për Autoritetin ndaj Nënkontraktorëve dhe Koncesionari dëmshpërblen dhe përjashton Autoritetin ndaj cdo përgjegjësi, pretendim për dëmshpërblim, padi apo procesi tjetër të ardhur si pasojë e ndonjë Nënkontrate apo marrëdhënies midis Koncesionarit dhe një Nënkontraktori.

42. LIGJI I ZBATUESHËM

Kontrata e Koncesionit rregullohet dhe interpretohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë,.

43. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

43.1 Njoftimi i Mosmarrëveshjes

Në rastin e një mosmarrëveshjeje që lind nga çdo çështje apo në lidhje me këtë Kontratë ("**Mosmarrëveshje**"), secila Pala ka të drejtë të njoftojë për këtë Palën tjetër ("**Njoftim për Mosmarrëveshje**").

43.2 Diskutimet dhe Pajtimi

43.2.1 Palët përpiqen t'i zgjidhin Mosmarrëveshjet në mirëbesim dhe me diskutime miqësore brenda hapësirës së Komitetit Ndërlidhës.

43.2.2 Efikasiteti i një zgjidhjeje miqësore të një Mosmarrëveshjeje varet nga marrëveshja me shkrim e Palëve.

43.3 Arbitrazhi

43.3.1 Në rastin se Autoriteti dhe Koncesionari nuk nënshkruajnë një marrëveshje me shkrim për zgjidhjen e Mosmarrëveshjes brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga Njoftimi i Mosmarrëveshjes, Mosmarrëveshja mund të dërgohet për shqyrtim nga tre arbitra, në arbitrazh sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë: një arbitër caktohet nga secila Palë dhe i treti caktohet në përputhje me Rregullat në fjalë.

43.3.2 Procesi i arbitrazhit do të zhvillohet në **Tiranë** . Ligji rregullues është ai shqiptar dhe si Forum Arbitrazhi është ICC, me seli në Tiranë.

43.3.3 Kur një Mosmarrëveshje dërgohet për zgjidhje në arbitrazh, përveç lëndës në diskutim, Palët kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtat e tyre të tjera përkatëse dhe të përmbushin detyrimet e tyre të tjera përkatëse sipas Kontratës së Koncesionit.

43.4 Heqja dorë nga imuniteti

Secila Palë heq dorë në mënyrë të pakthyeshme në masën më të plotë të lejuar nga Ligji i Zbatueshëm, në lidhje me veten, të ardhurat dhe asetet e saj (pavarësisht nga përdorimi faktik apo i synuar i tyre), nga gjithë imuniteti për shkaqe sovraniteti apo shkaqe të tjera të ngjashme përkundrejt (i) padive (ii) juridiksionit të çdo gjykate, (iii) sigurimin e padisë, urdhëravepër një veprim të caktuar apo për dorëzimin e pronës, (iv) konfiskimin e pasurive (qoftë përpara ose pas gjykimit) dhe nga (v) ekzekutimi apo zbatimi i një gjykimi, për të cilin ai vetë ose të ardhurat e tij në të kundërt do të kishin pasur të drejtë në një proces ligjor në gjykatat e çdo juridiksioni. Secila Palë pranon në mënyrë të pakthyeshme, me masën më të plotë të lejuar nga Ligji i Zbatueshëm, se nuk do të kërkojë një imunitet të tillë në ndonjë proces.

– "Përjashtime"

a) "Ambjentet e misionit", të tashme apo të ardhme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, "ambientet konsullore" të tashme dhe të ardhshme, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në vitin 1963, ose që përdoren nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose çdo agjenci ose instrument i tyre;

b) Asnjë pasuri të paluajtshme sipas nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 Mbi Pasuritë e Paluajtshme Shtetërore" i ndryshuar;

c) Asnjë fond monetar/ose shuma monetare të përcaktuara për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka në bazë të traktateve, konventave apo marrëveshjeve publike ndërkombëtare të nënshkruara në kapacitetin e saj si Subjekt i së drejtës Ndërkombëtare Publike.

43.5 Ekzistenca

Dispozitat e këtij Neni 43 do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të kësaj Kontrate për çfarëdo arsye.

XIV TË NDRYSHME

44. KALIMI

44.1 Në përputhje me Nenin 44.2 më poshtë, Koncesionari nuk mund të shesë, ngarkojë, kalojë tek një palë tjetër, apo ndryshe transferojë të drejtat apo detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, pa pëlqimin me shkrim të Autoritetit. Çdo shitje faktike, tentative apo qëllim për shitje nga Koncesionari, barrësim, kalim ose transferim i ndonjë prej të drejtave detyrimeve apo interesave të tij bazuar në këtë Kontrate që nuk përputhet me kushtet e këtij Neni është i pavlefshëm dhe pa fuqi ligjore dhe përbën Rast Mospërmbushje të Koncesionarit.

44.2 Autoriteti ka të drejtë t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate çdo Entiteti tjetër Shtetëror me tagra të njëjta për të dhënë të drejta koncesionare.

45. KONFIDENCIALITETI

Palët mbajnë konfidenciale dispozitat e kësaj Kontrate, përfshirë Shtojcat e saj, si edhe çdo dokument të bërë të njohur, apo të dhënë Palës tjetër sipas kësaj Kontrate. Ky detyrim nuk zbatohet për publikimin e informacionit:

(a) nga secila Palë, këshilltarëve apo konsulentëve të saj dhe, nga ana e Koncesionarit, në marrëdhëniet e tij me Financuesit ose Investitorët e Kapitalit, qofshin ata potencialë apo aktuale, me kusht që të gjithë këta këshilltarë, konsulentë apo Financues ose Investitorë Kapitali të jenë të detyruar nga zotime të barasvlershme konfidencialiteti;

(b) atyre palëve dhe në atë masë që është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;

(c) që bëhet përgjithësisht i njohur për publikun, përveçse kur publikimi fillestar është bërë nga njëra Palë në shkelje të këtij Neni;

(d) nëse dhe në shkallën e kërkuar nga Ligji Zbatueshëm; dhe

(e) për të respektuar një urdhër gjykate, ose një urdhër rregullator të një organi të autorizuar publik.

46. GJUHA

Kjo Kontratë nënshkruhet në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje midis të dy versioneve, versioni në gjuhën shqipe ka përparësi.

Çdo komunikim dhe njoftim midis Palëve në lidhje me këtë Kontrate është në gjuhën shqipe.

47. POZITA E AUTORITETIT SI AUTORITET SHETËROR

Për shmangien e çdo dyshimi, kjo Kontratë nuk kufizon ose prek lirinë e diskrecionit të Autoritetit për të përdorur kompetencat e tij ligjore dhe rregullatore, por gjithsesi, me kusht që këto të drejta të ushtrohen në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

48. TATIMET DHE TAKSAT

48.1 Koncesionari është i vetmi përgjegjës dhe ka detyrimin të bëjë pagesat dhe të garantojë se do të paguajë, apo të sigurojë pagimin e të gjithë Tatimeve të vlerësuara për Koncesionarin dhe punonjësit e tij në lidhje me Punimet dhe/ose Shërbimet, ose siç mund të vlerësohen ndryshe si pasojë e përmbushjes nga Koncesionari të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate. Koncesionari mbron, dëmshpërblen dhe mban të padëmtuar Autoritetin ndaj çdo detyrimi për pagesën e Tatimeve.

48.2 Autoriteti nuk është përgjegjës ndaj Koncesionarit dhe Koncesionari nuk ka asnjë pretendim ndaj Autoritetit në lidhje me Tatimet e paguara nga Koncesionari sipas kësaj Kontrate.

48.3 Dispozitat e këtij Neni do të mbeten në fuqi pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj Kontrate për çfarëdo arsye.

49. NJOFTIMET

49.1 Çdo njoftim apo komunikim tjetër nga njëra Palë për Palën tjetër që kërkohet apo lejohet të bëhet sipas dispozitave të kësaj Kontrate duhet të: (i) bëhet me shkrim; (ii) dorëzohet personalisht (dorazi) apo dërgohet me postë të parapaguar rekomande, ose me korrier në adresën e Palës tjetër të dhënë më poshtë, apo në një adresë tjetër që Pala tjetër e njofton me shkrim, apo dërgohet me faks (me marrje të konfirmimit të transmetimit) në numrin e faksit të Palës tjetër të dhënë mëposhtë, apo në një numër tjetër faksi që Pala tjetër mund njoftojë me shkrim; dhe (iii) adresohet në vëmendjen e personit (personave) të caktuar më poshtë apo personit (personave) të tjerë që Pala tjetër mund të njoftojë me shkrim:

Autoriteti: [•]

Koncesionari:

[•]

<u>Me një kopje për</u>:

[•]

<u>Dhe për</u>

[•]

49.2 Çdo njoftim apo komunikim tjetër i bërë nga njëra Palë për Palën tjetër, në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij Neni, konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër: (i) kur dorëzohet dorazi, në ditën që lihet në adresën e asaj Pale, (ii) nëse dërgohet me postë të parapaguar rekomande ose me korrier, dyzetë e tetë (48) orë nga data e postimit, ose (iii) kur dërgohet me transmetim me faks, në datën e përcaktuar në konfirmimin e transmetimit.

50. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME

Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme apo e pazbatueshme, dispozitat e tjera të mbetura të Kontratës nuk preken.

51. GARANCI TË MËTEJSHME

Palët në çdo kohë kryejnë të gjitha veprimet e tjera dhe nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo akt dhe dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm për të përmbushur dhe zbatuar dispozitat e kësaj Kontrate.

52. MARRËVESHJA E PLOTË

Kjo Kontratë, duke përfshirë Hyrjen dhe Shtojcat bashkëngjitur, përfaqëson të gjithë marrëveshjen e lidhur midis Palëve në lidhje me Projektin dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo rregullimet e mëparshme, qofshin ato me gojë apo me shkrim, midis këtyre Palëve në lidhje me Projektin dhe/ose në lidhje me përmbajtjen e kësaj Kontrate (duke përfshirë çdo marrëdhënie apo shkëmbim informacioni në lidhje me garën e Projektit, të tillë si kërkesa për shprehje interesi dhe kërkesa për oferta, përmendur në hyrjen apo shprehjet e interesit dhe/ose ofertat e paraqitura në përgjigje të dokumenteve në fjalë).

53. MOSHEQJA DORË

Asnjëra prej Palëve nuk konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate përveç rastit kur kjo heqje dore bëhet shprehimisht me shkrim. Mungesa e insistimit nga njëra Palë që Pala tjetër të përmbushë në mënyrë korrekte secilën prej dispozitave të kësaj Kontrate, apo për të përfituar nga cdo e drejtë e saj sipas kësaj Kontrate, nuk interpretohet si heqje dorë nga një dispozitë e tillë, ose heqje dorë nga të drejta të tilla në të ardhmen.

Për Koncesionarin		**Për Autoritetin Kontraktues (MSHMS)**	
Emri:	1. LABOPHARMA 2. EXALAB 3. ABLS	**Emri:**	**Arian Kraja**

Pozita:	1. Administrator 2. Përfaqësues mé 3. Grosnari	Pozita:	**Titullar i Autoritetit Kontraktor**
Nënshkrimi:	1. Kristo Andoni 2. Kristo Andoni 3. [illegible]	Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:	1. REPUBLIKA E SHQIPËRISË Sh. p. k LABOPHARMA TIRANE DEPO FARMACEUTIKE	**Vula:**	
	2.		
	3.		